



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 10, 11 DHE 15 MAJ 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 10, 11. I
15. MAJA 2012. GODINE**

**MAJ - MAJA
2012**

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Interpelancë me zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel, sipas kërkesës së Grupit të deputetëve nënshkrues,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011,
11. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011,
12. Shqyrtimi i Raportit të punës së Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2011,
13. Shqyrtimi i Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
14. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
15. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë.
16. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe të Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

D n e v n i r e d

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija sa zamenicom premijera, Edita Tahiri, u vezi sa sudbinom nestalih u odnosu na razgovore sa Srbijom, u Briselu, prema zahtevu Grupe poslanika - potpisnika,
5. Drugo razmatranje Nacrt zakona o pozorištu,
6. Drugo razmatranje Nacrt zakona obligacionim odnosima,
7. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o šemi socijalne pomoći na Kosovu,
8. Razmatranje Godišnjeg finansijskog izveštaja o budžetu Republike Kosova, za 2011. godinu,
9. Razmatranje Izveštaja o radu Sudskog instituta Kosova, za 2011. godinu,
10. Razmatranje Izveštaja o radu Nezavisne Komisije za medije, za 2011. godinu,
11. Razmatranje Izveštaja o radu Kosovske agencije protiv korupcije, za 2011. godinu,
12. Razmatranje Izveštaja o radu Radio - Televizije Kosova, za 2011. godinu,
13. Razmatranje Predloga Vrhovnog suda Kosova o imenovanju člana u Komisiji za imovinske zahteve,
14. Razmatranje predloga Vlade Kosova za imenovanje člana Odbora Kosovske agencije za imovinu,
15. Razmatranje zahteva Komisije ad hoc za amandmandovanje Zakona o opštim izborima, za dodatni rok.
16. Zahtev Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, razvoj sela, sredinu i prostorno planiranje za dodatni rok za razmatranje Nacrt zakona o Nacionalnom parku “Šar” i Nacrt zakona o Nacionalnom parku “Prokletije”

E enjte, më 10.5. 2012

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministër,
Mirë se keni ardhur në mbledhjen plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është 30 minuta, diskutimet në emër të grupeve parlamentare zgjasin 5 minuta, në emër të deputetit, 3 minuta dhe replika s'ka në këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Unë dola ta marr fjalën sot për njërën ndër çështjeve që ka ndodhur në këto javë të fundit dhe po më vjen keq që kryeministri nuk është këtu, se desha t'i them atij direkt, por me këtë rast po u drejtohem deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës.

Unë e kuptoj se kapacitetet e Qeverisë për të zbatuar rendin dhe ligjin në pjesën veriore të Kosovës janë të limituara, e kuptoj që është problem. E kuptoj që është sfidë e Kosovës, këto 12 vjetët e fundit, e kuptoj po ashtu që ndalimi i mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës është sfidë dhe është goxha problem për t'i ndaluar. Dhe e di po ashtu që ka pasur edhe interesa të ndryshme nga bashkësia ndërkombëtare që kjo të ndalohet, të lejohet dhe të krijohen kushte që të mbahen këto zgjedhje. Mirëpo, është e papranueshme, e pa tolerueshme dhe e paarsyeshme që kryeministri në mbledhje të Qeverisë, të dalë edhe të thotë se me mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Republikën e Kosovës, u respektua Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kjo s'ka sens. Kjo është një deklaratë aq e paarsyeshme, aq e palogjikshme, aq e gabuar sa dëmton çdo koncept edhe kornizë të mendimit politik të shtetit të pavarur të Kosovës.

Po ashtu, deklarimi i zëvendëskryeministrit në konferencë për media, se me mbajtjen e zgjedhjeve të Republikës së Serbisë, në Republikën e Kosovës, u respektua Kushtetuta e Republikës së Kosovës - çfarë sensi ka kjo punë? Ne po i kuptojmë situatat ku jemi, ne e dimë fuqinë e limituar, por sjellja triumfaliste e Qeverisë së Kosovës për një fenomen, për një ngjarje negative në dëm të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Kosovës, në dëm të interesave shtetërore të Kosovës, është e papranueshme. Prandaj, mendoj se një sjellje e tillë duhet të gjykohet dhe vlerësohet nga ky Kuvend dhe një mendim dhe veprim i tillë i kryeministrit dhe i Qeverisë, duhet të gjykohet dhe vlerësohet nga ky Kuvend.

Dhe, gjykimi e vlerësimi i këtij Kuvendi, mendoj se është gabim sjellja antikushtetuese e kryeministrit dhe e Qeverisë dhe gabim dhe sjellje në dëm të interesave të Kosovës.

Kjo ishte ajo çfarë desha të them dhe po konkludoj me shprehjen se deklaratimet në mbledhje të Qeverisë dhe pas mbledhjes së Qeverisë, kanë qenë antikushtetuese dhe vetë mbajtja e zgjedhjeve ka qenë antikushtetuese, mirëpo Qeveria e Kosovës, me deklaratime të tilla po e dëmton interesin e Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Duhet ta kemi parasysh se kjo pikë e rendit të ditës është për të biseduar, për të folur deputetët jashtë rendit të ditës, por nuk është për të marrë vendime Kuvendi. Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ajo për çka dola të flas është lidhur me nenet 37 dhe 38 edhe vendimin e presidentes për t'i kthyer edhe një herë këto nene edhe këtë ligj në Kuvendin e Kosovës.

Unë e kam parë gjatë këtyre ditëve, mu ka përmendur emri disa herë si gazetar që e kam votuar, është e vërtetë që e kam votuar nenin 37 dhe 38, në formën si ka qenë, mirëpo ajo çka nuk është e nderhme dhe çka po ndodh në Kuvendin e Kosovës dhe prej deputetëve, ndoshta edhe prej Kabinetit qeveritar herë-herë është një servilitet i skajshëm i tyre dhe një gabim trashanik që janë duke bërë që mediet t'i lejojnë të vetë rregullohen në mënyrën se si ato shohin veten. Nuk është e vërtetë se vetëm në Kosovë ndodh të dënohesh, që Kodi Penal ta parashohë shpifjen, për shpifjen në Kodin Penal flasin gjysma e shteteve të BE-së, flasin gjysma e shteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, madje kemi edhe në burg në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gazetarë të cilët kanë vendosur të mos e tregojnë burimin e tyre, siç është rasti i gazetares së Uashington Post-it, e cila dënohet për shkak se nuk ka pranuar ta tregojë burimin. Por, edhe gazetarët duhet të sakrifikojnë pak dhe jo të sillen si “lopë të shenjta” ... ne kemi hequr dorë prej imunitetit si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne e kemi vu veten përpara drejtësisë. Pse gazetarët kërkojnë që të mbrohen, jo prej vetëtimës, por prej murmurimës, ata frikohen edhe prej murmurimës – thonë - mbronani se tash kur murmuron ne ka me na vra, jo, jo.

Po e marr rastin e fundit që ndodhi këto dy ditët e fundit, një fushatë e egër ndaj nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, zotit Xhavit Haliti. Një i burgosur ordiner, qohet në mënyrë ilegale me telefon nga burgu, thirr mediet edhe mediet, pa kurrfarë filtri, pa i respektuar dy burimet, pa i respektuar kush është edhe dikush tjetër, pra është në etikën e gazetarëve që t'i kenë së paku dy burime kur flasin për tema kaq të ndjeshme. Merret shabllon një i dënuar ordiner, thirr edhe thotë që kam porosi prej Xhavit Halitit. Ku po shkojnë këto medie?

Ku është ai, madje kanibalizmi tjetër që po ndodh te mediet është në portale, edhe nëpër mediet elektronike. A i keni lexuar komentet e lexuesve që ndodhin në portalet e medieve tona? Kush merr përgjegjësi prej atyre medieve për ato komente që shkruhen edhe i

pjekin për së gjalli, jo vetëm politikanët, por edhe jetën private të familjeve të tyre edhe secilin njeri? A duhet që gazeta Express, Index Online, Koha.net, Zëri.info, t'i redaktojnë ato komente të lexuesve, të cilët nuk lënë gjë pa thënë për secilin prej jush këtu dhe për secilin anëtar të familjeve tuaja.

Unë mendoj që është mirë që janë kthyer nenet 37 dhe 38, mirëpo nuk duhet hequr dorë prej kornizimit moral edhe ligjor të medieve, që ato nuk janë të lira. Ato duhet ta paguajnë tatimin, t'i paguajnë gazetarët, ato duhet të sillen konform shoqërisë sonë. Nuk mund mediet në mënyrë të pavarur t'ia caktojnë vetes, po...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, në emër të vet. Tregoni përpara se në cilën cilësi flet, në emër të Grupit, apo në emër të tij si deputet. Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu, në emër të Grupit.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,
Para se ta filloj fjalën, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe lëvizja “Vetëvendosje” e përshëndet lirin e Ramush Haradinaj, nga Gjykata e Hagës.

Po ajo që do të flas është në lidhje me zgjedhjet e Serbisë, më 6 maj, mbajtja e tyre është edhe një tregues për rrugën në të cilën sot gjendet mbetja e mbetjes së shtetit të Kosovës, rrugë kjo që për ditë po ia humb përmbajtjen asaj që i themi Republikë e Kosovës dhe e cila që me shpalljen e vet, me pakon e Ahtisarit, i humbi elementet qenësore të shtetit dhe ato të mbeturat po i humb çdo ditë nëpërmjet negociatave.

Dhe, në këtë rrugë, treguesve që e bëjnë të dukshme këtë, siç ishin edhe zgjedhjet e fundit të Serbisë, nuk po i mbetet gjë tjetër Qeverisë, përpos marifeteve retorike për ta kamufluar një gjë të tillë.

Si kryeministri, po ashtu edhe presidentja e Republikës së Kosovës, gjatë muajve mars e prill, disa herë patën deklaruar se kurrfarë zgjedhjesh të Serbisë nuk do të mbahen në Kosovë, meqenëse Kosova është shtet i pavarur e sovran dhe cenime të tilla nuk do të lejohen. Mandej, deklaratat u zbutën nga kryeministri, duke thënë se do të lejohen vetëm zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Serbisë, por jo edhe ato lokale dhe në fund për t'i lejuar pikërisht edhe zgjedhjet lokale. Kryeministri dhe presidentja, jo vetëm që nuk i mbajtën fjalët, por ata bënë lojë retorike për t'i gënjyer qytetarët për një çështje kaq të rëndësishme si kjo.

Pra, në vend se të gënjehet Serbia e të jenë të sinqertë me qytetarët e Republikës së Kosovës, ata e bëjnë saktësisht të kundërtën. Çdo premtim që ia japin Serbisë për pjesëmarrje në bisedime, e që i nevojitet asaj dhe çdo zotim për marrëveshje, që sërish i nevojitet asaj, këta i përmbushin me përpikëri të plotë. Por, as për së afërmi nuk kanë dhe nuk tregojnë këso gatishmërie dhe përkushtim kur janë në pyetje, pra qytetarët e Kosovës.

Dhe, kjo lojë nuk përfundon me kaq. Fundi i saj, si duket, do të jetë njohja pikërisht e këtyre zgjedhjeve lokale, duke i marrë parasysh deklaratimet nga kryeministri për gatishmërinë për negociatat me qytetarët serbë të Kosovës që jetojnë në veri, gjë që, si duket, nuk do të jenë larg, bazuar në deklaratimet e zyrtarëve të huaj në lidhje me negociatat për veriun. Dhe, bazuar te kjo gatishmëri, Qeverisë i mbetet ose të negociojë me Serbinë për veriun, ose ta bëjë këtë me serbët e veriut. Dhe, në bisedimet me serbët e veriut nënkuptojnë bisedime me përfaqësuesit politikë të tyre, e që në fund do të përfundojnë me njohjen e këtyre zgjedhjeve. Pra, marifeti retorik i Qeverisë ishte sa për t'u hedhur hi syve qytetarëve, për diçka që tani më në fillim ishte pranuar.

Zgjedhjet e Serbisë në Kosovë nuk kanë pasur bazë ligjore. Ato nuk ishin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por e shkelën atë. Të dielën që shkoi, qytetarët e Kosovës me dyshtetësi, nuk votuan, atyre askush nuk ua kërkoi pasaportën e Republikës së Kosovës, në vendvotime. Dhe, këtu s'bëhet fjalë, pra për të drejtën e dyshtetësisë, meqenëse Kosova dhe Serbia nuk janë shtete që e njohin njëra-tjetrën, e ku pastaj do të mund të zbatohet ky votim nëpërmjet ambasadave përkatëse.

Zgjedhjet e Serbisë në Kosovë janë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Serbisë. Në preambulë të kësaj kushtetute shkruan që Kosova është pjesë integrale e Serbisë, me autonomi substanciale. Duke i pranuar këto zgjedhje me këtë bazë ligjore dhe pa i shpallur ato ilegale, Qeveria e Kosovës në fakt po i bie se e ka pranuar Kushtetutën e Serbisë. Kjo gjë gjithsesi paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndoshta, përveç në rastet kur Qeveria e Kosovës do ta argumentojë këtë gjë me fusnotën, që e pranoi në Bruksel, në emrin e shtetit që e konteston pra shtetësinë.

Pas arrestimeve në kufi me Serbinë të qytetarëve të shumtë të Kosovës, e po ashtu pas arrestimit të tetë shqiptarëve të tjerë nga Bujanoci dhe mbi të gjitha, pas vrasjes së Selver Haradinajt dhe plagosjes së familjes së tij nga sulmi terrorist, të lejohen zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, paraqet legjitimim të ri politik të krimeve tradicionale shoviniste të Serbisë.

Aq më keq që Policia e Kosovës, që ishte poshtëruar nga xhandarmëria e Serbisë, pas kidnapimit në Dumnice të Besianës, u urdhërua që të kujdeset për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Nëse Qeveria e Kosovës nuk mund, nuk do ose nuk di të bëjë mirë, atëherë së paku nuk do të duhej të bënte keq. Mirëpo, jo, Qeveria e Kosovës po i rri gatitu Beogradit, pikërisht ashtu qysh as vetë Serbia nuk po i rri.

Qeveria e Kosovës nuk po i ndihmon as shqiptarët në veri të Kosovës dhe as ata në Luginë të Preshevës. Shqiptarëve në veri ajo u ndihmon vetëm, pasi të vriten dhe të dëbohen në jug të lumit Ibër, siç ishte rasti me familjen e Selver Haradinajt, e sa u përket shqiptarëve në Luginë të Preshevës, përpos inkurajimit të Serbisë për terror atje nëpërmjet marrëveshjeve që ndodhin paralelisht me terrorin, nga Serbia atje, Qeveria atyre ua shton edhe çmimin e ardhjes në Kosovë nëpërmjet sigurimeve të shumëfishuara, gjë që ata do të duhet të paguajnë në kufi. Lidhja pra e vetme e inkurajimit të shqiptarëve në Luginë të Preshevës, po këputet nga vetë Qeveria e Kosovës. Pra, shumë thjeshtë dhe qartë Kosova po shihet qartë që është duke e vazhduar rrugëtimin e saj drejt humbjes së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Donika Kada-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Falemnderit!

I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Kohëve të fundit po thuaj se çdo mëngjes që marrim gazetën shohim se ka ndodhur një vrasje, vetëvrasje ose tentim vrasje.

Zakonisht shpjegimet e ekspertëve dhe viktimave që po i mbijetojnë kësaj flasin për depresion të rëndë si pasojë e problemeve të mëdha socio-ekonomike, të papunësisë, mungesës së sigurisë në punë, sidomos në sektorin privat, por edhe në sektorin publik.

Mungesës së kontratave, respektivisht zbatimit të Ligjit të punës, i cili ka kaluar në këtë Kuvend, kohë më parë, por edhe më tutje nuk po zbatohet.

Mungesës së qasjes në sigurime shëndetësore dhe pamundësisë për të pasur qasje në shërim, për shkak se shëndetësia në vend, ashtu si edhe shumë sektorë të tjerë është bërë më tepër biznes.

Mungesës së lëvizjes së lirë, sepse me gjithë premtimet e shumta Kosova edhe më tutje po vazhdon të mbetet vendi më i izoluar në Evropë dhe në Ballkan dhe në përgjithësi kjo ndjenjë po shkakton një mungesë të perspektivës.

Ndërkohë në këtë Qeveri janë të ulur individë të cilët gjatë garës për pushtet kanë rritur pritjen, sidomos të rinjve nëpërmjet premtimeve që Kosovën në mandatin e tyre, nëse e marrin, do ta bëjnë vend të cilën edhe nga jashtë do të vijnë njerëz për të jetuar. Mua, ende më kujtohen ato shifrat e mëdha për vende pune, për zhvillim, për ekonomi, investime dhe investitorë nga jashtë për shkak të lidhjeve të biznesit që kanë të njëjtit që sot janë zëvendëskryeministra. Madje, kjo bëri që kryeministri Thaçi të emërojë një zëvendëskryeministër për investime. Çka po ndodh kjo? Sot krejt kjo, do të thotë, të gjitha këto premtime nuk kanë shkuar përtej hajgares së planit të Banjskos, do të thotë, as nuk po shohim investitorë, as investime, as zhvillim dhe as vende pune nga të gjitha ato premtime megalomane.

Ajo çka po shohim kohëve të fundit është që pikërisht të njëjtit kanë harruar që Kosova në fakt ka ligje dhe procedura administrative dhe kanë filluar publikisht të dalin në televizion dhe të sillen me kodin e BE-së, të bëjnë be që paratë që i kanë shpenzuar, në fakt janë të sakta dhe të kërkojnë që Qeveria t'ua kthejë. Mendoj, që kjo veç po kalon dhe po e devalvon çdo shkallë të civilizimit të mirëqeverisjes dhe të asaj se çka presin qytetarët e vendit tonë.

Ndërkohë, kemi një rritje të çmimeve, mungesa e sigurisë në vendin e punës, një politizim të skajshëm të sektorit publik dhe ikje të investitorëve dhe mungesë të investimeve. Nuk ka ndërruar asgjë sa i përket lëvizjes së lirë, madje edhe në rajon edhe pse e kemi pranuar fusnotën, nuk po shihet që kemi lehtësime në pjesëmarrjen e nismave rajonale, përkundrazi është komplikuar gjithçka më shumë.

Prandaj, është koha e fundit që Qeveria e Kosovës të reflektojë. Mendoj se rekomandimet për zbutjen e varfërisë në Kosovë duhet të shkojnë në disa drejtime. Në rend të parë, hartimi i politikave adekuate sociale që kanë të bëjnë me këto kategori të familjeve.

Ndryshimi i Ligjit për skemën e ndihmës sociale, sepse çështja e trashëgimisë, po e theksoj, dhe e pronës në Kosovë, paraqet problem në vete, të cilit duhet t'i qasemi.

Të forcohen mekanizmat dhe instrumentet politike për realizimin e objektivave makro-ekonomike, posaçërisht përmirësimi i politikave fiskale, politikave monetare, politikave të të ardhurave dhe politikave të marrëdhënieve ekonomike me jashtë. Të subvencionohen nëpërmjet formave të ndryshme të këtyre politikave, prodhuesit e ekonomive bujqësore, blegtorale, arsimore, shëndetësore, turistike, prodhuese, shërbyese dhe veprimtarive të tjera, që bëjnë gjenerimin e vendeve të reja të punës, duke u dhënë përparësi absolute në punëzënie familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, viktimave civile të luftës, rasteve sociale dhe kategorive të varfra të popullsisë.

Ndërmarrjet dhe kompanitë e tjera që punësojnë numër të konsiderueshëm të punëtorëve duhet të favorizohen dhe subvencionohen në mënyra të rregullta ligjore nëpërmjet instrumenteve politike dhe mekanizmave të tjerë institucionalë.

Të hartohet një legjislacion favorizues për investime të brendshme dhe ato të drejtpërdrejta nga jashtë dhe përtej vullnetit dhe dëshirave të mira që disa individë të lartë të Qeverisë po i promovojnë, të kemi hapa konkretë institucionalë nëpërmjet politikave institucionale, e jo marrëveshjeve ndërmjet individëve, sepse kështu nuk funksionon dhe po shihet që s'ka pasur sukses.

Krejt kjo nuk mund të ndodhë nëse Qeveria nuk e ndërron qasjen dhe fillon të mendojë për qytetarët në rend të parë, para se të mendojë për veten. Dhe, nëse kuptimi i fjalës “qeverisje moderne” të mos përkthehet bukvalisht që Kosova duhet të ketë ministra dhe ministre modernë që kanë aparencë moderne për njerëz, të cilët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Në emër të Grupit.

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Shtjellimet në tregun e karburanteve kanë nisur të marrin përmasa shqetësuese. Në vazhdimësi dëgjojmë deklarata për cilësinë e dobët të naftës, të derivateve të saja, që qarkullojnë brenda vendit, për shtrenjtimin e vazhdueshëm të tyre si dhe për dyshimet rreth sasisë së faturuar dhe asaj që i jepet blerësit.

Është shqetësuese se pohime të këtilla bëhen edhe nga individët përgjegjës për kontrollimin e cilësisë së karburanteve, përkatësisht nga laboratorët e licencuar. Ata me fakte konkrete argumentojnë se karburantet në treg janë larg prej standardeve të kërkuara. Mirëpo, kjo gjendje nuk e brengos askënd, madje as Inspektoratin e Tregut, as Ministrinë përkatëse, përkatësisht atë të Tregtisë dhe Industrisë.

Rreth këtyre zhvillimeve në treg është një çështje mjaft indikative. Meqë sipas deklaratave të përgjegjësve nga laboratorët, shumica e mostrave që janë marrë në kufi kanë rezultuar se u përgjigjen standardeve të lejuara. Ndërkaq, karburantet të themi kushtimisht, ndoten brenda vendit, mirëpo nuk dihet kush janë ndotësit, me çka përzihen karburantet si dhe përmasat e dëmeve që u shkaktohen pronarëve të automjeteve, ambientit si dhe buxhetit të shtetit.

Duhet pranuar se këtu ka dështuar inspektorati apo Ministria përkatëse, e cila nuk po tregohet vigjilente në raporte me situatën shqetësuese në këtë treg, sado që në të kaluarën ka pasur disa intervenime, përkatësisht gjobitje, po këto duket se nuk kanë mjaftuar për krijimin e rregullit dhe të rendit.

Po ashtu, ka dyshime se konsumatorëve u ofrohet sasi më e vogël e karburanteve në krahasim me atë që paguajnë, do të thotë se pronarët e pikave për shitjen e karburanteve, kanë mundësi që vetë të ndërhyjnë dhe ta rregullojnë mekanizmin për sasinë e naftës që i nxjerrin, pa marrë parasysh se ato duhet të jenë të kontrolluara nga Instituti për Metrologji. Ndërkaq, çështja e çmimeve është problem specifik dhe sipas rregullativës në fuqi është një fushë ku nuk ka mundësi për ndërhyrje. Ky është një treg i lirë ku çmimet krijohen në bazë të gjendjes në tregun ndërkombëtar, mirëpo, bursa përcillet vetëm atëherë kur duhet ngritur çmimet, por jo edhe kur ndodhë edhe rënia e tyre.

Ndërkaq emëruesi i përbashkët i të gjitha këtyre problemeve është mos efikasiteti i Administratës Tatimore në Kosovë, për fiskalizimin e pikave për shitjen e karburanteve. Ajo vazhdimisht arsyetohet për procedurat, për licencimin dhe patentimin e aparaturës përkatëse, por sa duhet të zgjasë kjo procedurë, nuk ka afate të caktuar, që edhe kjo fushë ku brenda vitit qarkullojnë 300 deri 400 milionë euro, të jetë nën vëzhgimin e Autoritetit Fiskal të Kosovës.

Ndërkaq, në fiskalizimin e pompave të benzinës do të eliminoreshin shumë parregullsi. Sa për ilustrim po përmend rastin e Maqedonisë, ku përmes fiskalizimit të këtij sektori kanë zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me sasinë e karburantit që i shërbehet dhe çmimin e tij. Këtë e rregullon arka fiskale e cila nuk pranon asnjë ndërhyrje me qëllim të rregullimit të sasisë apo çmimit sipas dëshirës së shitësit, nëse tentohet për ndërhyrje atëherë bllokohet i tërë sistemi.

Njëkohësisht propozoj që të ndërmerret iniciativa për ndryshimin e mënyrës për formimin e çmimeve, madje këtë çështje në të ardhmen mund ta imponojë aplikimin e një arke fiskale në këtë sektor. Nuk insistoј për rregullimin centralist të çmimeve apo mbajtjen e tyre nën kontrollin e mekanizmave të shtetit. Mirëpo, në rajon ka modele të ndryshme për formimin e çmimeve: Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina apo Mali i Zi, kanë mekanizma rregullues të çmimit, qoftë si autoritete të pavarura apo si trupa profesionale që veprojnë brenda Ministrisë së Financave.

Në të shumtën e rasteve korrigjimi i çmimeve bëhet dy herë në muaj, me këtë rast merren parasysh lëvizjet në bursën ndërkombëtare, parashikimet afatshkurtra për zhvillimin në tregun e karburanteve, raporti i dollarit me euron apo me valutat domiciele, si dhe specifikat që ka tregu vendor i karburanteve. Në bazë të këtyre parametrave, kalkulohet çmimi, me të cilin nuk dëmtohet asnjë pjesëmarrës në treg, as importuesi, ai distributori, as konsumatori e as buxheti i shtetit. Falemnderit!

KRETARI: Falemnderit! Deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Shefja e Grupit Parlamentar e Koalicionit për Kosovën e Re,

Përshëndetje për të gjithë,

Duke marrë parasysh prononcimet të cilat bëhen pa fakte në Kuvendin e Kosovës, duhet të jepen sqarime shumë të qarta për informacione të cilat përgatiten në salla të partive politike që të keqpërdoren mediet dhe në sallat në të cilat drejtorët financiarë jepen shifrat alarmante për njerëz të cilët nuk kanë marrë të holla nga buxheti i Kosovës.

Duhet të ketë argumente secili nga ju në rast se do të flasë për një person apo një zyrtar të lartë, për arsye se njerëzit të cilët i kanë ndihmuar Kosovës nuk duhet të keqpërdoren në favor të fushatës politike, e cila mund të japë sqarime vetë partia në fjalë që bën fushatë politike kundër zëvendëskryeministrit të parë, nga i vijnë paratë që financohen vetë ato parti politike. Ju falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më 1, 2 dhe 3 maj është mbajtur manifestimi tradicional “Ditët e Agimit” e Agim Ramadanit në Zhegër. Ne kemi pasur shumë vërejtje në fakt nga qytetarët për shkak se atë rrugë e përshkon një rrugë regjionale e cila është bërë si rruga e dikurshme e Kukësit, me dallimin se ajo nuk është një rrugë me leqe. Njerëzit janë ndier shumë keq, janë irrituar nga ajo gjendje që ka qenë edhe kanë kërkuar që të ndërmerret diçka nga institucionet tona që kjo gjendje të përmirësohet për faktin se ata kanë defekte në makina dhe nuk janë të interesuar që të investojnë dy herë. Domethënë, një herë të investojnë në taksa që ata i paguajnë për ato rrugë dhe herën tjetër për makinat të cilat jashtëzakonisht kanë shumë defekte.

Unë kam qenë në fakt në Ministri dhe jam interesuar disa herë që ajo ta trajtojë këtë problem, por ajo përherë ka dhënë një përgjigje të papërcaktuar. Në fakt, në një pyetje që i është bërë këtu ministrit për këtë çështje, për kriteret që i përdor kjo Ministri për t'i caktuar prioritetet me të cilat kjo i përcakton projektet, në fakt ministri ka dhënë një përgjigje shumë korrekte dhe ato kriteret janë kriteret evropiane që nuk mund të zbatohen te ne për shkak se ende nuk kemi ndonjë rrugë të certifikuar në bazë të standardeve të Bashkimit Evropian.

Unë kërkoj nga ministri që ta trajtojë këtë problem me prioritet, me qëllim që njerëzit të ndihen rehat kur kalojnë në atë rrugë. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Falemnderit, kryetar!

Monitorimi i vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria është esenciale, pasi që ekziston mundësia e keqtrajtimit, madje edhe torturës. Personat e privuar nga liria kanë ndikim shumë të kufizuar në fatin e tyre dhe tërësisht varen nga autoritetet që duhet t'u garantojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre.

Mirëpo, këto autoritete jo që nuk u mbrojnë të drejtat, ashtu siç paraparë edhe me konventat ndërkombëtare, por shkelësit më të mëdhenj të tyre janë vetë këto autoritete.

Kohëve të fundit janë raportuar keqpërdorime në qendrat e paraburgimit, ku janë paraqitur raste të vjedhjeve të gjësendeve personale të të burgosurve të lëna depozitë.

Mandej ka shumë ankesa nga vetë të burgosurit, por edhe punonjësit sa i përket kujdesit shëndetësor, mungesës së barnave esenciale, mungesë higjienë, deri në masën ku ndërrimi i çarçafëve të krevateve nuk bëhet deri në gjashtë muaj. Po ashtu, edhe hapësirat ku të burgosurit e vuajnë dënimin, janë të mbipoplluara.

Shqetësim tjetër paraqitet edhe trajtimi apo diskriminimi ndaj të burgosurve sa i përket të drejtave të tyre për pushime vikendesh apo edhe afatin kohor të përfundimit të paraburgimi e të shlyerjes së dënimeve. Ka raste kur të burgosur lirohen më herët sesa masat e parapara për paraburgim dhe raste kur ata mbahen me shumë sesa që i është shqiptuar masa e paraburgimit.

Se deri në çfarë niveli është degraduar situata brenda këtyre institucioneve tregon edhe fakti i keqpërdorimeve brenda vetë institucionit dhe asaj që nuk ka të bëjë direkt me të burgosurit, por që menaxhmenti i këtij institucioni përfiton në emër të të burgosurve. Akoma më banale janë dëshmitë, raportimet dhe filmimet ku paraqiten punonjësit duke vjedhur si brenda ashtu edhe jashtë këtij institucioni dhe krejt çka është ndërmarr ndaj këtyre keqpërdorimeve dhe personave, kanë qenë suspendimet për një periudhë të shkurtër kohore dhe prapë të njëjtë persona janë kthyer në vendet e tyre të punës, duke iu ndërruar kështu vetëm sektori.

Por, pse ndodhi e gjithë kjo? Në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, kemi lidhje familjareve të të punësuarve nga drejtori e deri te pastruesi e kuzhinieri. Një pjesë e këtyre të punësuarve janë vetëm me shkollim fillor, e të tjerët, e kaluara e të cilëve është tejet e dyshimtë. Ka raportime kur vetë oficeret e këtij institucioni janë të kërcënuar nga menaxhmenti me largim nga puna, apo kërcënime të ndryshme për te gjithë ata që paraqesin shqetësimet e tyre apo japin intervista për media të ndryshme në lidhje me keqpërdorimet, shantazhimet, trajtimet e të burgosurve apo denoncimet e rasteve të korrupsionit.

Nga kjo që u tha më lart shihet qartë se leksioni i Ministrit të Drejtësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i dhënë disa muaj më parë, nuk është shoqëruar me veprime për të përmirësuar gjendjen kaotike në burgjet e Kosovës, me çka ministri nuk po i mbron të drejtat e qytetarëve të Kosovës që vuajnë dënimin...

KRYETARI: Falemnderit! Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kosova është e përfshirë nga një valë vetëvrasjesh që shumica e tyre janë si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike.

Një kategori posaçërisht që po përballët me këtë fenomen janë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këtë javë në Rahovec edhe një ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bëri vetëvrasje, për arsye ekonomike dhe sociale, sipas të gjitha gjasave.

Shumica e udhëheqësve të shtetit janë kolegë të ushtarëve të vetëvrasarë. Kryeministri ka qenë drejtor politik, komandantët e zonave sot shumica janë kryetarë të komunave apo deputetë të Parlamentit të Kosovës, por edhe udhëheqës të agjencive të ndryshme shtetërore.

Shtrohet pyetja: Nëse udhëheqësit e UÇK-së nuk kanë asnjë konsideratë për ish-kolegët e tyre të idealit, kush mund të ketë konsideratë për këtë kategori? Sa herë që vijnë zgjedhjet flisni me madhështi për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shokët e vrasarë, por të gjallët shpeshherë i nënçmoni dhe i katandisni në varfëri deri në vetëvrasje.

Për vetëvrasjen e ish- ushtarëve dikush duhet të ketë përgjegjësi, ju bie më së shumti juve ish- udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që në fakt ju udhëhiqni me shtetin e Kosovës për të vetmen arsye se keni qenë udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nëse mendoni se nuk keni përgjegjësi, atëherë po ja përkujtoj dhe po ju bëj pyetje: Ku është Ligji për veteranët? Pse janë fryrë listat e veteranëve, pse veteranë i keni bërë familjarët, shokë e nipa që kurrë s'kanë qenë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e luftën e UÇK-së e kanë parë nga diaspora dhe nga rivierat bregdetare. E për këtë arsye veteranët s'po mund t' i gëzojnë benificionet që i meritojnë.

KRYETARI: Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër, anëtarë të Qeverisë,
Kolegë deputetë,

Dola për të shtruar dy çështje që e kanë të njëjtën temë.

Çështja e parë është, dëshiroj ta informoj Kuvendin e Kosovës se Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës e ka filluar mandatin në bazë të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, në përmbyllje të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. Tani më ne si Komision kemi bërë një plan të veprimit dhe kemi filluar diskutimin e ligjeve një nga një, mund të themi që i kemi përfunduar 5 ligje. Është një pako prej 21 ligjeve, e sponsoruar nga Qeveria, të cilën Komisioni e ka marrë ta përgatisë për miratim në seancë.

Ne gjithashtu kemi bërë edhe harmonizimin kohor të këtij aktiviteti, sepse ky harmonizim do të kërkojë edhe ristrukturim pakë edhe të seancave parlamentare, për shkak se mendohet se gjatë muajit korrik të bëhet leximi i parë i këtyre ndryshimeve legjislative, kurse në fillim të shatorit mendohet që këto të hynë në leximin e dytë, ndërkohë, në proces janë edhe amendamentet kushtetuese që do t'i japin fund përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrtur dhe ato aktualisht janë në Gjykatën Kushtetuese dhe së shpejti pritet të vijnë dhe të përgatiten për seancë plenare.

Çështja e dytë që dëshiroj të sqaroj është fjala që javën e kaluar disa deputetë kanë nënshkruar një pako të amendamenteve dhe kanë deklaruar - nuk e kemi ditë çka kemi nënshkruar. Dola për t'ju treguar se çka kanë nënshkruar, sepse nuk është mirë deputeti të deklarojë - unë e nënshkrova, por s'dita çka nënshkrova.

Si kryetar i Komisionit më duhet t'ju shpjegoj këtyre deputetëve që s'kanë ditë çka kanë nënshkruar, ata me të vërtetë kanë nënshkruar amendamentet e Komisionit Kushtetues, të cilat Komisioni i ka hartuar mbi bazën e punës së suksesshme njëvjeçare, një punë që është vlerësuar shumë në opinion, një punë profesionale. Por në këtë pako janë përfshirë 3 dispozita brenda amendamenteve, asnjë amendament i ri, por tri dispozita të reja për të cilat fatkeqësisht Komisioni nuk ka pasur konsensus në mbledhjen e fundit dhe në ndërkohë lidhshipi i vendit i ka harmonizuar ato tri çështje dhe ato tri çështje janë tri dispozita brenda amendamenteve kushtetuese. Nuk duhet lejuar iluzion që janë bërë amendamente të reja, jo, janë bërë amendamente të njëjta të Komisionit Kushtetues, janë bërë tri dispozita që flasin për të drejtën e vetos së presidentit, që flasin për autoritetin e presidentit për të emëruar kryeshefin e Agjencisë së Inteligjencës dhe çështjen e gjyqtarëve, nuk është ndërruar substanca e 11 amendamenteve që ne kemi dorëzuar, por janë futur 3-4 rreshta që e plotësojnë këtë amendamente dhe ne urojmë që Gjykata Kushtetuese mos të marrë edhe dy muaj kohë, por ne urojmë që Gjykata Kushtetuese tani më gati e ka të përfunduar vlerësimin, sepse ka dy muaj që e ka pakon e amendamenteve dhe ta rikthejë pakon e amendamenteve me vlerësimin pozitiv, sepse këto amendamente në asnjë shkronjë të saj nuk prekin kaptinën për lirinë dhe të drejtat e njeriut, në mënyrë që Kuvendi pastaj të ushtrojë autoritetin kushtetutdhënës, t'i marrë në diskutim dhe në shqyrtim këto...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kemi përfunduar kohën e paraparë prej 30 minutash për deklarime jashtë rendit të ditës. Për seancën e radhës kanë mbetur dy deputetë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta, deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Fillojmë me deputetin e parë, Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Deputeti nuk është këtu.

Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputete e ke fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Buja,

Nëpër disa shkolla fillore dhe të mesme, në kuadër të hapësirës shkollore ekzistojnë ambulancat shëndetësore. Pyetja ime është- Cilat kritere i ka përdorur Ministria juaj për t'i hapur këto ambulanca, kur dihet se hapja e ambulancave është detyrë e Ministrisë së Shëndetësisë e jo e Ministrisë së Arsimit?

KRYETARI: E ke fjalën ministër.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Breca,

Në bazë të Ligjit për arsimin parauniversitar të Kosovës, neni 7, kompetencat shtesë për komunat, pika 3.3 sqaron se komunat në bazë të Ligjit për vetëqeverisje komunale, numër 303/L-040, të datës 20 shkurt 2008 dhe Ligjit për arsimin në komuna, numër 03/L-068 të datës 21 maj 2008, janë të obliguara për sigurimin e një ambienti të shëndetshëm duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjienike, sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambientin e sigurt për nxënësit dhe personelin duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe sigurinë fizike efektive.

Nëse sipas Ligjit për shëndetësi numër 2004/4, aktin e themelimit të institucionit shëndetësor e nxjerr Ministria e Shëndetësisë, që ju keni të drejtë. Në bazë të të dhënave të marra nga drejtoritë komunale të arsimit, vërtet, në kuadër të hapësirës shkollore nuk ambulanca shëndetësore. Në disa nga komunat ambulancat ekzistojnë në afërsi të

shkollave, mirëpo funksionojnë si Qendra të Mjekësisë Familjare dhe janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë, kurse disa ambulanca janë në funksion që nga periudha e paraluftës dhe kanë mbetur në hapësirat shkollore në një dhomë mësimi. Por, këto ambulanca ekzistojnë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, në nivelin lokal, Drejtoria komunale e shëndetësisë dhe të gjitha shërbimet kryhen në bazë të ligjeve ekzistuese në fuqi, Ligjit për shëndetësi dhe Ligjit për arsimin parauniversitar dhe gjithë kjo bëhet në bashkëpunim të dy drejtorive komunale të arsimit dhe atij të shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë? E ka fjalën Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Falemnderit!

Unë lirisht mund të ju them se këto ambulanca aspak nuk janë në kompetencë të drejtorive komunale të shëndetësisë, sepse nuk menaxhohen edhe punëtorët që punojnë aty janë një farë mënyre të diskriminuar, se në asnjë procedurë nuk mund të marrin pjesë se ata nuk janë as punëtorë të arsimit, e as nuk janë punëtorë të shëndetësisë, kjo është një. Nuk marrin pjesë as në proceset e edukimit të vazhdueshëm profesional edhe pagat i kanë më ulët se punëtorët shëndetësorë tjerë, që janë nëpër qendra të mjekësisë familjare. Se pari, kjo nuk është në kompetencë të komunave.

Së dyti këto as për së afërmi s'i plotësojnë kriteret për të ekzistuar si ambulancë, se ambulanca nuk punon vetëm me një mjek, por duhet ta ketë edhe stafin tjetër ndihmës, përpos kësaj duhet ta ketë inventarin, pajisjet edhe materialet e tjera me të cilat do t'u afronte shërbime nxënësve në rast nevojë. Kjo është edhe kundër politikave shëndetësore për shkak se ..

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje shtesë?

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuara deputete,

Ju nuk kishit pyetje por ato që thoni gjithsesi është prezent një dukuri e tillë, por tash për t'ju dhënë një informacion plus, domethënë për gjendjen si është nëpër komuna në bazë të informacioneve që kemi, ta zëmë në komunën e Prishtinës në disa shkolla, ambulancat ekzistojnë që paraluftës të cilat paguhen nga buxheti i komunës, po them të dhënat që i posedoj.

Në Gjakovë në disa shkolla ka shërbime stomatologjike, por funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, por në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë.

Në Gjilan në dy shkolla afrohen shërbime stomatologjike në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë. Në Pejë në shkollën "Xhemajl Kada", ta zëmë, që tetë muaj është aktivizuar ambulanca e cila është hapur në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë, që paguhen nga buxheti i arsimit të komunës. Në Prizren, në shkollën e qytetit ekzistojnë stomatologë të cilët paguhen nga Drejtoria Komunale e Shëndetësisë. Kjo është një gjendje, një pasqyrë plotësuese nga ajo që the, është e vërtetë që kjo do të duhej të shihet në mënyrë të veçantë për të rregulluar. Falemnderit, shumë!

KRYETARI: Falemnderit, ministër! Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ramë Buja.

NAZANE BRECA: Falemnderit!

I nderuar zoti ministër,

Drejtorët e shkollave gjysmë orari duhet të punojnë si menaxherë, e gjysmë orari duhet të punojnë si profesionistë. Cili ligj do të aplikohet për ta, ai i shërbyesve civilë apo ai i arsimit?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Falemnderit, edhe një herë e nderuara deputete!

Drejtorët e shkollës, sipas nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës janë shërbyes civilë dhe ky ligj aplikohet ndaj tyre.

Gjithashtu me Ligjin e ri për arsim parauniversitar nuk parashihet që drejtori duhet të ketë gjysmë orari udhëheqjeje e gjysmë orari mësimdhënie.

Një sqarim plotësues. Para se këto ligje, domethënë, Ligji për shërbimin civilë dhe Ligji për arsim parauniversitar, të hynë në fuqi kjo çështje ka qenë e rregulluar me Udhëzimin administrativ 04/2003, të datës 29.1.2003, në nenin 6.6.13 thuhet se drejtori kryen detyrat e tjera të caktuara nga MASHT dhe komuna. Në shkolla ku ka më pak se 250 nxënës, drejtori duhet të mbajë së paku 10 orë në proces mësimor, por ky udhëzim administrativ numër 04/2003 është shfuqizuar me Udhëzimin administrativ 18/2004, të datës 23.6.2004 dhe me Ligjin për arsimin parauniversitar dhe tani kjo është e ditur që ata në bazë të Ligjit për shërbimin civil duhet të trajtohen.

KRYETARI: Deputete, pyetje shtesë?

NAZANE BRECA: Prapë këtu disa gjëra nuk janë të qarta edhe unë mendoj se këto gjëra duhet të sqarohen në ligjet bazë. Edhe një herë tregoj se ligjet ndërmjet veti nuk harmonizohen si duhet edhe ju si ministri jeni ata që duhet t'i inicioni amendamentet në mënyrë që të vijë deri te harmonizimi i ligjeve e mos të kemi mandej probleme, domethënë, në praktikë që nuk dihet mandej me cilin ligj. Me udhëzime administrative, ndoshta sqarohen disa nene që janë bazike, domethënë në ligjin bazë, mirëpo vetëm me udhëzime administrative nuk rregullohen këto punë. Falemnderit!

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje?

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar, mbase se më ke keqkuptuar- thashë se është fuqizuar gjithçka çka ka qenë në veprim paraprakisht me udhëzimet administrative të caktuara, por kjo i ka dhënë fund udhëzimeve administrative, Ligji për shërbimin civil ose për shërbyesit civilë dhe tash ata trajtohen në bazë të Ligjit për shërbimin civil ose shërbyes civilë. Kështu që nëse do të duhej iniciuar këtë gjë gjithsesi mund ta iniciojmë ne, por ligji është ligj dhe ne e respektojmë këtë që është tash në fuqi kështu si është. Falemnderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi, pyetje për ministrin Mujota.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar,
I nderuar ministër,

Këtë pyetje e kam ngritur në bazë të shqetësimeve të mëdha që kanë shoqëritë transportuese në Kosovë, të cilat nuk ekzistojnë fare dhe duke parë që rrugëve të Kosovës dhe pikat kufitare të Kosovës i defilojnë shumë transportues ndërkombëtarë e asnjë transportues me regjistrim KS. Desha ta pyes ministrin- Sa është duke u angazhuar që të stimulojë ndërtimin e shoqërive transportuese- a ka të nënshkruara marrëveshje me shtetet për lehtësira të transportit dhe a është duke komunikuar me ministrin e Financave për lehtësira fiskale në mënyrë që shoqëritë transportues të organizohen?

KRYETARI: Ministër Mujota, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Falemnderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,
Anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,
Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Kelmendi,

Çështja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtetet tjera është një nga prioritetet e Ministrisë së Infrastrukturës e natyrisht që konsiderojmë se deri tash është arritur një progres i mirë me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve, por që ka diskutim në çështjen e zbatimit të këtyre marrëveshjeve në disa vende.

Unë po përmend radhazi vendet me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit dhe funksionimi i tyre.

Me Republikën e Shqipërisë marrëveshja është nënshkruar në gusht të vitit 2011, është dekretuar nga presidentja e Republikës së Kosovës, në shtator të vitit 2011, marrëveshja po zbatohet pa vështirësi të caktuara, ndërkohë që gjatë këtij muaji do të ketë takime të komisioneve teknike për një analizë më të hollësishme të zbatimit të marrëveshjes.

Marrëveshjet të cilat janë nënshkruar dhe funksionohet mirë relativisht janë marrëveshjet të bashkëpunimit me Këshillin Federal të Zvicrës, marrëveshja e bashkëpunimi me Mbretërinë belge, marrëveshja e bashkëpunimit me Republikën e Turqisë, marrëveshja e bashkëpunimit me Republikën e Kroacisë. Në të gjitha këto shtete nuk ka vështirësi të caktuara në realizimin e marrëveshjeve të nënshkruara.

Me Republikën e Bullgarisë, marrëveshja është nënshkruar dhe është dekretuar nga ana e presidentes së Republikës së Kosovës, por ka probleme në zbatimin e kësaj marrëveshje, pasi që ende nuk është bërë ratifikimi nga ana e Parlamentit të Republikës së Bullgarisë. Këtë shqetësim e kam ngritur drejtpërsëdrejti në nivel ministri në raport me Ministrinë e Punëve të Jashtme këtu në Kosovë, për të ngritur shqetësimin në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bullgarisë dhe shpresojmë që ministri i Jashtëm dhe ambasadori ynë në Sofje, do të mund të ndihmojnë që autoritetet bullgare të bëjnë ratifikimin e kësaj marrëveshje

në mënyrë që transportuesit tanë të mos jenë të dëmtuar. Personalisht e kam ngritur këtë shqetësim dhe do të autorizoj një grup teknikë punues për të parë se pse nuk e zbaton ose nuk e ratifikon këtë marrëveshje Republika e Bullgarisë.

Po ashtu kem edhe një numër të caktuar të draft-marrëveshjeve që janë diskutuar dhe përafuar për nënshkrim me disa shtete. Po përmend këtu Austrinë, marrëveshja është e trajtuar nga komisione teknike, nuk ka ndonjë çështje problematike dhe po punojmë sa më parë ta nënshkruajmë këtë marrëveshje.

Po ashtu me Malin e Zi, marrëveshja është përgatitur dhe presim ta nënshkruajmë shpejt, sot saktësisht komisionet ndërminstrore punojnë që kjo marrëveshje përafrohet dhe të caktohet data e nënshkrimit.

Me Slloveninë, marrëveshja është në fazën përfundimtare dhe pritet nënshkrimi i saj, nuk ka probleme në transport ndërmjet dy vendeve.

Me Maqedoninë, marrëveshja është dialoguar, por nuk është finalizuar për arsye të disa detajeve teknike që lidhen me transportin për dhe në vendet e treta. Shpresoj që në takimin e radhës dhe për ko incidencë sot do të kemi takim pune, do të diskutohet kjo çështje dhe çështje e tjera, në mënyrë që transportuesit tanë të mos jenë të dëmtuar në raport me transportuesit e shteteve tjera.

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

RAMIZ KELMENDI: Kam edhe një pyetje në lidhje me Portin e Shëngjinit. A ka filluar realizimi i ndonjë projekti të përgjithshëm apo ndërtimi i infrastrukturës, lokacionit në mënyrë që investitorët kosovarë të mund t'i qasen kërkesave për ndërtimin e objekteve në Portin e Shëngjinit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Falemnderit, i nderuar deputet!

Kjo është pyetja e dytë që kam marrë nga ana juaj,

Ju falënderoj për çështjen që keni parashtruar dhe unë dua ta informoj Parlamentin, natyrisht dhe publikun se disa vjet më herët ka qenë një vullnet dhe gatishmëri politike e dy qeverive, asaj të Tiranës dhe Prishtinës, natyrisht Qeveria e Tiranës ka afuar në shërbim, Portën e Shëngjinit dhe nga atëherë dhe deri tani mund t'ju them që nuk ka pasur ndonjë marrëveshje të nënshkruar dhe zbatimi i kësaj marrëveshje ka pasur pastaj sigurisht vështirësitë e veta, meqë në start nuk ka ndodhur marrëveshje me shkrim. Sidoqoftë, grupet profesionale kanë bërë vlerësime dhe analiza të shumta për Portën e Shëngjinit, është një projekt i mirë edhe strategjik edhe ekonomik, por është më tepër projekt që i takon të ardhmes, sepse në bazë të studimeve që janë bërë, ka çmim jashtëzakonisht të lartë, përgatitja e infrastrukturës së Portit të Shëngjinit dhe duke pas për bazë edhe Portin e Durrësit, që tash për tash jep shërbime të mëdha për Kosovën, ndërtimi i autostradës që ka shkurtuar kohën e qarkullimit të transportuesve dhe natyrisht të mallrave, atëherë mund të themi se deri tash nuk ka pasur ndonjë përparim të theksuar

në drejtim të shfrytëzimit të Portit të Shëngjinit sipas atij deklarimi dhe gatishmërie politike.

Për më tepër dua të potencoj edhe një vështirësi shtesë që në adresë të Ministrisë së Infrastrukturës kanë arritur shumë shkresa nga pretendues të tokave dhe hapësirave për rreth Portit të Shëngjinit, të cilat kërkojnë edhe çështje të zgjidhjeve gjyqësore. Prandaj, deri tani nuk mund të flitet për ndonjë përparim të theksuar dhe mbetet në dorën e biznesmenëve për të pasur projekte më të detajuara drejt shfrytëzimit të Portit të Shëngjinit, tash.

KRYETARI: Falemnderit, ministër!

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi pyetje për kryeministrin, zotin Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. Deputete, a doni ta bëni pyetjen? Atëherë, falemnderit!

Deputetja, Alma Lama, pyetje për ministren Vlora Çitaku.

Deputete, e ke fjalën.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar!

Në bazë të një studimi të bërë nga UNICEF, i cili është fokusuar tek fëmijët e riadhesuar nga Gjermani dhe Austria, situata në të cilën po jetojnë këta fëmijë në Kosovë është alarmante, traumatike, vuajnë nga depresioni, stresi postraumatik. Shteti i Kosovës, me gjithë se ka ndarë një fond prej 3.4 milionë eurosh deri tani nuk u ka ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve dhe familjeve të cilat i përkasin më së shumti komunitetit rom. Nga ana tjetër riintegrimi i këtyre personave vazhdon të mbetet kushti kryesor për procesin e liberalizimit të vizave. Prandaj, përse Ministria që drejtoni ju, zonja Çitaku si bartëse e këtij procesi nuk merr masa të nevojshme në mënyrë që fondi i ndarë të shfrytëzohet, qoftë për ndërtime shtëpish, për kurse gjuhës dhe trajnime profesionale? Bilanci i vitit 2011 është tepër negativ. Falemnderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Falemnderit, shumë!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë ministra,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete Lama,

Para së gjithash, dua të ju njoftoj që bilanci, në fakt, i procesit të riintegritit të personave të riadhesuar, është pozitiv. Sikur të ishte bilanci negativ, misioni vlerësues i Komisionit Evropian dhe vendeve anëtare që ka qëndruar dy herë brenda vitit të kaluar në Kosovë, nuk do të kishte dhënë rekomandimin pozitiv për nisjen zyrtare të dialogut për liberalizimin e vizave dhe udhërrëfyesi, i cili pritet të vijë brenda pranverës nuk do të merrej vendimi, as për të nuk do merrej vendimi pozitiv. Megjithatë, ju e dini që procesi i riintegritit të personave të riadhesuar është një proces shumë kompleks, është një proces shumë sfidues edhe për vendet me sistem të etabluar të skemave sociale e lerë më për Kosovën e cila paralelisht është dashur të merret me shumë procese. Megjithatë, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera, kanë ndërtuar mekanizmat institucional, infrastrukturën ligjore dhe kanë ndarë buxhet të mjaftueshëm për t'i adresuar sfidat e procesit të riintegritit.

Jo më shumë se disa javë më parë revista “Ekonomist”, ka bërë një vlerësim të zyrave rajonale për integrimin e personave të riatdhesuar, në bazë të atij raporti Kosova rangohet më së larti në këtë fushë.

Gjithsesi ne kemi shumë sfida, ne jemi të vetëdijshëm që ende ka shumë për të bërë, mirëpo ju i referoheni një dokumenti i cili është hartuar vitin e kaluar e ne brenda një viti ndërmarrë edhe hapa tjerë për të adresuar sfidat që dalin nga procesi i riintegrit të personave të riatdhesuar.

Ne kemi një buxhet prej 3.4 milionë eurosh në dispozicion dhe deri më tani janë zotuar një milion e 428 mijë e euro. Normalisht që ne duhet të bëjmë edhe më shumë, por ju duhet të dini që ndarja e mjeteve nga ky fond nuk mund të bëhet në mënyrë arbitrare nga ana e bordit ekzekutiv, ajo bëhet mbi bazën e projekteve që vijnë tek ky bord, i cili udhëhiqet nga Ministria e Punëve të Brendshme, jo nga Ministria e Integrimeve Evropiane, por unë për hir të respektit e mora detyrën të përgjigjem për këtë pyetje.

Unë personalisht kam vizituar vitin e kaluar të gjitha komunat, nga dy herë, kam takuar secilin udhëheqës të Zyrës për Kthim dhe Komunitete, që e kanë edhe përgjegjësinë për adresimin e sfidave në fushën e riintegrit të personave të riatdhesuar dhe unë ju siguroj që një...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Po, falemnderit!

Zonja Çitaku, ju jeni bartëse e procesit të liberalizimit të vizave dhe prandaj ju kam drejtuar pyetjen juve. Nuk e di nëse nuk ju duket serioz ky raport, ky është raport i UNICEF-it, Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe në fakt është studim, është më shumë se sa raport. Dhe të dhënat të cilat përfshihen këtu janë këto. Unë nuk do bëj komentet e mia do t'i citoj vetëm të dhënat, thotë: Deri në fund të vitit 2011, pra deri më 31 dhjetor, Fondi i Qeverisë së Kosovës për Integrim, prej 3.4 milionë euro të shpenzuar në masën 9.3% sipas këtij raporti as edhe një shtëpi nuk është ndërtuar për familjet e riatdhesuara që janë në nevojë. Nga Fondi prej 440 mijë eurosh të dedikuara për të përmirësuar qasjen në shërbimet shëndetësore, Qeveria e Kosovës ka shpenzuar vetëm 116 euro, asnjë centë nuk është shpenzuar për kushtet e mësimin të gjuhës ose në trajtimin e mësuesve në aspektin psikologjik si t'i trajtojnë këta fëmijë. Ndërkohë ju keni thënë të kundërtën gjatë gjithë kohës që keni raportuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministre, vazhdoje fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit, shumë deputete Lama!

Unë sinqerisht nuk besoj që ne do të kishim mund të marrim vlerësim pozitiv nga ana e Komisionit Evropian dhe nga ana e zyrtarëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian,

për punën në procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar, sikur gjendja të ishte aq e zezë, siç e prezantoni ju. Ai raport i referohet një periudhe kohore para një viti, ndërkohë që tani unë ju njoftoj që Bordi Ekzekutiv ka miratuar 7 kërkesa për ndërtimin e shtëpive, 19 kërkesa për renovim të shtëpive, 120 persona të riatdhesuar janë strehuar në strehim të përkohshëm, 367 persona kanë përfutur nga skema për qiradhënie për periudhën 12-mujore, 152 kërkesa janë miratuar për furnizim me dru dhe ngrohje, 40 kërkesa janë miratuar për fillim biznesi dhe gjenerim punësimi, 39 kërkesa për trajtim mjekësor si dhe kërkesa tjera të cilat i kam të detajuara dhe dua t'i sjell me shkrim.

Bordi Ekzekutiv ka përmirësuar jashtëzakonisht nivelin e punës dhe angazhimit dhe unë ju siguroj që gjendja tani nuk mund të krahasohet me atë çfarë ka qenë në fillim të vitit të kaluar. Ju e dini që ne vetëm në vitin 2010 e kemi miratuar strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe kjo është një sfidë me të cilën kemi filluar të merremi së fundi.

KRYETARI: Vazhdojmë për pyetjen e fundit. Deputetja, Alma Lama, pyetje për ministrin Ramë Buja.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe një herë theksoj, ky ishte raport që përfshin periudhën deri në fund të vitit 2011. Më vjen mirë nëse ka zhvillime pozitive për këtë vit.

Pyetje për ministrin Ramë Buja.

Zoti Ministër, Ministria e Arsimit aktualisht ka caktuar një grup punues për të hartuar Projektligjin për veprimtari kërkimore- shkencore, mirëpo mbetet e paqartë se mbi çfarë kriteresh është krijuar ky grup pasi vetë punonjësit shkencorë nuk kanë asnjë ide se çfarë po bën ky grup? Grupet e interesit ndihen të përjashtuar, këto janë profesorë universitar dhe kërkues të tjerë shkencë dhe ligji në fjalë lidhet pikërisht me punën e tyre. Përse, Ministria e juaj nuk bënë transparencën e nevojshme dhe nuk i fton grupet e interesit të thonë fjalën e tyre në lidhje me projektligjin gjatë fazës së hartimit. Falemnderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Lama,

Më besoni ato që i thatë nuk qëndrojnë, për faktin që janë konsultuar të gjitha grupet e interesit siç thoni ju dhe tash raportimi që është bërë në Bruksel nga të gjitha komisionet tona të brendshme, është bërë vetëm një sugjerim krejt kozmetik që të shihet edhe një herë ky ligj dhe të bëhet ajo që duhet bërë përndryshe është shumë përmbajtjesore, por duhet të ju them edhe saktësi tjera.

Ministra e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë në fillim të këtij viti e ka formuar Komisionin për rishikimin e Ligjit për veprimtari shkencore. Në kohën e konstituimit të Komisionit, të institucioneve të arsimit të lartë, instituteve shkencore dhe Akademisë së

Shkencave dhe Arteve të Kosovës u është kërkuar me shkrim që t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre në grupin punues.

Në këtë formë, komisioni është përbërë nga një përfaqësues i Universitetit të Prishtinës, nga një përfaqësues i të dy institucioneve kërkimore-shkencore, Institutit Albanologjik dhe të Historisë, një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe pesë përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Pas hartimit të draftit, i njëjti u është dërguar sekretarive të universiteteve publike, me qëllim të shpërndarjes elektronike të dokumentit të i tërë stafi, instituteve dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ku është kërkuar që të jepen vërejtjet dhe sugjerimet e nevojshme. Gjithashtu, janë ftuar përfaqësuesit e universiteteve dhe instituteve dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë privat në takime të veçanta në MASHT, me qëllim të dhënies së sugjerimeve dhe propozimeve të tyre.

Në draftim janë konsultuar edhe ekspertët austriakë të projektit “HIGH-KOS”, të cilët kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, të cilat ne i çmojmë. Në takimet me Universitetin e Prishtinës kanë marrë pjesë katër profesorë universitarë, të cilët nuk kanë dhënë asnjë vërejtje apo sugjerim të caktuar. Kurse, institutet dhe institucionet e arsimit të lartë privat, vërejtjet e tyre i kanë dërguar edhe në mënyrë elektronike.

Draftligji po ashtu ka qenë online në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit për një afat prej 15 ditësh dhe të gjithë të interesuarit kanë pasur mundësi që deri më 25 prill t'i dërgojnë të gjitha komentet që ata i kanë menduar se mund t'i bëjnë me vërejtje dhe sugjerime, që janë konsideruar gjithmonë. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Falemnderit! Deputete, pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Zoti ministër,

Grupi punues përbëhet vetëm nga punonjës të Ministrisë së Arsimit. Këto informacione, që do t'i lexoj tani, i kam marrë nga sekretari juaj permanent, Isni Kryeziu - MASHT, Ukë Osmanaj - MASHT, Mensur Neziri - MASHT, Haki Sfishta - MASHT, Ferid Idrizi - MASHT, Ministria juaj e Arsimit.

Nuk i keni respektuar kriteret, as profesionale, dhe pyetja që do të ju bëj tani është, pse në këtë komision nuk është asnjë grua? Duket që diskriminimi në veprimtarinë shkencore fillon që në hartimin e ligjit. A keni përgjigje për këtë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: Më besoni, e nderuar deputete, nuk jam marrë me çështjet gjinore dhe këtu mund të jetë faji. Por, se me kriteret shkencore dhe bëj kriteret profesionale, po e po, dhe ata njerëz që i përmende nga këto institute janë të pranishëm dhe unë ju thashë se cili është proporcioni. Ju lutem, a po flasim si në odë, apo si po e bëjmë këtë gjë? Po, ju lutem! Ju e bëtë pyetjen dhe unë po ju përgjigjem tash.

Dhe, këto kritere, që po thoni ju janë respektuar të gjitha, po them unë në të vërtetë janë respektuar të gjitha dhe ai komision është ai që është. Është shumë profesional dhe mund të them se vërejtjet që janë bërë nga Komisioni Evropian në këtë ligj kanë qenë krejtësisht kozmetike.

Ne do t'i bëjmë edhe ato ndryshime dhe besoj që ky ligj do vijë te ju dhe ju do ta keni pastaj ndikimin e juaj, për ta bërë ligj të mirëfilltë. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Mirë, kjo ishte edhe përgjigjja e fundit. Po, herët tjera kërkoj nga deputetët dhe ata që përgjigjen ta respektojnë kohën!

Para se të fillojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 maj 2012, fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit, deputeti për Ekonomi, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryetar!

E kam një kërkesë. Ju kam sjellë edhe me shkrim për ndryshimin, përkatësisht plotësimin e rendit të ditës edhe me një pikë të veçantë. Është fjala për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Siç e dini, në njërën nga seancat e mëhershme, unë kam kërkuar të tërhiqem, meqenëse nuk kishte kaluar, d.mth. nuk e kishte marrë aprovimin e komisionit dhe kërkoja nga Qeveria që ta shqyrtojë edhe njëherë.

Meqenëse Qeveria ka bërë ndryshime në këtë propozim dhe e ka sjellë në komision dhe meqenëse komisioni e ka aprovuar dhe, po ashtu, meqenëse nuk ka kohë, meqë ky Bord është i paplotësuar, ka kohë që ky sektor tanimë ka nevojë për funksionimin normal të këtij mekanizmi, unë kërkoj që sot të futet në rend dite dhe po ashtu ftoj që Kuvendi ta trajtojë pozitivisht këtë propozim të Qeverisë! Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë, në emër të grupit, e kam kërkesë që nga rendi i ditës të shtyhet për seancën e radhës Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për teatrot, me qëllimin më të mirë. Meqenëse, komuniteti i madh i artistëve ka bërë një mori kërkesash, sugjerimesh e vërejtjesh dhe nuk janë marrë parasysh, nuk e them që çdo herë merren parasysh të gjitha, por mundësia që ky ligj të plotësohet, ekziston. Prandaj, kisha dashur të ketë mirëkuptim dhe ka mundësi që komisioni në një mbledhje të radhës t'i shqyrtojë këto kërkesa edhe njëherë dhe në seancën tjetër ky projektligj të vihet për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Po, i kemi tash dy mocione, si të them. Cili është qëndrimi i grupit për mocionin, që e kërkoj deputeti Zenun Pajaziti? Ose, nëse jeni dakord shkojmë në votim formal. Deputeti, kryetari i Grupit të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Kërkesën që ne e bëmë, normalisht është e drejtë e grupit parlamentar, por mendojmë se nuk është urgjente, ajo mund të shqyrtohet në seancën e radhës, dhe nuk jemi që të futet kësaj. Ju e dini, zoti kryetar, po edhe të tjerët, se ne kemi pasur vërejtje edhe herën e kaluar për shkak të kriterit profesional, për shkak të përgatitjeve të njerëzve, sepse është një bord i rëndësishëm dhe duhet krijuar mundësi deputetëve që t'i vlerësojnë. Realisht, Qeveria e ka bërë vlerësimin, por ne jemi ata që duhet dhënë votën edhe për këtë pikë, përkatësisht për këtë bord, e kjo ka mundësi të bëhet në mbledhjen tjetër, sikur edhe ajo që e thashë paraprakisht për Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për teatrot. Prandaj, ne jemi që kjo të ndodhë në seancën tjetër, e jo sot.

KRYETARI: Falemnderit!

Po, rekomandimi i komisionit është pozitiv. Shkojmë me rend. Jemi për kërkesën e deputetit Zenun Pajaziti. Partia Demokratike, në emër të grupit, kush e do fjalën? Kryetari i grupit, Adem Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e sheh shumë të nevojshme dhe të domosdoshme që sot të hyjë në rend të ditës, të votohet dhe të plotësohet ky komision, sepse shumë procese janë të bllokuara, të cilat janë shumë të rëndësishme për vendin. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", kryetari i grupit, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Konsideroj që sa i përket listës për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, ne kërkojmë që kjo të procedohet në seancën e ardhshme, jo në këtë seancë. Meqenëse, kjo çështje është trajtuar këtë javë në komision dhe deputetët nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'i trajtuar këta emra dhe të vendosin për votën e tyre.

Ndërkohë, meqenëse e mora fjalën, tash po flas edhe për Ligjin për teatrot. Ne pajtohemi plotësisht me mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së që kjo të shtyhet.

Kanë ardhur edhe disa vërejtje shtesë nga komuniteti i artistëve, që merren me çështjen e teatrit dhe, rrjedhimisht, konsiderojmë që do të kishte qenë e udhës që komisioni ta ketë kohën t'i trajtojë edhe këto vërejtje, në mënyrë që ta kemi mundësinë ta përpilojmë një ligj sa më të mirë për teatrot edhe sipas kërkesave të komunitetit të artistëve. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Mendojmë se e njëjta që u tha më përpara vlen. Ose janë çështje, të cilat po përsëriten, ose janë çështje të cilat nuk arrijnë të harmonizohen kurrsesi, domethënë kemi përsëritje të asaj që ka ndodhur më përpara. Dhe, mendojmë se duhet të shtyhet dhe duhet të marrim diçka, që ndryshon nga rastet e mëparshme. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Për Koalicionin Kosova e Re, kryetarja Myzeje Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke e marrë parasysh se procedimi i emrave ka shkuar me vonesë dhe tash nëse duam të bëjmë përzgjedhje të emrave të rinj, po ju them shumë haptas se edhe unë në fillim nuk kam qenë e pajtimit me disa emra që të shkojnë aty. Mirëpo, nga kërkesa e organizatave apo ndërmarrjeve, të cilat atakohen direkt me Bordin e Zyrës së Rregullatorit, ata kanë mbetur shumë mbrapa dhe projektet e tyre janë në dështim e sipër, për arsye se bordi nuk është i kompletuar dhe vendimet nuk mund të merren.

Për këtë arsye, që të mos kemi procedim të proceseve shumë të rëndësishme në sektorin e energjisë, për mungesë të bordit, Koalicioni për Kosovën e Re do të përkrahë që ky vendim të hyjë sot në seancë plenare dhe të votohet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Në emër të SLS-së, kryetari Sasha Milosavljeviq e ka fjalën!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

S obzirom da je ovaj, mnogo bitno ovo pitanje, mi se slažemo da se ova tačka uvrsti u današnji dnevni red. I to je to!

KRYETARI: Falemnderit!

Në emër të “6+”, deputeti Fikrim Damka e ka fjalën!

FIKRIM DAMKA: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e përkrah kërkesën e kryetarit të Komisionit të Ekonomisë për të hyrë në rend të ditës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë etj., Idriz Vehapi!

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë do të flas lidhur me Projektligjin për teatrot.

Ne si komision e kemi shqyrtuar projektligjin, kemi organizuar edhe dëgjim publik. Ka qenë i ftuar edhe komuniteti i artistëve. Ka pasur diskutime “pro&contra” ligjit, kemi futur edhe disa ndryshime që i kanë propozuar ata. Njëkohësisht, projektligji është shqyrtuar edhe prej komisioneve të përhershme. Nuk ka pasur vërejtje dhe unë nuk po e shoh të arsyeshme që kjo të shtyhet për një mbledhje tjetër. Por, si do që të jetë, deputetët do të vendosin për këtë projektligj. Unë e shoh të paarsyeshme që të shtyhet.

KRYETARI: Mirë, falemnderit! Kemi dy kërkesa. Kërkesa e parë është e kryetarit të komisionit dhe në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, për ta futur në rend të ditës votimin e vendimit të Qeverisë për plotësimin e Komisionit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 37 vota “për”, 34 “kundër”, një abstenim, hyn në rend të ditës si pikë e fundit.

Propozimi i dytë është i deputetit Ismet Beqiri, për tërheqjen nga leximi i dytë i Ligjit për teatrot. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Me 45 vota “për”, 21 “kundër”, 8 abstenime, shtyhet për seancën e radhës.

Vazhdojmë! Të pranishëm i kemi 77 deputetë.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 maj 2012.

A ka vërejtje në procesverbalin e kësaj mbledhjeje? Fjalën e ka kërkuar deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Më lejoni, para se të kalojmë në rendin e ditës, e kam një sugjerim për Kuvendin.

Në pikën e 12-të të rendit të ditës e kemi paraparë shqyrtimin e Raportit të punës të Radio-Televizionit të Kosovës për vitin 2011.

Këtu e kam vendimin e Kuvendit, të datës 29 korrik të vitit të kaluar, me të cilin i bënë rekomandime dhe afatizon brenda 3 muajve Radio-Televizionit që të bëjë shqyrtim dhe adresim të vërejtjeve që i ka dhënë Auditori.

Nëse e trajtojmë raportin, ku veç tjerash, tabelat nuk i harmonizohen, ku e tërë pasuria është e regjistruar në emër të drejtorit dhe shumë e shumë tjera që i kemi shqyrtuar, për këtë ata nuk janë përgjegjës, prandaj unë e shoh të pakuptimtë trajtimin e raportit në mungesë të këtyre të dhënave, sepse nuk kemi elemente bazë mbi të cilat do ta japim vlerësim. Flas për anën financiare, jo për skemën programore.

Dhe, unë i propozoj Kuvendit, që para se ta trajtojmë atë raport, ne duhet t’i marrim këto rekomandime, me të cilat e kemi marrë vendimin. Unë e kam këtu vendimin, të nënshkruar prej juve, zoti kryetar.

Pra, mendimi im është që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, derisa ne nuk i marrim këto adresime të këtyre rekomandimeve, të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm.

KRYETARI: Kryetar i komisionit, cili është mendimi juaj, meqë është mocion, që duhet ta hedhim në votim.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryetar!

Ne si Komision FunkSIONAL nuk e shqyrtojmë anën financiare të raportit. E, pastaj Kuvendi vendos.

KRYETARI: Edhe një herë fjalën e ka deputeti Ali Sadriu!

ALI SADRIU: Zoti kryetar, unë nuk fola si deputet. Fola si kryetar i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Materialin, të cilin ne e kemi përcjellë me pasqyra të audituara, me rekomandime, të njëjtat e kanë marrë miratimin e Kuvendit. Pra, është mendimi anë, ta mbrojmë në një mënyrë edhe autoritetin e Kuvendit. Ne po e shkelim. Ai e ka shkelur, nuk të është përgjigjur. Ka pasur afat tre muaj për ta njoftuar Kuvendin se pse kanë ndodhur ato dhe çka kanë ndërmarrë në riparimin e tyre. Unë kam informata shtesë se edhe auditimi i këtij viti i ka gjetur po të njëjtat gabime, bile edhe më të theksuara.

Prandaj, është koha kur duhet t'i edukojmë, në mënyrë që të respektohen vendimet e Kuvendit.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, kryetar!

Edhe grupi ynë e mbështet plotësisht këtë kërkesë. Madje, prej fillimit kemi thënë që kur të shqyrtohet raporti i punës së institucioneve të ndryshme të pritët dhe të shqyrtohet së bashku me raportin e Auditorit, sepse pa pasur një pasqyrë të qartë se si janë përdorur financat nuk mund të flasim as për programet, e as për punën.

Në qoftë se financat janë keqpërdorur, edhe puna e një institucioni është keqpërdorur. Po flasim parimisht. Kështu, që e mbështetim plotësisht kërkesën e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrje Financiare. Falemnderit!

KRYETARI: Unë jam dakord me ju dy, por ne kemi dy komisione që kanë rekomanduar që kjo çështje të shqyrtohet. Është komisioni përkatës dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Fjalën ia jap kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetes Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar,

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa ne e shqyrtojmë raportin financiar të secilit institucion të pavarur. E kemi shqyrtuar edhe raportin financiar të Radio-Televizionit të Kosovës dhe i kemi dhënë dy rekomandime.

Shqetësim në Komisionin për Buxhet dhe Financa ka qenë çështja e deficitit të pambuluar të Radio-Televizionit të Kosovës, kurse në përgjithësi Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar raportin.

Çështjet që po diskutohen këtu janë më tepër çështje që kanë të bëjnë me punën, efikasitetin apo performansën e shfrytëzimit të mjeteve, që është çështje e Auditorit dhe e Komisionit të Kontrollit.

Megjithatë, raporti i auditimit edhe për vitin e kaluar do të vijë në Kuvend dhe kjo është më tepër çështje e tij. Kurse, ne e shikojmë çështjen që ka të bëjë me mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, domethënë nga ajo që është planifikuar dhe nga ajo që është realizuar, kurse për çështjen e efikasitetit të shfrytëzimit të mjeteve është Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, që ndoshta është më tepër çështje kur të vijë raporti i auditimit të këtij institucioni për vitin 2011.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjuhësi, deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Unë para vetes këtu e kam një vendim të nxjerrë nga ky Kuvend, i aprovuar më datën 29 korrik 2011 dhe i nënshkruar nga kryetari, zoti Jakup Krasniqi. Ky vendim i kërkon institucionit, në këtë rast Radio-Televizionit të Kosovës, që të ndër marrë disa masa konkrete dhe t'i raportojë Kuvendit në një afat kohor brenda tre muajsh.

Radio-Televizioni i Kosovës nuk e ka respektuar këtë vendim dhe nuk i ka raportuar Kuvendit. Krejt çka kërkohet këtu është respektimi i një vendimi të Kuvendit. Të shtyhet trajtimi i raportit të punës të Radio-Televizionit të Kosovës derisa të vijnë këto informata shitesë. Mendoj se me këtë rast respektohet një vendim i votuar në Kuvend, nga të gjitha partitë besoj, dhe nuk ka diçka politike këtu. Po e trajtojmë një procedurë, vendim të Kuvendit që duhet të respektohet, e pastaj të hyjmë në një procedurë tjetër të aprovimit ose jo të raportit të punës së Radio-Televizionit të Kosovës.

Ne duhet të krijojmë logjikën e respektimit të institucioneve, e në këtë rast institucion vendimmarrës është Kuvendi. Kuvendi ka vendosur, institucioni publik, në këtë rast Radio-Televizioni i Kosovës duhet ta respektojë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Unë edhe njëherë po them, jam dakord, por realisht do të duhej që komisionet ta kërkojnë zbatimin e atij vendimi, e sidomos komisioni që e mbikëqyr punën e Radio-Televizionit të Kosovës.

Meqenëse e kemi mocionin, kush është për ta shtyrë këtë derisa Radio-Televizioni t'i përgjigjet vendimit të mëparshëm të Kuvendit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 61 vota "për", 3 "kundër" dhe 2 abstenime shtyhet edhe pika 12 e rendit të ditës.

A kemi ndonjë mocion? Nuk kemi.

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e datës 3 maj 2012? Nuk ka.

Së pari le ta merr fjalën deputetja Blertë Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Falemnderit, kryetar!

Unë nuk kam vërejtje për transkript. E kam një vërejtje për një lëshim, që është bërë në ueb-faqen e Kuvendit. Më është ndërruar emri i partisë dhe kërkoj nga administrata e Kuvendit që ta përmirësojë këtë lëshim.

KRYETARI: Mirë, administrata kërkon falje. Deputetja Salë Berisha-Shala e ka fjalën!

SALË BERISHA-SHALA: Falemnderit, kryetar!

As unë nuk kam vërejtje në transkript, por e kam një kërkesë për administratën e Kuvendit. Po e përsëris edhe njëherë, Njësia e Transkripteve le t'ia bashkëngjijë transkriptit rendin e ditës së seancës, e cila transkriptonet.

KRYETARI: Mirë, sigurisht administrata do ta ketë këtë parasysh. Por, ne i votojmë procesverbalet e mbledhjeve. Falemnderit!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Interpelancë me zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve, në raport me bisedimet me Serbinë në Bruksel, sipas kërkesës së Grupit të deputetëve nënshkrues

Deputetja Kimete Bajrakari dhe Grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë zëvendëskryeministren Edita Tahiri.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë. Përfaqësuesit e interpelancës e kanë të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8 e Rregullores së Kuvendit, zëvendëskryeministria Edita Tahiri e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash. Koha e ndarë për diskutime sipas grupeve parlamentare të deputetëve është si vijon:

- Grupi i Partisë Demokratike 50 minuta,
- Grupi i Lidhjes Demokratike 40 minuta,
- Grupi i “Vetëvendosjes” 18 minuta,
- Grupi i Grupit Parlamentar të AAK-së 18 minuta,
- Grupi i Koalicionit Kosova e Re 11 minuta,
- Grupi i SLS-së 13 minuta,
- Grupi i “6+” 7 minuta dhe
- Grupi i nëntë deputetëve të pavarur, 16 minuta.

Ftoj përfaqësuesen e parashtruesit të interpelancës, deputeten Kimete Bajraktari, që ta marrë fjalën!

(Ndërhyrje)

Atëherë, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryetar!

Ne në seancën e kaluar kemi marrë vendim që rekomandimet pas seancës që e kishim, përkatësisht debatit për persona të pagjetur, ato rekomandime të votohen sot, sepse janë të një seance tjetër. Ndërkaq, interpelanca është seancë po ashtu me temën e njëjtë, por është interpelancë, dhe janë të ndara. Prandaj, sa unë e di, këto rekomandime janë të përgatitura. Atëherë, rekomandimet të miratohen, e pastaj të hyhet në interpelancë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Edhe pse kanë ardhur me rekomandime me vonesë, mendoj që kur ta përfundojmë debatin i votojmë dy rekomandimet, edhe rekomandimet, që mund të dalin nga interpelanca, edhe rekomandimet që kanë dalë nga debati.

Unë kam kërkuar që të shpërndahen dhe besoj se administrata është duke e kryer punën në procedurë. Po vazhdojmë!

Deputete Kimete Bajraktari, e ke fjalën!

KIMETE BAJRAKTARI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në prill të vitit 2012 po bëhen 13 vjet prej kur nuk është zbardhur fati i një numri të madh të të zhdukurve, si pasojë e luftës në Kosovë.

Mekanizmat shtetërorë të Serbisë nëpërmjet organizimit ushtarak, policor dhe paramilitar kanë marrë me vete në Serbi mijëra shqiptarë të Kosovës. Ndërsa, edhe sot, në vitin 2012, nuk dihet për fatin e 1780 personave. Gjatë gjithë këtyre viteve, zbardhja e fatit të të zhdukurve ka qenë njëra prej kërkesave themelore njerëzore të shqiptarëve të Kosovës, të shoqatave të shumta për të pagjeturit dhe të institucioneve të Kosovës.

Kjo çështje vazhdon të jetë dhimbje e madhe për të gjithë ne, për familjet dhe për të afërmit tanë. Dhe, pavarësisht tentimeve dhe kërkesave të pandashme të shqiptarëve të Kosovës, e në rend të parë të familjarëve të të zhdukurve, Serbia asnjëherë nuk ka treguar vullnet politik për ta zbardhur fatin e tyre. Madje, me gjithë lëshimet politike që Kosova ka bërë në raport me Serbinë, Qeveria e atjeshme ka vazhduar të ketë sjellje të njëjtë, duke mos i hapur asnjëherë dosjet e informatave shtetërore për këtë çështje.

Në mars të vitit 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka filluar procesin e ri të bisedimeve me Serbinë, që mbahen në Bruksel. Deri më tash nuk ka pasur asnjë informatë, apo raportim në Kuvendin e Kosovës prej udhëheqëses së delegacionit të Kosovës, përkatësisht zëvendëskryeminstres Edita Tahiri, për çështjen e bisedimeve dhe për temën e zbardhjes së fatit të të zhdukurve në këtë proces.

Zëvendëskryeministrja Tahiri duhet të shpjegojë para Kuvendit të Kosovës se çfarë ka bërë gjatë këtij procesi të bisedimeve me Serbinë që të arrijë rezultate në temën e dhembshme të zbardhjes së fatit të të zhdukurve.

Po ashtu, është tejet e rëndësishme që ta vendosim temën e fatit të të zhdukurve në temën prioritare kushtëzuese në raport me Serbinë. Kjo interpelancë është bërë nga deputetët e të gjitha grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, që vijnë nga komuna e Suharekës.

Nisma ka ardhur pas një varg konsultimesh dhe një tryeze të mbajtur me aktorët kosovarë, që merren me zbardhjen e fatit të të zhdukurve, tryezë kjo që është mbajtur më 24 mars 2012, në Suharekë.

Propozojmë që Kuvendi i Republikës së Kosovës t'i miratojë këto pika të mocionit:

1. Duke shprehur interesimin për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë nga forcat ushtarake policore serbe gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë, të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta kushtëzojë vazhdimin e bisedimeve të mëtejshme me Serbinë me zbardhjen e plotë të fatit të tyre.
2. Kërkojmë nga të gjithë organizmat e përfshirë në procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur që ta intensifikojnë punën, me qëllim të identifikimit të mundshëm të mbetjeve mortore, si dhe përkrahjen në sigurimin dhe procedimin e informatave të reja.
3. Kërkojmë nga Instituti për Krime Lufte i Republikës së Kosovës që të grumbullojë dokumente e fakte për krimet e bëra nga ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe në Kosovë, në periudhën kohore 1998-1999.
4. U bëjmë thirrje medimeve të shkruara dhe elektronike që të vazhdojnë ta kenë në fokus çështjen e të zhdukurve dhe ta japin kontributin e tyre nëpërmjet vetëdijesimit të aktorëve ndikues, që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.

Ju falemnderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z.Xhavit Haliti)

KRYSUESI: Falemnderit!

Radha është e zëvendëskryeministres, zonja Edita Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Fillimisht, më lejoni që ta falënderoj grupin e deputetëve nënshkrues të kërkesës për këtë interpelancë për të diskutuar së bashku për çështjen e personave të pagjetur, si dhe për t'u njohur me rrjedhat rreth kësaj çështjeje në bisedimet teknike të Brukeslit.

Çështja e personave të pagjetur është njëra prej plagëve më të rënda të luftës agresore të Serbisë ndaj Kosovës, e cila edhe pas 13 vjetësh të mbarimit të luftës ende nuk është zgjidhur përfundimisht.

Në bazë të burimeve zyrtare, ende janë 780 persona, fati i të cilëve ende nuk dihet, nga gjithsej 6012 persona të zhdukur në mënyrë të dhunshme nga forcat okupatore të Serbisë.

Pa dyshim që çështja e personave të pagjetur përbën një nga problemet dhe dhembjet më të mëdha të popullit shqiptar, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucioneve tjera dhe, në veçanti, të familjeve, që jetojnë në ankthin e pritjes për të kuptuar për fatin e më të dashurve të tyre.

Duke qenë thellësisht të shqetësuar për çështjen e të pagjeturve dhe mungesën e një zgjidhjeje të plotë për këtë çështje, ne si Qeveria e Republikës së Kosovës kemi qenë dhe mbetemi tërësisht të angazhuar për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi.

Krahas angazhimit të mekanizmave qeveritarë dhe atyre ndërkombëtarë, të cilët janë duke punuar në vazhdimësi në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës ka arritur që çështjen e të pagjeturve ta ngrejë në nivelin e Bashkimit Evropian, duke e vendosur në agjendën e dialogut teknik, me gjithë refuzimet e palës serbe.

Çështja e të pagjeturve është diskutuar në rundin e katërt të bisedimeve në Bruksel, të mbajtur më 18 maj 2011 dhe, me këtë rast, delegacioni i Republikës së Kosovës e ka paraqitur platformën e Qeverisë sonë për zgjidhjen e këtij problemi.

Kërkesat tona kryesore kanë qenë:

1. Që Bashkimi Evropian të marrë rol udhëheqës dhe garantues për zgjidhjen e plotë të çështjes së personave të pagjetur, duke e fuqizuar procesin ekzistues nëpërmjet instrumenteve obligative, që e detyrojnë Serbinë për të bashkëpunuar dhe jo për ta sabotuar zgjidhjen e këtij problemi.
2. Kemi kërkuar që të hapen arkivat e gjenocidit, përkatësisht arkivat e ish-ushtrisë jugosllave dhe të mekanizmave të tjerë, të përfshirë në operacionet luftarake në Kosovë, sepse jemi të bindur se aty është adresa, ku Serbia vazhdon t'i fshehë krimet.
3. Kemi kërkuar që sa më shpejt të ofrohen informacionet e sakta për vendndodhjen e personave të zhdukur, vendvarrimet tjera të jashtëligjshme apo klandestine me mbetje mortore të viktimave të luftës, si dhe informatat mbi fshehjen e gjurmëve, duke përdorur furnallatat për djegien e trupave, e të tjera.

4. Kemi kërkuar të përshpejtohet procedimi i mëtejshëm i rasteve të parashtruara me kërkesë zyrtare, siç janë rasti i Rashkës, rasti i Medvegjës, i Rrezallës, i Peruçacit, i Zhilivodës, rasti i Suharekës, përkatësisht fabrikës “Ballkan”, rasti i Koshares, përfshirë edhe rastet për të cilat janë kërkuar informacione shtesë, siç janë rasti i Pastaselit dhe Izbicës.

5. Kemi shprehur gatishmërinë e institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës për të shqyrtuar dhe proceduar me kohë çdo informacion që parashtrohet nga pala tjetër.

6. Po ashtu, është konfirmuar gatishmëria për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet komisioneve qeveritare të të dyja shteteve, Kosovës dhe Serbisë, me mbështetjen e EULEX-it dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe kemi kërkuar që operacionet teknike në terren të realizohen nga ekipet profesionale, si dhe me praninë e palëve dhe të bashkësisë ndërkombëtare.

7. Kemi insistuar që çështja e të pagjeturve të trajtohet sipas konventave ndërkombëtare, si çështje humanitare dhe të ndërpriten tendencat e politizimit të kësaj çështjeje nga Serbia.

8. Në mënyrë të veçantë, kemi kërkuar zbardhjen e fatit të profesor Ukshin Hotit, atdhetarit dhe intelektualit të shquar shqiptar.

Të nderuar deputetë,

Bisedimet për këtë çështje kanë lënë të kuptohet se pala serbe vazhdon me qasje politizuese, me gjithë faktin se zgjidhja e çështjes së të pagjeturve është obligim ndërkombëtar, që garantohet me konventat ndërkombëtare, në mesin e të cilave Konventa e Gjenevës e vitit 1949, si dhe Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë.

Një qëndrim i tillë i papërgjegjshëm i palës serbe nuk ishte diçka e panjohur, sepse në sajë të qëndrimeve të tilla antihumane çështja e të pagjeturve po zvarritet kaq shumë vite.

Për këtë arsye, ne si Qeveri e Kosovës kemi kërkuar që Bashkimi Evropian të angazhohet drejtpërdrejt dhe të bëhet garantues i procesit dhe i zgjidhjes finale.

Mund të shtoj edhe diçka, se qëndrimi i palës serbe nuk ka dalluar nga politikat e kohës së Milosheviqit. Me fjalë tjera, nuk kanë treguar gatishmëri të ballafaqohen me përgjegjësinë që e kanë si shtet që ka bërë katër luftëra agresore, në hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe që ka bërë një gjenocid të paparë në Kosovë. Për këtë arsye, ne si Qeveri e Kosovës kemi kërkuar që Bashkimi Evropian të angazhohet drejtpërdrejt dhe të bëhet garantues i këtij procesi dhe i zgjidhjes finale.

Po ashtu, dua të ju informoj se Bashkimin Evropian ia kemi dorëzuar të gjitha dokumentet relevante që kanë të bëjnë me këtë çështje, përfshirë këtu platformën e Qeverisë së Kosovës për zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve, dokumentet analitike dhe dokumentet faktografike.

E konsideroj të rëndësishme të ju informoj se përgatitjet e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të delegacionit të Kosovës për bisedime kanë qenë të nivelit të lartë, si për nga ekspertiza, kompetenca, strategjia dhe integriteti. Platforma qeveritare për çështjen e të pagjeturve është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, nën udhëheqjen e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë Hajredin Kuçi, i cili e ka emëruar edhe grupin e ekspertëve, në përbërje profesor Pajazit Nushi, kryetar i grupit; Prenk Gjetaj, kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, dhe Arsim Gërxhaliu, drejtor i Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Në kuadër të përgatitjeve, unë si udhëheqëse e delegacionit, me qëllim të njohjes sa më të mirë të kësaj çështjeje, kam zhvilluar takime pune me Ministrinë e Drejtësisë, Grupin Qeveritar për Persona të Pagjetur, Departamentin e Mjekësisë Ligjore, EULEX-in, Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe shoqatat e familjarëve të personave të zhdukur, të cilët i falënderoj për bashkëpunimin e plotë dhe punën e madhe që kanë bërë.

Po ashtu, më lejoni të ju theksoj se kam raportuar në Komisionin Parlamentar për Persona të Pagjetur, si dhe para shoqatave të familjarëve të personave të zhdukur.

Pavarësisht se çështja e të pagjeturve është trajtuar vetëm në njërin nga rundet e bisedimeve, vlerësojmë se janë arritur disa rezultate konkrete. Si Qeveri e Republikës së Kosovës kemi pasur për qëllim, që duke e futur në agjendën e dialogut teknik këtë çështje, të bëjmë që kjo çështje të ngrihet në nivel të trajtimit të Bashkimit Evropian, si dhe Bashkimi Evropian të pranojë të marrë rol udhëheqës dhe garantues për zgjidhjen e plotë të këtij problemi, përkatësisht për zbardhjen e plotë të fatit të të pagjeturve dhe këtë e kemi arritur plotësisht, sepse sot kjo çështje është bërë pjesë e agjendës së Bashkimit Evropian.

Kemi arritur që ta informojmë dhe sensibilizojmë Bashkimin Evropian për të gjitha sfidat nëpër të cilat po kalon ky proces, duke kërkuar që të rritet trysnia mbi Serbinë, për të qenë bashkëpunuese në zgjidhjen e plotë të kësaj çështjeje.

Bashkimi Evropian është zotuar se do të angazhohet në mënyrë të veçantë për këtë çështje dhe se Raporti i Progresit i BE-së do ta trajtojë në mënyrë më të hollësishme këtë problem, prej ku do të dalin edhe obligime të reja për të dyja shtetet, Kosovën dhe Serbinë. Andaj, jemi të bindur se rritja e angazhimeve të BE-së në zgjidhjen e këtij problemi e përbën një fuqizim të ri për procesin dhe mekanizmat ekzistues vendorë dhe ndërkombëtarë për zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve.

Të vetëdijshëm për kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e kësaj çështjeje, Qeveria e Republikës së Kosovës, konform Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të vazhdojë angazhimin maksimal, si në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve vendore, që merren me këtë çështje, ashtu edhe me fuqizimin e këtij procesi, në mënyrë që sa më shpejt të zbardhet fati i të gjithë personave të pagjetur. Ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Falemnderit! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Muja, por duhet të ju përkujtoj se koha është e përcaktuar. Kështu që, merruni vesh ndërmjet jush që të mos e pengoni kolegun për diskutimin e mëtutjeshëm, nëse e keni. Grupet parlamentare pra ta kenë parasysh këtë. Falemnderit!

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,
E nderuar zëvendëskryeministre,
Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë dhe familjarë të familjeve të të zhdukurve në Republikën e Kosovës, Përcaktimi i numrit të personave të zhdukur si rezultat i luftërave dhe i shkeljeve të të drejtave të njeriut është veçanërisht i vështirë, kur aktorët e shumë grumbullojnë informacione të ndryshme për nga formati, thellësia analitike dhe për qëllime të ndryshme.

Në kontekstin e luftës së fundit në Kosovë, në bazë të të dhënave të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, në Kosovë ishin raportuar të zhdukur 6.010 persona, në mesin e në Kosovë të cilëve përfshihen edhe 1.371 persona të gjetur gjallë ose të vizituar në burgje. Sot, numri i personave të cilët janë ende të zhdukur është 1.781, nga të cilët rreth 500 individë janë joshqiptarë. Prapa këtyre numrave janë mijëra jetë njerëzish, familje të lënduara, fëmijë në pritje dhe prindër me shpresa të vyshkura.

Është vlerësuar se rreth 4.500 persona janë zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Pas më shumë se një dekade përpjekjesh intensive, rreth gjysma e këtyre personave të zhdukur janë gjetur, janë identifikuar me saktësi dhe eshtrat e tyre janë kthyer për varrim.

Me gjithë këtë përparim, kërkimi për të zhdukurit e ka arritur pikën e bllokimit virtual. Faktorët, të cilët i kontribuojnë kësaj ngecjeje janë të shumëfishtë, por tre shkaktarët themelorë janë të identifikueshëm.

Arsyeja e parë - e rëndësishme është se numri i gjetjeve dhe zhvarrimeve në mbetjet mortore të personave të zhdukur ka rënë në mënyrë dramatike që nga viti 2005. Në këtë vit janë paralajmëruar se do të bëhen hulumtime në 39 lokacione të varrezave të mundshme.

Arsyeja e dytë - ndërlikueshmëria e procesit, sidomos duke marrë parasysh motivin e zhdukjes, apo marrjes peng të këtyre personave, e që ishte kryekëput politik. Për t'i fshehur gjurmët e krimeve makabre, pas vrasjes regjimi i kishte varrosur dhe zhvarrosur disa herë viktimat.

Po marr dy shembuj, për t'i ilustruar këto. Kur në Batajnicë u gjetën trupat e shqiptarëve të vrarë, gruaja e ish-kasapit të Ballkanit, Slobodan Milosheviq, thoshte: "Ata janë serbë të vrarë në luftërat me turqit"!

Analizat shkencore të ADN-së, jo vetëm që e mohuan këtë pohim monstruoz, por dëshmuan që të gjitha viktimat e gjetura në këto varreza, të papara që nga Lufta e Dytë Botërore, ishin shqiptarë, pa përjashtim.

Një ilustrim tjetër i ndërlikueshmërisë dhe makabritetit të regjimit serb është fakti se, sipas raporteve të organizatave ndërkombëtare, mbetjet mortore të një shqiptari në Kosovë janë gjetur në 11 lokacione të ndryshme.

Arsyeja e tretë - kontribuuesi i cili e pengon përparimin e mëtejshëm, është një pjesë e identifikimeve të mëhershme të bëra pa ADN. Në periudhën 1999-2003, janë jo të sakta. Në Morgun e Prishtinës janë diku mbi 400 mbetje mortore të individëve të ndryshëm, të cilët ende nuk janë identifikuar për arsye të cilat as institucionet e përfshira në proces nuk i dinë ende.

Gjithsesi, arsyeja më madhore për moszbardhjen e fatit të rreth 2.000 personave ende të zhdukur është Serbia, e cila në përpjekjet e saj ataviste për ta penguar rrugëtimin e Kosovës po i mban peng informacionet për fatin e këtyre personave.

Se nuk kemi të bëjmë me retorikë të zakonshme populiste, por me fakte të pakontestueshme, e dëshmon edhe fakti se më 9 maj të vitit 2010, kryeprokurori i Prokurorisë për Krime Luftë të Serbisë, Vukçević, deklaroi për agjencinë e lajmeve: “Prokuroria e Krimeve të Luftës e Serbisë ka zbuluar një varr masiv, në të cilin gjenden mbetjet mortore të 250 shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimi për numrin e trupave është bërë në bazë të deklaratave të dëshmitarëve dhe incizimeve nga terreni”, duke shtuar se procesi i nxjerrjes së trupave do të fillojë së shpejti. Dje u mbushën dy vjet nga kjo deklaratë e dhënë në Ditën e Evropës, por as edhe një trup i vetëm nuk është kthyer nga Serbia, nga ai lokacion, dhe pos vizitave të pasuksesshme vlerësuese, shteti serb nuk ka bërë asgjë për ta zgjidhur këtë rast.

Bisedimet e filluara me Serbinë, në kuadër të dialogut të Vjenës, të iniciuara në vitin 2003 dhe të ndërmjetësuara nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, nuk po japin rezultate. Këtë e dëshmojnë edhe deklaratat e faktorëve të ndryshëm dhe situata në terren.

Një nga arsyet e këtij dështimi është fakti se ato kanë karakter humanitar, e nuk kanë mekanizma të detyrueshëm implementues.

Ka ardhur koha që niveli dhe karakteri i këtyre bisedimeve të ndryshojë. Ne do të insistojmë që çështja e personave të zhdukur të jetë subjekti kryesor në agjendën e Bashkimit Evropian, sepse jemi të bindur se zgjidhja e kësaj çështjeje, përveç që do ta zgjidhë ankthin 13-vjeçar të mijëra familjeve, do të kontribuonte në përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore ndërmjet dy shteteve, të Kosovës dhe Serbisë.

Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur do ta ndihmonte Kosovën për t’i shëruar plagët e luftës dhe Serbinë që të shkëputet nga e kaluara e saj hegjemoniste.

Deputetë të nderuar, ju e dini se çështja e personave të zhdukur ka qenë përgjegjësi e rezervuar e institucioneve ndërkombëtare, të UNMIK-ut dhe tani EULEX-it. Situatë e njëjtë vazhdon edhe sot e kësaj dite. Kjo nuk mund t'i amnistojë institucionet e Kosovës nga përgjegjësitë e veta kushtetuese për ta zbardhur fatin e qytetarëve të vet të zhdukur.

Ne e kemi një rezolutë të këtij Kuvendi, e cila duhet të zbatohet. Ne e kemi aprovuar një ligj, edhe pse të mangët dhe jo në përputhje me nevojat e kësaj kategorie, ai duhet implementuar. Ne e kemi një Departament të Mjekësisë Ligjore, por nuk e kemi asnjë antropolog dhe arkeolog mjeko-ligjor. I kemi 1.781 persona të zhdukur, e nuk kemi arkiv qendror për ta.

Të gjitha këto çështje mund të zgjidhen në mënyrë efektive me një bashkërendim të veprimeve të të gjithë faktorëve të përfshirë në proces.

Ne si mazhorancë nuk i mohojmë përgjegjësitë tona ligjore dhe kushtetuese. Ligji për personat e zhdukur është aprovuar. Është hartuar edhe Rregullorja dhe pritet të miratohet në Qeveri. Ka nisur procesi i krijimit të të dhënave qendrore dhe janë ndarë 50.000 euro për zhvarrimin e lokacioneve në Zhilivodë, zhvarrim ky i cili pritet të përfundojë këtë verë. Gjithashtu, kanë nisur edhe konsultimet për ndërtimin e një memoriali për personat e zhdukur, e do të vazhdojmë t'i përkrahim institucionet e specializuara edhe politikisht, edhe materialisht.

Të nderuar kolegë, shihet qartë se mekanizmat ekzistues për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur nuk po japin rezultate. Dhe, sikur më tha një familjar para ca ditësh, nëse vazhdohet me këto ritme, ka frikë se edhe për 50 vjet tjera nuk do të zbardhet fati i familjarëve të tij!

Vitin e kaluar janë identifikuar 51 trupa. Llogariteni vetë edhe sa vjet duhet të zgjasë kjo çështje. Pra, perspektiva duket e zymtë, prandaj ne propozojmë:

1. Çështja e personave të zhdukur të jetë temë kryesore në agjendën e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian duhet ta detyrojë Serbinë t'i përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare, duke i dhënë të gjitha informacionet për personat e zhdukur në Kosovë.
2. Kalimi i kompetencave nga EULEX-i tek institucionet e Kosovës, mungesa e pjesëmarrjes vendore e parandalon zhvillimin e ndjenjës së pronësisë së sukseseve dhe pengesave, gjithashtu. Rishqyrtimi i kësaj situatë në Kosovë është po aq i rëndësishëm për perspektivën e punës në të ardhmen, sa edhe për përcaktimin nëse a duhet të konsiderohen në të ardhmen përpjekjet ndërkombëtare të suksesshme, apo jo. Institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i marrin përgjegjësitë e veta kushtetuese.
3. Kryeministri i Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministrja dhe ministri i Drejtësisë ta thërrasin një takim urgjent të të gjithë faktorëve të përfshirë në proces për ta dëgjuar vlerësimin e tyre për situatën. Ky takim duhet ta ketë si produkt final hartimin e një strategjie konkrete, për hapat e mëtutjeshëm me afate të përcaktuara kohore.

4. Implementimi i Ligjit për personat e zhdukur, sidomos përsheptimi i krijimit të të dhënave qendrore, krijimi i një arkivi qendror të të dhënave për personat e zhdukur, në nivel qendror, e preferuar me një bazë të vetme të kërkueshme dhe të kompjuterizuar, do të ishte pikë e prekshme e largimit nga status quo-ja dhe do të mundësonte konsolidimin sistematik të të dhënave ekzistuese hetuese, të të dhënave “ante mortem” dhe “post mortem”, vendndodhjen gjeografike të vendvarrimit, si dhe informatat rreth identifikimit dhe riatdhesimit. Kjo, si rezultat, do të lejonte përmirësimin e punës në rast dhe vendosjes së bazave më të mira për analiza të përgjithshme. Një arkiv i tillë qendror i të dhënave do të mundësonte edhe testimin e hipotezës fillestare në lidhje me përcaktimin e vendeve të varrezave masive, të pazhvarrosura ende.

5. Fuqizimi i institucioneve vendore, të cilat merren me persona të zhdukur, në veçanti. Kjo vlen për Komisionin Ndërminstor dhe Departamentin e Mjekësisë Ligjore. Fuqizimi i këtyre institucioneve do ta lehtësonte edhe hartimin e një strategjie dalëse të mekanizmave ndërkombëtarë, në vitin e përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur.

6. Përsheptimi i procedurave për ndërtimin e memorialit dhe inicimi i krijimit të një fondi për mbështetjen e shoqatave të familjarëve të individëve të zhdukur.

Falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Dhjetë minuta e pesëmbëdhjetë sekonda i ke shpenzuar, ta kesh parasysh! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Çështja e personave të zhdukur vërtet është një prej çështjeve më të dhimbshme në Kosovë, ndërkaq e dimë nga kush dhe nga çka është shkaktuar.

Po ashtu, është mirë që sot kryenegociatorja, zonja Edita Tahiri, deklaron dhe jep raport verbal para deputetëve të Parlamentit të Kosovës, edhe pse ky Parlament e ka miratuar një rezolutë, e cila e obligon kryenegociatoren që të japë raport vazhdimisht për bisedimet Kosovë-Serbi.

E dyta, zonja zëvendëskryeministre, nëse nuk keni harruar, Beogradi para se të hyjë në bisedime me Kosovën, si kusht, ndër kryesorët, ka qenë që të trajtohet çështja e të zhdukurve pas luftës, pas përfundimit të luftës në Kosovë. Domethënë, Beogradi ka tentuar t'i barazojë viktimat e pasluftës me personat e zhdukur gjatë luftës, që i ka shkaktuar terrori i shtetit serb në Kosovë.

Dhe, këtë ju e keni pranuar, duke hyrë në bisedime, pa parashtruar kërkesa serioze ndaj Serbisë, apo ndaj bisedimeve Kosovë-Serbi.

Zonja zëvendëskryeministre, ju e dini shumë mirë se janë dënuar njerëz deri në 200 vjet burg për shkak të viktimit të paidentifikuara dhe të pafaktuara në Serbi. Domethënë

janë shqiptarë, të cilët janë akuzuar. Kjo tregon se nga Qeveria e Kosovës nuk ka pasur gatishmëri që kjo çështje të trajtohet seriozisht.

Nëse nuk keni harruar, zonjë e nderuar, ne ju kemi ftuar në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe keni dhënë fjalë të mëdha se kjo çështje do të bisedohet në bisedimet Kosovë-Serbi.

Ju po thoni se e keni mbajtur një takim më 18 maj, mirëpo ne nuk e dimë, ne sot dëgjuam për këtë. Mirëpo, ne ende nuk e kemi asnjë fakt, asnjë raport që tregon se këto bisedime janë zhvilluar, se cilat janë rezultatet. Rezultate nuk paska, pala serbe nuk paska qenë e dakorduar që të bisedojë për këtë çështje. Atëherë, si keni biseduar? A ka qenë çështje e rendit të ditës? Apo, keni diskutuar e biseduar diku nëpër korridoret e Brukselit!?

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon që kjo çështje të trajtohet më seriozisht, jo vetëm në bisedimet Kosovë-Serbi, por të merren parasysh nga edhe Qeveria e Kosovës dhe të respektohen rezolutat dhe vendimet e Kuvendit.

Kjo çështje nuk mund të zgjidhet pa një tryzni ndërkombëtare ndaj Serbisë, ndaj Beogradit, i cili duhet të tregojë për vatrën e krimit, e jo të tentojë ta barazojë krimin e shtetit serb me personat e zhdukur pas luftës. Serbia e ka kërkuar këtë, e kjo është pranuar dhe me këtë kusht është hyrë në bisedime me Serbinë, ndërsa pala kosovare nuk e ka shfrytëzuar këtë rast. Nuk e ka paraqitur numrin e më shumë se 2.000 personave të zhdukur për të hyrë në bisedime. Dhe, normalisht, tani kemi ngecje në këtë proces. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Albin Kurti e ka fjalën!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ajo çka kemi parë deri tash, nga të gjitha qeveritë, sa i përket çështjes së të pagjeturve, kërkon një ridefinim të vetë termit “i pagjetur”.

Kjo qeveri e tanishme, por edhe të gjitha të tjerat të mëparshme nuk kanë bërë gjë konkrete për të pagjeturit. Prandaj, të pagjeturit, para se të jenë të pagjetur, mbi të gjitha janë “të pakërkuar”. T’u thuash atyre “të pagjetur” krijon iluzionin e angazhimit për ata që qenkan kërkuar, por s’qenkan gjetur.

Dhe, kjo e amnistion përgjegjësinë e një qeverie të papërgjegjshme, e cila kurrë nuk i ka kërkuar seriozisht të rrëmbyerit. Të pagjeturit janë braktisur! E kur kjo qeveri, nganjëherë të pagjeturit i quan “të zhdukur”, kjo paraqet indikacion se kërkimi i të pagjeturve realisht është shpallur i mbyllur, pa filluar mirë asnjëherë.

Prej kur Qeveria Thaçi hyri në negociatën me Beogradin, në mars të vitit të kaluar, të pagjeturit kurrë nuk janë shtruar si çështje për t’u zgjidhur, por vetëm për t’ua dhënë negociatave njëfarë legjitimiteti dhe domosdoshmërie. Të pagjeturit kanë shërbyer vetëm si retorikë për ta justifikuar kinse njëfarë angazhimi për një çështje të ndjeshme, siç është kjo e të pagjeturve.

Por, krejt çka po shohim deri sot janë 8 marrëveshje me Serbinë, në të cilat Qeveria ka lëshuar pe për shtetësinë, sovranitetin, kufijtë, përfaqësimin e jashtëm me fusnotë, regjistrat civilë e librat kadastralë, targarat e automjeteve, dokumentet e udhëtimit, dokumentet e mallrave e të tjera.

Kurse të pagjeturit, si çështje, kanë shërbyer vetëm atëherë kur Qeverisë i është nevojitur, të thotë se jemi duke biseduar për problemet, të cilat na interesojnë. Të pagjeturit, Qeveria e Kosovës ia ka përmendur qytetarëve të Kosovës, në mënyrë që të shkojë në bisedime me Serbinë, ku s' do të përmenden të pagjeturit.

Qeveria ka lëshuar pe, aty ku nuk është dashur - Republika e sovraniteti, kurse Serbia nuk i përmbush as ato obligime që janë standarde minimale, morale dhe ndërkombëtare - kthimin e të rrëmbyerve.

Vetë fakti, që të pagjeturit u bënë temë negociatore me Serbinë i përmban dy probleme të mëdha.

Së pari, dehumanizimin e të pagjeturve nëpërmjet politizimit të kësaj çështjeje dhe tregtimin e tyre.

Së dyti, iluzionin se Serbia humanizohet nëpërmjet negociatave.

Në vend që të kishte trysni dhe sanksione ndërkombëtare për Serbinë që t'i kthejë të pagjeturit, pati presion për Kosovën që të hynte në negociata me Serbinë dhe të bënte kompromise për shtetësi.

Në vend se të pagjeturit të shërbejnë si arsye humanitare, që Serbisë t'i bëhet trysni politike, Serbia i ka kthyer të pagjeturit, krimin e vet, në kushtëzim për favore politike në negociata.

Ajo i ka rrëmbyer ata. Ajo i ka vrarë. Ajo e di se ku janë ata. Ajo i fsheh. Ajo nuk i kthen dhe në fund, për t'i kthyer, ajo kërkon të përfitojë nga ata.

Më thoni, deputetë të Kuvendit të Kosovës, nëse ka poshtërim më të madh për të pagjeturit sesa kjo padrejtësi e shumëfishtë që po u bëhet atyre?

Këtë mund ta pranojë vetëm një Qeveri që vetë është pa kurrfarë dinjiteti njerëzor. Prandaj, për ta gjithçka është e tregtueshme, duke filluar prej së ardhmes së brezave që ende nuk kanë lindur, e deri te mbetjet mortore, të atyre që nuk janë më në mesin tonë.

Të mendosh se Serbia mund të humanizohet nëpërmjet negociatave është iluzion. Negociatat janë mënyra më e mirë se si Serbia të trimërohet për mbrojtjen e krimit të saj, sepse negociatat janë saktësisht e kundërta e drejtësisë. Negociata ka pikërisht ngaqë nuk ka drejtësi. Drejtësia është vulosje e zgjidhjes së kontestit nëpërmjet ndëshkimit të fajtorit

dhe zhdëmtimit të viktimës, kurse negociatat janë presupozimi i pamundësisë së ekzistencës së fajtorit, si i tillë.

Drejtësia është binare: fajtori dhe i pafajshmi. Negociatat janë rrafshuese: pikënisja e të barabartëve dhe shpërndarja e plotë e bashkëfajësisë. Drejtësia i del krimit përpara. Negociatat e hedhin krimin prapa shpinës. Drejtësia ta jep atë që të takon, ndërkaq negociatat ta vënë në pikëpyetje atë që të takon.

Për të pagjeturit duhet drejtësi, e jo negociata. Të pagjeturit nuk do të gjenden me këtë Qeveri të humbur në negociata me Serbinë. Serbia nuk i kthen ata pa ia kthyer asaj padrejtësinë me sanksione, kushtëzime dhe trysni. Kjo mund të ndodhë vetëm atëherë kur populli i Kosovës të gjejë kurajë për t'i dhënë fund kësaj Qeverie të papërgjegjshme. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të AAK-së, deputetja Kimete Bajraktari.

KIMETE BAJRAKTARI: Falemnderit, zoti kryesues!

Numri i madh i personave të zhdukur është simbol i fuqishëm i dështimit të të drejtave të njeriut dhe vendosjes së rendit dhe ligjit.

Nëse nuk kemi rend dhe ligj, atëherë nuk kemi shtet, por vetëm pushtet. 1871 persona të zhdukur, por që nga viti 2005 kemi bllokim të këtij procesi. Viti 2011, fillimi i bisedimeve të ashtuquajtura “teknike” me Serbinë, por asnjëherë nuk u realizuan premtimet e bëra nga kryenegociatorja Tahiri se çështja e të zhdukurve do të jetë në tavolinën e bisedimeve me palën serbe. Ajo arriti sukses të madh në ngritjen e kësaj çështjeje në Bruksel, e sensibilizoi dhe e informoi BE-në për sfidat nëpër të cilat po kalonte ky proces, thua se në Kosovën e pasluftës askush nuk dinte se çfarë po ndodhte.

Zoti kryeministër, a thua ju deri më tani nuk e keni informuar faktorin ndërkombëtar dhe nuk e keni sensibilizuar çështjen e personave të zhdukur? Shtrohet pyetja: Çfarë keni bërë ju si kryeministër i Kosovës për të arritur rezultate në këtë temë të dhimbshme? Pse nuk kemi rezultate?

Zonja zëvendëskryeministre, a e di kryeministri epilogun e bisedave tuaja për të zhdukurit në Bruksel? Cilat janë instruksionet e zotit kryeministër për vazhdimin e këtij procesi?

Për zotin kryeministër dhe për ju zonja Tahiri, është shumë më e rëndësishme të bisedoni për targa e letra se sa për më të afërmit tanë, të cilët na mungojnë dhe shpirti i tyre nuk na lë të qetë tash e 13 e vjet. Si duket, ju nuk i dëgjoni thirrjet e nënave që t'ua ktheni bijtë e tyre. Familjarëve nuk u shuhet dhimbja në shpirt, ndërkaq ju nuk e dëgjoni vajin e heshtur, nuk i dëgjoni klithjet e tyre. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, nënkryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministren, e cila gjendet sot këtu me ne, dhe për të gjithë deputetët,

Duke marrë parasysh se sot në këtë seancë është shtruar interpelanca e zonjës Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet Serbi në Bruksel dhe duke marrë parasysh se në seancë janë të pranishëm familjarët e të zhdukurve, me gjithë respektin për ta, që është një çështje shumë e ndjeshme që ne këtu sot të merremi me përkujtimin e dhimbjeve të tyre, ngase është shumë e rëndë për një familjar kur dëgjon në Kuvendin e Kosovës çfarë debati bëhet në favor të familjarëve të tij, atëherë ne si deputetë të këtij Kuvendi të Kosovës dhe si Grup Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re kërkojmë, jo vetëm nga zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri, e cila është pjesë e bisedimeve, por edhe nga Kuvendi dhe nga Qeveria që të bëhet e pamundura që fati i këtyre njerëzve që nuk gjenden në mesin tonë, të zgjidhet.

Mirëpo, jo me deklaramë dhe jo me politika brenda Kuvendit. Mirëpo, me argumente, duke lobuar te instancat më të mëdha si në Bruksel, të cilat duhet të kërkojnë nga Serbia si shtet i cili pretendon të jetë anëtar i BE-së që vuajtjet e familjarëve kosovarë, që përjetuan e tmerrin nga Serbia, të zgjidhen njëherë e përgjithmonë. Kërkoj nga zonja Edita Tahiri, që është e pranishme sot këtu me ne dhe nga ministri i Punëve të Jashtme, që në shumë seanca, të cilat mund të mbahen në javët e ardhshme në OKB, të theksohet edhe njëherë çështja e të pagjeturve, ndërkaq ne si Kuvend t'ua bëjmë me dije Brukselit dhe të gjitha vendeve mike, të cilat na ndihmojnë në procesin e shtet ndërtimit të Kosovës, se për këtë çështje nuk mund të debatohet, mirëpo duhet të veprohet, për arsye se janë ndjenjat e familjarëve që i përjetojnë shumë dhimbshëm. Ne politikën mund ta bëjmë në favor të qytetarëve, mirëpo duhet të kemi kujdes të mos e bëjmë në favor të njerëzve të zhdukur.

Si Grup Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re kërkojmë që institucionet ta ndërmarrin një fushatë intensive, jo vetëm në Bruksel, por edhe në OKB, meqë është e drejtë e çdo familjari të kërkojë familjarin e vet në listën e të pagjeturve dhe të dihet për fatin e tyre. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, zonja Jasmina Živković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Drage kolege poslanici,

Na žalost, ponovo se pokreće tema u kojoj svi pričaju o nekoj osetljivosti, ali niko nije dovoljno osetljiv i spreman da ozbiljno priđe ovoj temi.

Ono što me užasno vređa i kao člana porodice, i kao pripadnika srpske zajednice, jeste to da se vrlo jednostrano priča o ovoj temi, i da su preporuke vrlo jednostrane.

Gospođa Edita Tahiri, zamenik premjera, je iznela zahteve predložene u Briselu i ti zahtevi su prilično jednostrani.

Ono što mene interesuje jeste, s obzirom da se traži odgovornost od Srbije, s obzirom da se traži da Srbija sarađuje, da li je Kosovo ponudilo izvesnu saradnju i izvesnu spremnost da i ono da svoje odgovorne i da određenu odgovornost za sve ono što se desilo.

Nisu se zločini i stvari desili samo na jednoj strani i samo od jedne strane. Ako bismo da krenemo napred, nakon 13 godina, vreme je da ovo pitanje rešimo, ali da rešimo ozbiljno i svi zajedno. A ne da samo prozivamo jednu stranu. Žao mi je što na žalost još uvek ne vidim tu političku spremnost da se ovo pitanje ozbiljno reši. Žao mi je što se još uvek samo debatuje o tome. Jedina mogućnost da se ovo pitanje reši jeste podrška Međunarodne Zajednice, ali da se izvrši ozbiljan pritisak, i na Prištinu, i na Beograd. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Falemnderit! Grupi “6+”? nuk ka të paraqitur.

Atëherë, vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Deputeti zoti Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Falemnderit, zoti kryesues!

Pas sqarimeve që i dha zonja Tahiri dhe diskutimeve të kolegëve tjerë, diskutimin tim unë do ta dorëzoj me shkrim në Sekretarinë e Kuvendit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Osmani.

VJOSA OSMANI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Rezoluta e Kombeve të Bashkuara për dialogun Kosovë - Serbi, e shtatorit 2010, dhe Rezoluta e këtij Kuvendi për dialogun, e marsit 2011, theksoj se ky dialog bëhet për përmirësimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve.

Deri më sot, delegacioni i Kosovës ka qenë shumë i suksesshëm në arritjen e marrëveshjeve që ia lehtësojnë jetën Serbisë, e rrjedhimisht ia dhanë asaj edhe statusin e kandidatit për Bashkimin Evropian. Por, nuk është arritur as edhe një marrëveshje e vetme që do të rezultonte me përmirësimin apo lehtësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Me gjithë faktin se kishte ikur për në Bruksel për të filluar bisedimet një ditë para se ta merrte miratimin nga ky Kuvend, zëvendëskryeministrja ka qenë mirë e informuar se Kuvendi si organ përfaqësues i qytetarëve të Kosovës mendon se nuk ka çështje më të rëndësishme që do ta lehtësonte jetën e afro 2.000 familjeve dhe rrjedhimisht të të gjithë qytetarëve të Kosovës, se sa çështja e të zhdukurve.

Mua më vjen mirë që pikërisht ky shqetësim u konfirmua sot nga të gjitha grupet parlamentare, që nënkupton që ky Kuvend, si organ përfaqësues i gjithë qytetarëve të Kosovës, përsëri e ka po të njëjtin mendim - se zbardhja e fatit të të zhdukurve është shembulli më i mirë, që do ta lehtësonte jetën e qytetarëve të Kosovës. Fatkeqësisht, vullneti i këtij Kuvendi dhe i qytetarëve të Kosovës është shkelur me injorancën që delegacioni i ka bërë kësaj çështjeje. Fillimisht, është dashur që zbardhja e fatit të të zhdukurve të ishte parakusht për fillimin e bisedimeve. Lëre që nuk është bërë kjo, por delegacioni i Kosovës nuk ka pranuar që kjo çështje të jetë primare apo prioritare në dialog, duke lënë të kalojnë muaj të tërë, thjesht për ta shtruar këtë si çështje.

Meqenëse kjo është interpelancë, unë do t'i shtroj këtu disa pyetje, në mënyrë që Kuvendi të informohet më qartë, në qoftë se vërtet është arritur ndonjë rezultat konkret. Sepse ngritja e çështjes nuk është rezultat konkret, është vetëm ngritje e çështjes. Pyetja e parë: Ju keni deklaruar se në arkivat e ish-ushtresë jugosllave dhe mekanizmave tjerë që morën pjesë në luftën e fundit në Kosovë është adresa e të dhënave për fatin e mbi 1.800 personave të pagjetur që prej 13 vjetësh, keni thënë që jeni të bindur se aty është përgjigjja. Nëse tashmë e keni këtë informatë, pse dialogu me Serbinë nuk është kushtëzuar me hapjen e këtyre arkivave në momentin kur statusi i kandidatit për Serbinë varej nga Kosova?

Pyetja e dytë: Pse është kaluar në tema të tjera, pa gjetur zgjidhje dhe pa arritur asnjë rezultat konkret dhe pa marrë asnjë informacion të vetëm për asnjë të zhdukur nga Kosova?

Pyetja e tretë: Pse në raportin konfidencial dërguar Bashkimit Evropian më 16 shkurt 2012, dhe ju e dini për cilin raport e kam fjalën, e unë e kam një kopje të këtij raporti, në qoftë se deputetët duan ta shohin, ju keni përmendur vetëm tri çështje të pazgjidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, po i lexoj ato: 1. energjia, 2. telekomi dhe 3. përfaqësimi rajonal? Derisa sot dhe çdoherë kur keni folur në Kuvend, por edhe për mediet e Kosovës keni thënë që të zhdukurit janë çështje e pazgjidhur. Në qoftë se vërtet mendoni ashtu, pse nuk janë paraqitur në raportin tuaj për BE-në, të datës 16 shkurt 2012, as edhe me një fjalë të vetme?

Pyetja e katërt: Nëse varrezat në Serbi qenkan shumë problem, çfarë është bërë për varrezat që gjenden brenda territorit të Kosovës, por në veri të saj? Rreth dhjetë varreza në veri ekzistojnë dhe nuk mund të bëhet identifikimi i mbetjeve mortore për shkak të problemeve në veri dhe për shkak të problemeve me strukturat paralele, që nënkupton se kjo ekskluzivisht varet nga vullneti i Serbisë dhe kjo është dashur të shfrytëzohet në dialog si informatë me rëndësi.

E pesta: A mund ta konfirmoni edhe njëherë atë që e thatë sot, se BE-ja ka pranuar që të ketë rol udhëheqës në këtë çështje dhe të bëjë trysni mbi Beogradin, sepse ky konfirmim kërkohet meqenëse ata nuk e kanë deklaruar këtë publikisht dhe, e fundit, ju sot thatë se BE-ja është zotuar që Raporti i Progresit për të dyja vendet, Kosovën dhe Serbinë, do ta trajtojë më hollësisht këtë çështje, nga i cili do të dalin obligime për të dyja shtetet. A nënkupton kjo që ju keni pranuar që Kosova dhe Serbia të trajtohen njësoj sa i përket përgjegjësisë së tyre për personat e zhdukur dhe Kosova të barazohet me krimin që e ka kryer Serbia ndaj civilëve të pafajshëm në Kosovë?

Përfundimisht, unë i bëj thirrje ministrit të Jashtëm, që në raportimin e tij në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 15 maj ta ketë prioritet çështjen e të zhdukurve, sepse nuk e ka shtruar asnjëherë deri më sot dhe, e dyta, unë ju ftoj që ta keni primare çështjen e të zhdukurve në vazhdimin e dialogut me Serbinë, e jo objekt të qasjes suaj injoruese e tallëse në mënyrë, që kur të ju përfundojë karriera politike ato familje të të

zhdukurve, që sot janë këtu, të dinë se ju keni bërë diçka për ta dhe në mënyrë që Kosova së paku të ju mbajë në mend bile për një gjë të mirë që i keni sjellë vendit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nënkryetari i “Vetëvendosjes”, zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar familjarë të të rrëmbyerve!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Me sa e dëgjuam, pjesa më e madhe e fjalës së zonjës Edita Tahiri ishte: “Kemi kërkuar këtë, kemi kërkuar atë”, më shumë duke na e prezantuar listën e saj të kërkesave, por kërkesat zonja Tahiri ne i dimë. Pyetja është, cilat janë rezultatet konkrete?

E rezultatet, fatkeqësisht, janë zero. Prandaj, çështja duhet të shtrohet, çka tash, pasi rezultatet janë zero? Përgjegjësia shtetërore nuk është vetëm të kërkosht, por të arrish dhe të japësh përgjegjësi nëse nuk e ke arritur atë që ke premtuar. Prandaj, zonjës Tahiri duhet t’i shtrohen 16 pyetje, mendoj unë, të cilat janë: Pse çështja e të pagjeturve nuk ishte parakusht për Serbinë para çfarëdo bisedimesh me të? Si u bë që Qeveria e Kosovës të heqë dorë nga ky insistim, për të cilin aq shumë qeveritarë rregullisht zotoheshin përpara qytetarëve të Kosovës? Pse çështja e të pagjeturve nuk u bë së paku zyrtarisht temë në dialogun në Bruksel, meqë i keni hyrë tashmë kësaj rruge? A e keni kërkuar nga Serbia ose ndërmjetësi Robert Kuper që Serbia të detyrohet t’i hapë dosjet e saj, të cilat me siguri se do ta zbulonin fatin e shumë njerëzve të pagjetur? A keni kërkuar nga Serbia ose nga ndërmjetësi Kuper dhe pse Qeveria nuk ka iniciuar një hetues të pavarur që do t’i hulumtojë të gjitha çështjet lidhur me rrëmbimin e personave të pagjetur, transferimin e tyre, pastaj transportin dhe zhvarrosjen e kufomave dhe që do ta zhvillonte procedurën legale për ndjekjen e këtyre kriminelëve? A keni kërkuar llogari nga i deleguari i Qeverisë së Serbisë në dialogun në Bruksel lidhur me numrin simbolik të rasteve të proceduara të kriminelëve të luftës në Serbi nga gjykatat atje, e posaçërisht nga e ashtuquajtura “Gjykatë Speciale”, që ishte themeluar më 1 korrik të vitit 2003? A keni kërkuar nga homologu juaj, Stefanoviq, zbardhjen e fatit të profesor Ukshin Hotit dhe kur e keni bërë saktësisht këtë gjë? A e keni konsideruar ndonjëherë idenë që Ukshin Hoti të shpallet udhëheqës i delegacionit të dialogut në Bruksel, pasi dihet se një ide e tillë ishte dhënë edhe atëherë kur u zhvilluan negociatat e Rambujesë, më 1999, si dhe ato të Vjenës, në vitin 2006? Nëse keni kërkuar nga Brukseli trysni të shtuar mbi Serbinë për çështjen e të pagjeturve, a ka ndodhur kjo dhe si ka ndodhur konkretisht, dhe sa jeni të kënaqur ju personalisht? Cila është strategjia apo platforma juaj për çështjen e të pagjeturve gjersa u zhvillua një duzinë rundesh të dialogut në Bruksel dhe u arritën plot 8 marrëveshje me Serbinë atje? Kë e keni këshilltarë në ekipin tuaj për çështjen e të pagjeturve? Kur jeni takuar herën e fundit me ndonjë shoqatë të të pagjeturve në Kosovë dhe me cilën saktësisht? Kur e keni shtruar në mbledhjet e Qeverisë së Kosovës çështjen e të pagjeturve, posaçërisht në lidhje me dialogun me Serbinë, që nisi më 8 mars të vitit 2011? A do të kishit ndryshuar diçka sa i përket trajtimit të çështjes së pagjeturve në dialog në Bruksel sikur të kishit mundësi që gjithçka ta nisnit prej fillimit? Cilat i konsideroni se janë sukseset e cilat dështimet, sa i përket punës dhe rolit tuaj në zbardhjen e fatit të të pagjeturve?

Në fund, kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme ua ka dërguar dy letra në këtë vit, më 20 shkurt dhe më 1 mars, por ju nuk jeni përgjigjur. Shtrohet pyetja, pse? Raportimi juaj i parë dhe i fundit para Komisionit për Punë të Jashtme në këtë mandat të Kuvendit tonë është bërë më 8 prill të vitit të kaluar, më 2011. Pse nuk shkoni të njoftoni e të raportoni në këtë komision? Kjo interpelancë do të ishte shumë më efikase sikur ju tashmë të ishit përgjigjur para Komisionit për Punë të Jashtme. Këto pyetje, të cilat i kam të shkruara, unë po ua dorëzoj zonja Tahiri, me shpresë se do të marrim përgjigje.

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti, zoti Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuara familje të personave të pagjetur,

Çështja e personave të pagjetur është plaga më e rëndë që ka mbetur që nga koha e luftës dhe që është ende aktuale dhe ende e pazgjidhur.

Ne e dimë se Serbia ka bërë gjenocid në Kosovë dhe se këtë gjenocid është munduar ta fshehtë duke bartur njerëz të vrarë, të pafajshëm, gra, pleq, fëmijë, të rinj, duke i varrosur në varreza kolektive, si në Kosovë, ashtu edhe në territorin e Serbisë dhe ta fshehtë krimin. Ne e dimë se nuk ka krim më të madh, e nëse është kështu atëherë përpjekjet për ta mbyllur këtë plagë është dashur të jenë më të vendosura edhe nga Qeveria jonë. Ne dëgjuam kryesuesen e delegacionit tonë në bisedime dhe e përcolla me vëmendje, e cila disa tha se herë është përmendur kjo temë dhe është biseduar. Unë mendoj se nuk ka pasur qasje aq serioze në këtë çështje dhe se delegacioni i Kosovës në bisedime, por edhe vetë Qeveria e Kosovës, do të duhej që çështjen e të pagjeturve ta vinte si çështje kyçe në këto bisedime, madje t'i kushtëzonte bisedimet me zgjidhjen e këtij problemi që ka mbetur që nga koha e luftës.

Nuk do të duhej të realizohej asnjë bisedë me delegacionin e Serbisë pa u gjetur edhe personi i fundit i vrarë në Kosovë, sepse për këtë janë të gjitha mundësitë. Dihet se Serbia i ka arkivat, dihet se Serbia ka bërë gjenocid shtetëror nëpërmjet organeve shtetërore dhe se i ka shënimet për çdo person të vrarë në Kosovë. Unë e dëgjova kryenegociatoren, e cila tha se politika serbe sot më s'ka dallime nga politika e Milosheviqit dikur. Nëse është kështu, atëherë pse uleni e bisedoni me këtë delegacion? Kur dihet se edhe vetëm njëherë po t'u jepej shansi do ta bënin përsëri të njëjtin gjenocid që e kanë bërë në Kosovë. Unë edhe njëherë po e paraqes dhe po e shtroj kërkesën time që Qeveria e Kosovës dhe delegacioni i Kosovës në këto bisedime ta kushtëzojë çdo takim me delegacionin e Serbisë dhe çdo bisedë me Serbinë me çështjen e personave të pagjetur dhe me zbulimin edhe të personit të fundit të pagjetur. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

Zëvendëskryesuese e këtij delegacioni të famshëm,

Të nderuar deputetë,

Për ankthin e pritjes për të ditur për rrëmbimin, zhdukjen dhe me siguri vrasjen e më të afërmve të familjes nuk ka nevojë të komentohet. Këtë të drejtë e mohon edhe e drejta ndërkombëtare, edhe e drejta njerëzore, edhe e drejta e Zotit. Për dukurinë apo gjetjen shpirtërore të atyre familjeve që presin të dinë, fjalën e vet e kanë thënë edhe psikologët, edhe sociologët, edhe të gjithë, sepse po bëhen 13 vjet duke jetuar të gjithë me këtë situatë. Pra, është një shkatërrim total shpirtëror dhe fizik i shumë familjeve shqiptare, përderisa ende vrapojnë, duke e kërkuar të vërtetën e hidhur. Nuk e kam ndërmend ta komentoj këtë situatë, sepse është shumë e njohur nga gjithë ne, madje është debatuar shumë shpesh këtu. Por, unë e kam një pyetje, e nderuara zonja zëvendëskryeministre: Ju, me mandatin e Qeverisë së Kosovës, në emër të Kosovës, në emër të familjeve, keni negociuar me Qeverinë e Serbisë edhe për çështjen madhore për të zhdukurit. Këto biseda janë bërë pa e ditur në të vërtetë se çfarë po bisedohet, pa komente mediale dhe pa komente të tjera së paku nga ju. Prej atij momenti nuk ka dalë asnjë rezultat. Puna është se kërkohen njerëz të zhdukur. Rezultat duhet të ketë, ngase kërkohen varreza masive, kërkohen edhe fakte tjera të krimeve. E dimë se as Qeveria e Serbisë, as subjektet tjera të Serbisë, nuk i pranojnë krimet, por Ju, e nderuara zëvendëskryeministre, a mund të na thoni të vetmen gjë, të paktën të vetmen kërkesë që duan edhe sot ta dinë familjarët? Nëse nuk jeni në gjendje të thoni diçka tjetër për të zhdukurit, a keni marrë informacione se a ka varreza tjera masive në Serbi? A keni informacione se ku janë varrezat tjera masive në Kosovë, në Mal të Zi, apo diku tjetër?

Konsideroj se duhet t'i keni parasysh apo duhet t'i keni mësuar këto informacione. Dhe, merre me mend, se ç'duan të dinë familjarët, e nuk e dinë ende. Por, duhet ta dini se kërkesa e familjeve është se ata i duan familjarët e vet, i duan të gjallë apo të vdekur, dhe duhet ta dinë vendndodhjen e tyre. Dhe, shoqatat e familjarëve janë të bindura se Serbia e di informacionin, ngase vetë i ka vrarë. Dhe, pse e nderuara zëvendëskryeministre nuk keni diçka të saktë të thoni, pasi keni bërë aq shumë takime? Nëse nuk ua thoni këtë njoftim, çfarë keni për t'u thënë konkretisht? Ngase ata janë lodhur me ledhatime politike. Dhe, sa mirë do të kishit bërë ju zëvendëskryeministre, po të kishit ardhur në Mejë në Ditën e të Zhdukurve të Kosovës, më 27 prill, e t'u thoshit të paktën një fjalë të vetme, aty ku ka ndodhur krimi më i madh, aty ku ishin gjithë familjarët e prekur nga e tërë Kosova.

Ftesa i është bërë Qeverisë së Kosovës, u është bërë publikisht edhe gjithë deputetëve, edhe gjithë anëtarëve të Qeverisë, prandaj nuk ua ka ndaluar askush të merrni pjesë të paktën në ditën e të Zhdukurve, më 27 prill. Ju asnjëherë deri më tani nuk jeni takuar me shumicën e kësaj kategorie, bile nuk e keni vizituar asnjë shoqatë, nëse i keni përfaqësuar ata në bisedime, dhe ju në fjalën tuaj, këtu në këtë interpelancë, zonja Tahiri, ndër ato kërkesa, që gjoja i keni bërë, nuk e përmendët Mejën. Meja është masakra më e madhe në Kosovë, pikërisht më 27 prill, prandaj është marrë vendim në Kuvend që kjo të jetë Dita e të Zhdukurve të Kosovës. Prandaj, edhe pse janë vetëm 18 të pagjetur në Mejë, 24 në komunën e Gjakovës, edhe për të zhdukurin e fundit, familjarët njëzëri kërkojnë që ata të gjithë të gjenden. Edhe vetëm një qoftë është shumë i vlefshëm për ne.

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëri po bisedojmë për një çështje, së cilës nuk mund të mos i qasem në mënyrë të njëjtë. U përket të gjithëve, edhe si komunitete, edhe si komunitete etnike, edhe fetare, edhe si grupe politike, edhe si përkatësi regjionale, aty jemi. Dhe, ky Kuvend po bisedon në dy seanca, njërën pas tjetrës, e mendoj se do të mund të ishin një. Është një problem dhe do të mund të shtrohej bashkërisht.

Për më tepër, ndoshta dhe pa përgatitjet e duhura, kemi ardhur këtu me dy propozim konkluzionesh, madje edhe pa i precizuar çka janë ato, ndërkaq është fjala për interpelancë. Do të duhej ndoshta pak më shumë ta shikonim rregulloren dhe të shikojmë se ç'është ajo që është objekt i interpelancës. Dhe, jo çdo çështje pastaj ta shtrojmë, edhe interpelancën si debat, edhe debatin si interpelancë, kurse në fakt të mos na funksionojnë as njëra, as tjetra. Ajo që është e veçanta e kësaj nisme, të cilën unë e përsëris, natyrisht me vërejtjet që bëra, është fakti se është kërkuar që çështja e fatit të pagjeturve të shtrohet në raport me bisedimet me Serbinë dhe, siç është thënë pastaj, në diapozitiv atje të jetë temë prioritare kushtëzuese. Kjo ndoshta është ajo e veçanta e kësaj, por për mua shtrohet edhe një pyetje, e nderuar zëvendëskryeministre. Unë nuk mund të mos i mbështes ato përpjekjet që janë bërë për ta lëvizur këtë çështje dhe kam parasysh edhe faktin se nuk ka mund të jetë kjo tema prioritare dhe kryesore. Është fjala për interpelancë, andaj mendoj se edhe lejohet. Por, pyetja që mua më imponohet është: A është një numër kaq i madh i personave të rrëmbyer, të arrestuar në mënyrë sistematike, të burgosur dhe pastaj të masakruar, të varrosur, të rivarrosur, të dërguar nëpër territore të ndryshme jashtë Kosovës e brenda Kosovës? A është thjesht një temë e negociueshme, apo është krim lufte?

Me çdo kriter, është krim i rëndë i luftës, është madje në këllëfin e asaj që quhet gjenocid, krim gjenocidal. Shtrohet pyetja: Pse nuk e cilësojmë si të tillë? Hyni në internet, ju lutem, dhe shikojini krimet e luftës dhe krimet e gjenocidit. Krahatojini edhe me përvojën tonë këtu. Pse ne rrudhemi për ta thënë të vërtetën ashtu siç është?! Nëse duhet të kemi kujdes, mendoj, duhet të kemi kujdes në ato që po thuhet me të drejtë, të mos e japim në raporte joadekuate, përgjithëse etj., se kjo mund ta dëmtojë edhe vetë shtrimin e saj të drejtë dhe zgjidhjen.

Për mendimin tim, nëse është tani krim lufte, krim i rëndë i luftës, krim gjenocidi, nuk di a duhet të shtrohet çështje në bisedime. A ka bisedime për krime lufte? Krimet e luftës nuk janë çështje të negociueshme. Janë çështje të drejtësisë ndërkombëtare dhe e procedimit adekuat në drejtësinë ndërkombëtare. Kosova nuk ka lëvizur në këtë drejtim, prandaj shtrohet pyetja: A duhet Kosova të jetë përjashtim në këtë drejtim. Edhe vendet përreth, siç e dini, kanë proceduar çështje të tilla në gjykata ndërkombëtare. Pse Kosova të mos e bëjë këtë? Prandaj, edhe sugjerimi im do të ishte që rekomandimet, të cilat përsëri nuk janë cilësuar, ç'janë ato rekomandime, çfarë synohet, një rezolutë, a një akt, që do ta ketë një emër? Në vend të kërkesës që instituti t'i grumbullojë faktet, gjë që po e bën, dhe me sa e di po e bën mirë këtë, por nuk është çështje që duhet të pritet se mund të bëhet brenda një dite.

Të kërkohet që instituti ta kompletojë dokumentacionin dhe ta procedojmë pastaj në organet përkatëse në mënyrën e duhur në relacion me drejtësinë ndërkombëtare. Ky është edhe propozimi im, kurse mendoj se megjithatë do të duhej pasur kujdes në rrezikun për të rënë në grackën e shndërrimit të kësaj çështjeje në një temë negociuese. Si mund të negociohet? Kjo është sikur, ta zëmë, dikush që ia ka rrëmbyer dikujt anëtarin e familjes, ia ka masakruar dhe ky tash të shkojë, e të bisedojë, e të negociojë me të. Çka duhet të bisedojë me të? Çka të negociojë me të? Apo ta legjitimojmë tash në nivel kombëtar, kosovar, atë që është bërë individualisht. Në mungesë të kujdesit institucional, shumë familjarë janë detyruar të hyjnë në tratativa të ndryshme, shpesh manipulative, me burime të ndryshme të dyshimta, kriminale etj., ndonjëherë edhe manipuluese mediatikisht, për ta mbuluar të vërtetën, ndonjëherë edhe për t'i vënë lajthitje dhe për t'i mashtruar financiarisht, materialisht.

Por, Kosova nuk mund të lejojë të bjerë në gracka tilla dhe në lojëra të tilla. Mendoj se kjo çështje i përket drejtësisë ndërkombëtare dhe duhet shtruar si e tillë. Ajo që me të drejtë u theksua në debat këtu, e nuk është theksuar gjithmonë, ka qenë, për mendimin tim, në procesin e përgatitjeve për bisedime. Është normale që si akt i vullnetit të mirë të pasonte së paku një përpjekje e dukshme dhe e ndjeshme për ta zbardhur dhe për ta lëvizur këtë çështje. Mirëpo, me të drejtë shtrohet edhe nga kolegja më përpara, nuk duhet ta shikojmë çështjen njëanshëm. Ka të pagjetur edhe të kombësive të ndryshme, ka edhe të kombësisë serbe. Edhe në këtë drejtim, ne nuk kemi bërë sa duhet dhe është rasti ndoshta për t'i ftuar njerëzit që mund të ndihmojnë që të zbulohen rastet e pazbuluara që lidhen edhe me fatin e qytetarëve serbë të Kosovës.

Kosova nuk duhet të jetë peng dhe të lejojë të barazohet ajo që është e pabarazueshme, të krahasohet ajo që është e pakrahasueshme. Raste individuale të paktën në një luftë, që janë bërë në rrethana të dyshimta, shpesh nga vetë autoritetet e Serbisë, nuk bën t'i lejohen t'i ndajmbathen Kosovës dhe luftës së saj, që është dëshmuar se ka qenë e pastër, dinjitoze e fisnike. Por, për ta dëshmuar këtë tërësisht, është mirë të hiqet edhe velloja e paqartësisë, si të thuash, për disa raste, të cilat duhen sqaruar. Prandaj, edhe unë do t'u bëja ftesë të gjithë atyre që mund të ndihmojnë, le të ndihmojmë që Kosova ta japë provimin dhe të kërkojë pastaj llogari prej atyre që nuk e kanë dhënë provimin. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Falemnderit, zoti nënkryetar! Kryesues i seancës!

Do ta trajtoj këtë çështje pak më ndryshe, sepse edhe në mbledhjen e kaluar kur kemi debatuar, kam kërkuar konkretisht që interesimi i Qeverisë të jetë më i madh, sepse problemi është serioz, e nuk është problem që duhet ta trajtojmë kështu.

Tash specifikisht, kërkesa e kolegëve tanë deputetë, zëvendëskryeministren e cila udhëheq bisedime nuk bën negociata sipas mandatit që ia ka dhënë ky Kuvend, në të cilin grupi im parlamentar ka votuar "kundër", është që ne ta nxjerrim në plan të parë problemin dhe shqetësimin tonë që e kemi. Po i përmendi dy fakte se pse Kosova është e kushtëzuar në raport me këtë çështje, në raport me të zhdukurit, sepse është e tillë dhe

është Qeveria e tretë që pritet të vijë në Serbi që do ta vazhdojë politikën e njëjtë, ndoshta edhe më agresive. E ajo që ne duhet ta sqarojmë është që duhet të themi që ky problem ka dalë jashtë ndikimit të zëvendëskryeminstres, të Qeverisë dhe të institucioneve të Kosovës për arsye që Serbia ka arritur ta barazojë problemin e të zhdukurit të luftës në Kosovë me të zhdukurit e pasluftës.

Dy janë arsyet: arsyeja e parë, i quajtur "Grup i Gjilanit", i cili kryesisht përfshin qytetarët banorë të Preshevës e Bujanocit, është arrestuar dhe është dënua gati me 200 vjet burg në Serbi nga Gjykata për Krime Lufte për veprat që kinse i ka bërë në Kosovë, ku Serbia nuk ka juridiksion dhe krejt "faktet" e kësaj gjykate të Serbisë janë për të zhdukurit serbë, që i adreson në pendën e Livoçit të Epërm në Gjilan. Janë bërë do mostra, është konstatuar se diçka mund të ketë, ndërkaq të gjithë ata që jetojnë aty së paku e dinë se ajo pendë është në aso gjendje të rëndë që nuk mund të vërtetohet kurrëgjë tjetër. Por, njerëzit janë duke vuajtur dënim për të zhdukurit. Dhe, e dyta, është edhe më e rëndë, që nuk duhet ta harroni ju. Edhe vetë kryesuesi i kësaj seance është përlyer, edhe vetë kryeministri i Kosovës është përlyer - Raporti i Dik Martit, i cili flet për të zhdukurit me motiv që organet e tyre të nxirren për trafikim.

Atëherë, ju shtrojeni qysh të doni, edhe thoni qysh të doni, por ndryshimi i këtij raporti është de fakto dhe si i tillë është mirë të trajtohet drejt. Kosova, në raport me këtë çështje të dhimbshme, të cilën disa kolegë tanë po e trajtojnë, po më duket, pak në frymë elektorale, e ka një ikonë dhe e ka një angazhim të vet, sepse i zhdukuri më i madh që ne e përmendim dhe për të cilin gjunjëzohemi përditë dhe lutemi është Ukshin Hoti, dhe mbetet si i tillë. Dhe i fundit, jo në ranglistë, jo me rëndësi, po si emër, është Ahmet Aliajeti, në Gjilan, i cili gjithashtu është i zhdukur. Por, nga fundi dëgjuam kur thanë: "vetëm 18", nuk ka "vetëm" në trajtimin e kësaj çështjeje. Ka të zhdukur! Por, po ashtu është fakt dhe trajtohet drejt si problem. Por, zëvendëskryeministrja e ka obligim të dalë të kallëzojë që këto dy procese kundër Kosovës janë procese të rënda, janë procese të dhimbshme dhe çfarë kanë ndërmarrë nëse Serbia ka arritur ta akuzojë kryeministrin e Kosovës, edhe grupin e madh të Kosovës, në emër të trafikimit dhe të të humburve, të zhdukurve, pse nuk tregon se procesi është kushtëzuar si i tillë, është barazuar.

Dhe, ky është lëshimi më i madh, a e ka bërë politika e jashtme apo e brendshme, nuk është shumë me rëndësi. Me rëndësi është që Kabineti Qeveritar ka përgjegjësi, ndërsa ky Kuvend ka miratuar rezolutë, e ajo rezolutë është obligative për secilin organ kushtetues të Kosovës, dhe trajtimi nuk është adekuat karshi gjendjes. Tash, zëvendëskryeministrja mund të thotë: "Më 18 maj, edhe 8 ditë bëhet rrafsh një vit, s'ka lëvizur kurrëgjë". Tha se kemi dërguar atje ekspertë, që zëvendëskryeministri Kuçi, tjetri zëvendëskryeministër, ka dërguar ekipe të mira, njerëz të ndershmë, të përkushtuar. Anë, çka?! Në fund, ku është rezultati, ku është poenta e krejt asaj që asaj për çka janë bërë këto mobilizime në Kosovë. Poenta e krejt kësaj është se ne kemi dokumente akuzë dhe aktakuzë ndërkombëtare, ndërkaq shteti ynë më i dashur, shteti amë, që është për mua amë sigurisht dhe mbetet si i tillë, atdheu im, ka bërë ligj të veçantë për të lejuar për t'u hetuar krimet, që lidhen kryesisht me të zhdukurit serbë. Pjesa e dytë ka të bëjë me njerëz që punojnë. Të vetmit njerëz që punojnë me dhimbje në këtë proces janë shoqatat e

familjeve, njerëz që janë të lidhur ngushtë me këtë problem që kanë të humbur, të zhdukur, që çdo ditë vuajnë.

Është mirë t'u njihet kjo e drejtë dhe është mirë t'u jepet zyra, instituti dhe organet tjera t'i udhëheqin, sepse vetëm ata janë duke punuar. Edhe zyrën koordinuese të kryeministri, edhe institutet tjera duhet të përfshihen, se Instituti i Mjekësisë, instituti i njohur si instituti i Arsim Gërxhaliut, është pa kapacitete. A e dini që ju një mjet e ka kërkuar ky institut plot dy vjet, e Qeveria nuk ia blen, për të bërë hulumtime, për të hapur gropë, për të kërkuar diçka, por Qeveria nuk ia blen, përderisa ai "bage", po e them në gjuhën e popullatës, është më i lirë se shpenzimet e zëvendëskryeministres! Edhe më të lira se shpenzimet e krejt zëvendëskryeministrave që i kemi. Nuk e blen, as nuk ofron laboratorë që do të duhej ta trajtojnë këtë problem më mirë. Edhe në fund, Presidentja e Republikës, në vend që të bëjë këshilla jashtë-kushtetues, është mirë ta bëjë një këshill për një problem dhe për një prioritet çfarë Kosova duhet të ketë është ky këshill, e ky proces, i cili duhet të hyjë në autoritetin e saj, e t'i grumbullojë e t'i lërë këshillat antikorrupsion, ngase janë organet tjera kushtetuese që marrin me problemet e veta, ndërsa t'i trajtojë ato të cilat popullit i dhembnin, sepse ajo, së paku me Kushtetutë, është përfaqësuesja e unitetit të popullit dhe duhet të jetë përfaqësuesja e dhembjes këtij populli. Edhe duhet t'ia nisë të merret me dhembjet, e jo me privilegjet dhe rezultatet tjera.

Në fund, të nderuar kolegë,

Zëvendëskryeministrja në fund do të dalë të na i arsyetojë krejt këto çështje, edhe do të thotë 'mos keni ju dert se kjo Qeveri është kompetente t'i zgjidhë këto probleme'; kjo Qeveri është përgjegjëse t'i zgjidhë këto probleme një ditë e më parë, përndryshe duhet pranuar se si procesi i tillë ka dalë jashtë dorës dhe u ka dalë jashtë përgjegjësisë, dhe u ka dalë jashtë kushteve, sepse kushtet po i determinon ai që e ka bërë këtë proces të dhimbshëm, ai që nuk po kallëzon ku janë të zhdukurit edhe të humburit e Kosovës, që është dhimbje e madhe për ne. Falemnderit, shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Unë sot, në vend se të flas vetë, do ta lexoj një letër, të cilën motra e Ukshin Hotit ia ka drejtuar këtij Kuvendi. U përmend Ukshin Hoti nga shumë diskutues, prandaj do t'i lexoj nëpërmjet letrës përjetimet e motrës së tij për vëllanë e zhdukur dhe të gjitha përpjekjet që ajo i ka bërë për ta marrë ndonjë informacion sado të paktë për vëllanë e saj.

Letrën do ta lexoj në vetën e parë, ashtu siç është shkruar, për shkak se dua ta ruaj origjinalitetin. "Kaluan shumë vite që unë i krahajoj me shekuj. Prej vitit 1997, moment kur unë e mora përgjegjësinë të kujdesem për vëllanë tim, Ukshin Hoti, i cili ishte i burgosur politik. Përveç vizitave që ia bëja për çdo muaj, më dhembte shpirti që ai qëndronte padrejtësisht në burgjet serbe. Qysh atëherë trokita në shumë dyer për lirim të tij nga burgju, por përpjekjet e mia ishin të kota, ngase nuk e gjeta përkrahjen e askujt. Angazhimet e mia për vëllanë nuk u ndalën asnjëherë. Ato vazhduan edhe në rrethanat e luftës. Gjatë bombardimeve të NATO-s në caqet strategjike të pushtetit serb, unë me

familjen isha e dëbuar në Maqedoni dhe atje përpjekjet nuk i ndala dhe kam arritur të kontaktoj nëpërmjet telefonit edhe me anëtarë të Parlamentit Evropian. Pas përfundimit të luftës, bashkë me forcat e NATO-s, hyra në Kosovë, gjithnjë duke shpresuar se do ta gjeja vëllanë tim. Unë mbeta vazhdimisht në pritje tash e 13 vjet. Përjetova shumëçka në raport me vëllezërit e mi, Ukshinin, Ragipin dhe Afrimin. Ukshini dhe Afrimi i përjetuan tmerrret e burgjeve serbe që nga vitet e '80-ta, ndërkohë që Ragipi u vra si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në vitin 1999. Të gjitha këto ishin vuajtje shpirtërore, mirëpo çështja e vëllait të madh, Ukshinit, për mua ka qenë kapitull i veçantë. 13 vjet të jetosh në ankth e në pritje për informacion për fatin e njeriut më të dashur është rëndë, për të mos thënë e tmerrshme. Të jetosh një jetë të tillë, siç thotë fjala e popullit, pezull, as në tokë e as në qiell, mbi dhe apo nën të, pret e nuk di çfarë do të vijë, e gjithë kjo është me pak fjalë jeta e motrës, e cila e kërkon vëllanë që i mungon. Edhe pas 16 majit të vitit 1999, përpjekjet e mia për zbulimin e së vërtetës për fatin e vëllait tim nuk u ndërprejnë. Vrapoja përsëri në adresa të ndryshme, në zyrat e Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, në zyrën e administratës së UNMIK-ut për të zhdukur, në Policinë ndërkombëtare që vepronte në Kosovë, në zyrat e KFOR-it, KMLDNJ-së, në zyrat e Tribunalit të Hagës në Prishtinë, në zyrat e qeveritarëve vendorë të Kosovës, te presidentë e kryeministra. Madje, kam shkruar dhe dërguar shkresa në të gjitha kancelaritë e burrështetasve vendorë e ndërkombëtarë, me të vetmen kërkesë që të japin ndonjë ndihmë apo informacion për atë se ku ndodhej vëllai im. Kam zhvilluar takime me individë të ndryshëm, të cilët më thoshin vazhdimisht se vëllai im jeton. Fjalët se fjala Ukshin Hoti ishte në mesin e të gjallëve gjithherë më forconin dhe më obligonin që t'i vazhdoj përpjekjet e mia njerëzore për ta gjetur të vërtetën për vëllanë tim. Por, tash unë jam dërrmuar shumë dhe fjalët nuk më bëjnë përshtypje si më parë. Konsideroj se kërkesat e mia hasën në vesh të shurdhër dhe nuk prodhuan ndonjë rezultat konkret. Vazhdoj të besoj se kërkesa ime është e drejtë elementare njerëzore dhe se ajo duhet të mbështetet dhe të më sigurohet informacion konkret dhe bindës për fatin e vëllait tim, Ukshin Hoti". Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryesues!

Ankthi i familjarëve të personave të pagjetur nuk ka përfunduar edhe 12 vjet pas luftës.

Edhe 13 vjet pas përfundimit të luftës, nga numri i përgjithshëm, që ishte mbi 5.000 të zhdukur, kanë mbetur edhe 1.800 njerëz për të cilët mungon çdo informacion. Institucionet tona në njëfarë mënyre nuk janë serioze në qasjen ndaj këtij problemi. Prej shkurtit të vitit 2008, përgjegjësia komplete peshon mbi institucionet e Republikës së Kosovës, por në këtë drejtim borxh dhe obligim kanë edhe institucionet ndërkombëtare, përkatësisht EULEX-i, i cili si mekanizëm ndërkombëtar duhet dhe e ka për obligim të punojë në ndriçimin e fatit të njerëzve. Të trokasë në derën ku mund të merret përgjigjja për fatin e këtyre njerëzve, e ajo derë është Beogradi.

Ata që i drejtojnë kërkesat dhe ankesat në institucione kanë arsye, sepse kjo çështje duhet të jetë vërtet institucionale dhe ata mund të jenë të kënaqur vetëm në momentin kur të dinë për fatin e personave të pagjetur. Prandaj, ata mbase kanë gjithmonë arsye derisa

nuk dinë për fatin e më të dashurve të tyre. Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri tha se në seancën e 10 majit, deputetëve do t'u shpjegohet se institucionet e Kosovës janë të përkushtuara seriozisht në zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur. E, çka është bërë? Çështja e të pagjeturve është një çështje humanitare dhe tendencat që Serbia i ka shfaqur vazhdimisht janë që ta politizojnë këtë çështje. Asociacioni i shoqatave të familjarëve të personave të pagjetur ka kritikuar në vazhdimësi institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare, duke thënë se në këtë drejtim nuk janë duke u angazhuar sa duhet. Kjo çështje duhet të jetë ndër prioritetet e para të institucioneve të vendit.

Përpos neglizhencës për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, ne i injorojmë edhe familjarët e tyre, me një ndihmë materiale që nuk u mundëson as minimumin e ekzistencës. Në kategoritë që nga Qeveria e Kosovës u janë rritur pagat nuk është përfshirë edhe kjo kategori, e cila po përballlet me kushtet e vështira materiale dhe sociale. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Izma ku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Falemnderit, kryesues!

E nderuar zëvendëskryeministre,

Të respektuar kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që të shpreh me të vërtetë një keqardhje për arsye që konsideroj që debati i tillë, me një temë të tillë, me një ndjeshmëri të tillë, ndoshta nuk është dashur të kalojë në një debat të tillë, ku kërkohet medoemos një fitore në raport me njëri-tjetrin.

Mendoj që me përjashtim prej subjektit të “Vetëvendosjes”, kolegët e mi këtu, të cilët i dëgjova, me të vërtetë, me keqardhje e them, me arrogancën, me mënyrën me të cilën iu drejtuan zëvendëskryeminstres, nëse bëhet një balancë pak më e mirë e punëve në të kaluarën, konsideroj që ndoshta moralisht as nuk ishte dashur të flitet kështu. Një temë pra si kjo, nëse secili nga ne nuk është prekur nga të qenët viktimë e një familjeje me të pagjetur, jemi shumica të afërm të njërit nga të vrarët në luftën e fundit; jemi njëri nga familjarët e të masakruarit, e të të zhdukurit, dhe gjithë bashkë po ashtu jemi shumë mirë të informuar dhe të bindur se kush i bëri këto krime. Ku është ajo adresë? Andaj, personalisht i bashkohem këtij shqetësimi për të pagjeturit tanë, si qytetare e një komune që ka me dhjetëra të tillë të zhdukur dhe si deputete e këtij Kuvendi.

Por, e them edhe njëherë, assesi nuk jam bashkë me asnjërin që do ta ngrinte gishtin ta bëjë fajtorin këtu në këtë sallë, të kërkojë ta bëjë fajtorë një zëvendëskryeministre këtu dhe as të mëparshmit zëvendëskryeministra e kryeministra, sepse familjarët tanë po vazhdojnë të jenë të tillë, të zhdukur këtu e 12 vjet më parë. Pra, ankthi i këtyre familjeve nuk ka përfunduar edhe 12 vjet pas luftës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Familjarë të të pagjeturve,

Dhe të gjithë ata që i drejtojnë kërkesat dhe ankesat në institucione kanë arsye vetëm për faktin se kjo çështje duhet të jetë e tillë, vërtet institucionale, si çështje deri në momentin kur përfundon si e zgjidhur. Dhe, familjarët mund të jenë të kënaqur, kushtimisht të qetë, vetëm në momentin kur do të dinë për fatin e personave të pagjetur.

Prandaj, ata mbase kanë gjithmonë arsye. Derisa nuk dinë për fatin e më të dashurit të tyre, zbardhja e fatit të të pagjeturve është një ndër parakushtet kryesore për vendosjen e marrëdhënieve normale fqinjësore ndërmjet të dy shteteve të pavarura dhe sovrane. Dua të rikujtoj se e njëjta storie si me qytetarët tanë vazhdon të jetë e tillë edhe 20 vjet pas luftës edhe në Bosnjë dhe në Kroaci. Në Ditën e të Pagjeturve, shefi i delegacionit të Komitetit të Kuq Ndërkombëtar, Pol Andri, e kishte bërë një deklaratë, duke i ftuar qeveritë e vendeve në hapësirën e ish-Jugosllavisë që mënyrë më efikase ta zgjidhin problemin e 15 mijë të pagjeturve gjatë luftës '91/'99.

Në konferencën për gazetarë, të mbajtur në Beograd, me rastin e Ditës Ndërkombëtare, ai kishte thënë se 3.000 persona evidentohen si të pagjetur nga konflikti në Kroaci. Afërsisht 15.000 në Bosnjë, ndërsa 2.000 persona janë të zhdukur në Kosovë. Duke vlerësuar se është e papranueshme që pas 20 vjetëve ende nuk dihet fati gati i këtyre 15.000 personave, ai thotë se ky problem paraqet pengesë serioze në rrugën e pajtimit dhe bashkëpunimit regjional. Por, këto bëhen nëse bashkësia ndërkombëtare vërtet e shikon aktivitetin e deritanishëm të institucioneve të veta në këtë drejtim, pa e larguar përgjegjësinë edhe nga institucionet tona, se nuk ka të drejtë askush nga ne të kërkojë të falur, t'i harrojmë krimet mizore. Është pra edhe ky fakt. Dhe, ne si deputetë, po e kryejmë punën tonë. Ata që duhet të ekzekutojnë vendime për të gjurmuar deri në fund fatin e bashkëqytetarëve tanë, le ta bëjnë punën e vet. Askush nuk ka qëllime, shpresoj, që në raste tilla të promovojë diçka tjetër, përpos ndjenjës humane dhe kërkesës për ndjenjën e përgjegjësisë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryesues!

Sinqerisht po më vjen keq se jemi duke biseduar për një çështje, sa të ndjeshme, shqetësuese, obligative, edhe detyruese për ne. Më vjen keq, domethënë që gradualisht po fillon të keqpërdoret edhe tema, edhe debati, interpelanca, dhe unë mendoj se asnjë grup, asnjë deputet nuk duhet të tentohet të pengohet, nëse mund të thuhet, ose të vlerësohet, të jepen vlerësimet për mendimet dhe angazhimet shumë të sinqerta të njerëzve, në këtë rast të deputetëve, përfaqësuesve të qytetarëve, për diçka që është një plagë e pashëruar dhe që realisht "kullon", siç thuhet, dhe vlerësimet e tilla nuk qëndrojnë dhe nuk duhet sot këtu asnjë deputeti, as askujt t'i mohohet e drejta, e aq më pak të quhet "arrogancë" ose "amoralitet", nëse mund të thuhet kësaj, nëse e ngre shqetësimin për atë që nuk po bëhet mjaft, sa e si duhet.

Nuk është me rëndësi kush sa ka bërë, por është me rëndësi shumë çka po bëjmë dhe çka duhet të bëjmë në të ardhmen që kjo punë të intensifikohet, të kryhet ky obligim që e kemi. Nuk e themi që kjo është punë mandatare që lidhet me një mandat, por rezultatet janë ato që tregojnë se pak po bëhet dhe nuk duhet marrë këto si sulme ndaj këtij ose atij. Por, realisht kur ta merrsh, siç thuhet në popull "bajrakun" për t'i prirë kësaj pune, atëherë duhet marrë edhe përgjegjësitë edhe angazhimet. Prandaj, unë nuk pashë asnjë diskutues gjer më tani që pati tendencë, përpos asaj që e shfaqti nga një shqetësim. Prandaj, edhe si grup parlamentar, unë lus kolegët të mos të hyjnë me rol të mbrojtjes ose

luajtjes rolit të avokatit, kushdo qoftë prej nesh, nëse kemi përgjegjësi për këtë çështje të ndjeshme dhe ne jemi dëshmitarë të të gjitha këtyre zhvillimeve. Ajo që ka kërkuar edhe e kërkon LDK-ja, pa e zgjatur, pa thënë fjalë të mëdha, është: Të mos bisedohet me Serbinë pa qenë në tavolinë kjo çështje! Të kërkohej detyrim nga Serbia, të kërkohej obligim, e jo të vajtojmë dhe të themi se cilat janë obligimet e Serbisë, sepse këto i dimë, por nuk po i kryen, nuk po i kryen as bashkësia ndërkombëtare. Dhe, ajo që e kemi thënë si LDK, nuk do ta them asnjë fjali më shumë, është që kjo të jetë në agjendë, të jetë në rend të ditës, por kështu nuk po veprohet në bisedimet e gjertanishme. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Regjia, kjo ishte replikë. Kundër-replikë, të mos llogaritet koha. Kundër-replikë, deputetja Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Falemnderit, kryesues!

Edhe njëherë po e shoh që po i referohesh fjalës, zoti Beqiri. Mendoj që ndoshta është dashur të reagojnë kolegët që folën paraprakisht, pra Vjosa Osmani, apo edhe Lutfi Haziri. Këtu e kisha fjalën se me të vërtetë nuk e di kë nuk e preku mënyra qysh u drejtuan. E konsiderova që këtu e kisha përpara një armik, e jo një zëvendëskryeministër, e fundit - një përfaqësuese institucionale.

Pra, arroganca u shpreh në atë mënyrë, përndryshe nuk jam avokate e askujt. Po flas si deputete. Kaq!

KRYESUESI: Deputetja Osmani, replikë.

VJOSA OSMANI: Zonjë, po e përsëris atë që e tha kryetari i Grupit parlamentar, sepse ju i akuzuat disa parti politike, jo individët, që nuk jeni askushi dhe nuk jeni në gjendje dhe as e informuar që ta vlerësoni dikë si arrogant. Nën dy, pyetjet që unë i bëra për zëvendëskryeministren ishin shumë të qarta. Unë po shpresoj vërtet që do të marrim përgjigje. Ato kanë të bëjnë me dokumente konkrete, që unë ju rekomandoj t'i lexoni para se të jepni vlerësime të tilla.

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Lutfi Haziri, replikë.

LUTFI HAZIRI: Falemnderit zoti nënkryetar, edhe njëherë! Sa për t'ua përkujtuar, unë konstatova, ia ktheva memorien dy procese kanë ndodhur në emër të të zhdukurve. Njëri një grup është dënuar me 200 vjet, për punën që ka bërë në Kosovë dhe në emër të të zhdukurve pas luftës, ndërsa i dyti e ka përlyer nënkryetarin e Kuvendit të Republikës sime dhe kryeministrin e Republikës sime, që janë të partisë së zonjës që po reagon pa dëgjuar mirë çfarë thashë. Këtu nuk ka dallim. Unë e konstatova gjendjen. Në vend se ta mbronin dhe të thonin se është fakt i tillë, ju po konstatoni se nuk duhet përmendur këtë punë. Po, sepse në emër të të zhdukurve është bërë një raport ndërkombëtar, i cili i akuzon autoritetet më të larta të Republikës sime, të shtetit tim.

Dhe, këtu duheni të jeni më të singertë, sepse ne nuk po dallohemi pozitë-opozitë. Ne këtu po flasim si deputetë, të cilët e njohin procesin. Se sa kem punuar deri t'i nxjerrim numrat e të kallëzojmë më herët, nëse duam ta zbardhim. Por, kjo Qeveri e ka ngrënë kushtin që Serbia e ka vënë, kushtin e kushtëzimit. S'mund ta nxjerrë në tavolinë si prioritet, sepse po rrëshqet. Qeveria e tretë në ardhje, kjo Qeveri, e ka pranuar kushtin që të barazohen të zhdukurit shqiptarë në luftë me të zhdukurit e pasluftës.

Argumentin, po ta përsëris edhe njëherë, shënoje se të duhet zonja Izmaku, dy procese të mëdha janë zhvilluar, një në Beograd dhe një në Strasburg, dhe për t'i mposhtur këto, zëvendëskryeministrja duhet të dalë të kallëzojë çfarë ka bërë, të tregojë që ne s'kemi faj, po faji është tjetërkund. E ata njerëz janë shqiptarë, mos harroni! Rusisht kanë lindur në Preshevë e Bujanoc. 200 vjet burg i kanë marrë për të zhdukurit e pasluftës. Nuk kanë argumente e fakte të tjera. Veç është thënë "Penda e Livoçit", u hi dikush e ka thënë: "Po, ka diçka", e çka ka askush s'e di. Njerëzit janë dënuar nga 20 vjet burg...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zonja Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, zonja Osmani, për atributin e askushit dhe të ju them shumë sinqerisht, e kam fjalën vetëm për mënyrën e komunikimit se qysh ju drejtoheni, assesi për fjalët qysh i thatë dhe ju përcolla me shumë vëmendje. Pra, jo këtë herë, po 99% i përcjell fjalimet e kolegëve të mi deputetë. Edhe njëherë mendoj se mënyra qysh keni komunikuar, nëse e ktheni regjinë, e shikoni dhe e shihni...

(Ndërhyrje)

Do të merrem me mënyrën qysh ti komunikon dhe qysh i drejtohes zëvendëskryeministres sime, pra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Mendoj që ato që unë kisha ndërmend t'i them veç u thanë prej kolegëve të mi, pasi kam kontribuar edhe në seancën e fundit në këtë temë. Fjalën time do ta dorëzoj me shkrim tek administrata. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Që prej një viti, delegacioni i përfaqësuar nga Edita Tahiri nuk e ka përmendur më çështjen e të pagjeturve as në të ashtuquajturat bisedime, as në deklaratimet zyrtare. Pikërisht, në maj të vitit 2011 ka qenë hera e parë dhe e fundit kur është diskutuar në Bruksel për këtë çështje. Që prej asaj kohe nuk ka ndodhur asgjë e re, përveç se edhe një vit tjetër i është shtuar mungesës së tyre.

Sot, në emër të shoqatës Thirrjet e Nënave, në Gjakovë, do ta lexoj një letër drejtuar zonjës Edita Tahiri:

Dihet që komuna e Gjakovës ka pësuar gjenocid nga ish-pushteti i kriminal serb, pa kursyer moshë, apo gjini.

Komuna e Gjakovës doli nga lufta me 750 të vrarë dhe 726 të rrëmbyer e të zhdukur. Ndërsa sot, pas 13 vjetëve, ende nuk dihet për fatin e 65 qytetarëve të kësaj komune, kurse Kosovës i mungojnë ende edhe 1.781 qytetarë të tjerë.

Qeveria e Kosovës gjithmonë ka theksuar se prioritet është zbardhja e fatit të të pagjeturve. Dhe ju, zonja Tahiri, keni theksuar se ky prioritet do të bisedohet me palën serbe, por, siç dihet dhe siç shihet, ky prioritet as që është zbatuar, gjë që i ka zhgënjyer familjarët e të pagjeturve, pasi na tregon se në të vërtetë ju kurrë nuk e keni pasur si prioritet zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Në emër të shoqatës Thirrjet e Nënave nga Gjakova që merret me zbardhjen e fatit të personave të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë 1998-1999 do t'i drejtohem zonjës Edita Tahiri me këto pyetje:

Nën 1. Pse Kosova është kushtëzuar t'i plotësojë kushtet për kthimin e serbëve, ndërsa Serbia vetëm po përfiton nga ky gjumë i thellë i politikanëve kosovarë, duke mos u kushtëzuar për kthimin e shqiptarëve të pagjetur?

Nën 2. Pse nuk është kërkuar kurrë nga pala kosovare që Serbia të kushtëzohet dhe të detyrohet t'i kthejë trupat e pagjetur, meqë ajo e di me saktësi vendin se ku i kanë dërguar?

Nën 3. Pse nuk keni kërkuar nga Bashkimi Evropian dhe nga ndërkombëtarët që të bëjnë presion mbi Serbinë e ta detyrojnë t'i tregojnë kriminelët që i vranë dhe zhdukën qytetarët e pafajshëm kosovarë?

Pse nuk kërkon ta detyrojnë Serbinë të kërkojë falje për gjenocidin e zhvilluar në Kosovë?

Zonja Tahiri,

Këto pyetje dhe njëherësh kërkesa, qëndrojnë në suaza të të drejtave të njeriut dhe janë të drejta themelore dhe shpirtërore. Ne duam të dimë për vendndodhjen e më të dashurve tanë, andaj dëshirojmë të ju bëjmë me dije se çështja e personave të pagjetur është çështje mjaft e dhimbshme, që kërkon angazhim të madh dhe duhet të keni kujdes kur thirrreni në emrin e tyre, sepse nuk duam fjalë, por punë, duam angazhim real nga ju.

Letrën po ua dorëzoj juve, zonja Tahiri, meqenëse udhëtimet Bruksel-Prishtinë dhe takimet me Stefanoviçin nuk ju lanë kurrë kohë t'i takoni nënat. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Sali Asllanaj e ka fjalën.

SALI ASLLANAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministre!

Së pari, e kam një protestë. Kur e kam shtypur sustën, kam qenë i paraqituri i pestë. Dola i pesëdhjeti! Çka u bë? Kjo ka të bëjë me menaxhimin tuaj, nënkryetar!

Unë mendoj se është mirë që për këtë çështje kaq madhore tonën po e bisedojmë së paku dy herë për një javë në Parlamentin e Kosovës. Të mos mbeten vetëm fjalë këto, por të kthehemi në vepra. Kemi pretenduar që ne nënshkruesit e kësaj iniciative ta ngremë nivelin e përgjegjësisë së Qeverisë që t'i ndryshojë pak prioritetet, e që prioriteti i të zhdukurve të jetë diku lart në listën tuaj të Qeverisë. Ky ka qenë vlerësimi im personal se pse e kam nënshkruar këtë iniciativë për interpelancë. Besoj edhe i të tjerëve.

Në këtë aspekt, mund të them se me vëmendje e dëgjova zëvendëskryeministren për raportin që e paraqiti për bisedimet në Bruksel. Zonja Tahiri, ishte kënaqësi ta dëgjojmë atë, ndërkaq shpresoj që në të ardhmen do të bëni edhe më tepër, por unë kisha dashur që disa nga fjalët tuaja, pra të pikave të numëruara, t'i kishit shndërruar në kushtëzim. "Kemi kërkuar, kemi kërkuar, kemi kërkuar!". "Kemi insistuar", ishte fjala më e fortë. Pra, kisha dashur t'i dëgjoj edhe fjalët "Kemi kushtëzuar".

A e kemi autoritetin, a kemi atë stabilitet të mjaftueshëm që të kushtëzojmë diçka? Unë mendoj që e kemi pasur mundësinë ndoshta edhe të kushtëzojmë, që së pari të bisedohet për këtë çështje, e cila do të ndihmonte dhe t'i lehtësonte bisedimet tjera dhe në lëmi të tjera. Nuk them që janë të parëndësishme edhe çështjet tjera që i keni biseduar, për të cilat gjëra keni arritur marrëveshje, të cilat objektivisht për mua janë ndoshta nën rangun e kësaj marrëveshjeje eventuale që do ta nënshkruajmë për gjetjen e të pagjeturve.

Tjetra! Unë do të kisha dashur të dëgjoj prej jush, zonja zëvendëskryeministre, por edhe prej Qeverisë, që ta ndihmojmë Institutin e Mjekësisë Ligjore. Do ta forcojmë edhe teknikisht, edhe me burime njerëzore që ato 400 mbetje mortore do të identifikohen dhe do t'i kemi 400 raste të zgjidhura. Kjo shifra 1.781 do të figuronte pak më e vogël!

Në të njëjtën kohë, do të kisha dashur ta bëj si kulturë të punës suaj që në çdo xhep tuajin të dhatit ta kishit në notesin tuaj këtë numrin 1.871 të pagjeturve. Pra, në përkujtuesin tuaj elektronik ta kishit atë. Dhe, në çdo bisedë, në çdo ulëse, kur të uleni, të bisedoni për këta njerëz.

E kam pasur rastin, si kryetar i Komunës, por edhe më vonë, që të takohem shpesh me këta familjarë. Këta kanë bërë shumë. Kanë bërë përpjekje mbinjerëzore të arrijnë diçka. Mirëpo, mundësitë e tyre kanë qenë të vogla. Sikur ne qeveritarët, apo ne pushtetarët, komplet, edhe të Parlamentit, të mos i ikin përgjegjësisë, dhe ta kishim 1% të angazhimit të tyre, konsideroj se do të kishim bërë punë të madhe.

Prandaj, ju kisha lutur zonja zëvendëskryeministre... Po ju përmend juve, sepse rastësisht ju jeni tash udhëheqëse e delegacionit tonë, por me këtë rast edhe Qeverisë i isha lutur që të bëjë përpjekje maksimale që të zgjidhet fati i këtyre njerëzve.

Do ta kishim hequr një borxh të madh moral, do të kishim hapur dyer të reja për bisedime, për shtensionim, për ofrim, sepse armiqësia nuk duhet të zgjasë gjithmonë. Duhet të paramendojmë se edhe me Serbinë duhet të krijojmë raporte të mira në të ardhmen. Por, këto janë disa pengesa, të cilat nuk na lejojnë. Desha edhe diçka, por Xheva nuk qenka këtu.

Në këtë aspekt, opozitarizmi im do të ishte pika e fundit. Në këtë aspekt, do të bisedoj ndoshta si një anëtar i pozitës, por në këtë rast paraqes shqetësimin e qytetarëve.

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Hoti e ka fjalën.

(Diskutim, pjesërisht i dorëzuar me shkrim)

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë do ta lexoj një letër nga disa familjarë të të pagjeturve nga trevat e Drenicës gjatë luftës së fundit.

“Krimet serbe ndaj shqiptarëve kanë qenë sistematike dhe të tmerrshme. Mundësitë dhe kundërvënia ishin gjithnjë të vogla dhe të paorganizuara. Të dhënat historike, edhe pse të pasistemuara sa e si duhet, flasin mjaft qartë për shumicën e tyre. Ato ishin të shumta dhe të vazhdueshme, me një qëllim të përhershëm për shfarosjen dhe zhdukjen e të gjithë shqiptarëve nga Kosova dhe nga viset tjera etnike, të cilat padrejtësisht ishin ndarë nga shteti amë, Shqipëria.

Veprimet kriminale shtetërore serbe e arritën kulmin e tyre gjatë luftës së viteve 1998-1999, kur me planet dhe projektet e tyre shtetërore angazhuan ushtrinë, policinë, njësitet paraushtarake dhe popullatën lokale serbe në luftë kundër njësiteve guerile shqiptare, të njohura si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e që në fakt ishte luftë frontale kundër gjithë popullatës shqiptare, e përshkruar me elemente të shumta të krimeve të rënda kundër njerëzimit dhe të gjenocidit.

Njëra nga trevat më të piketuara nga pala serbe, e cila konsiderohej si bastion më i fortë i Shqipërisë, ishte Drenica, dhe pikërisht aty ishin planifikuar të zhvilloheshin luftime dhe të bëheshin krimet më të mëdha, të cilat do të ushtronin ndikim frikësues në viset tjera shqiptare, siç ishte planifikuar për të vepruar nga forcat shtetërore jugosllave përkatësisht serbe, por rezistenca më e madhe dhe më heroike shqiptare ishte organizuar pikërisht nga popullata e Drenicës, ku UÇK-ja, me komandantin e saj Adem Jashari, e kishte ngritur follenë. Dhe, në pamundësi që të përballlet gjoks me gjoks me ushtarët trima të kësaj treve, forcat ushtarake policore serbe vritnin dhe masakronin, merrnin peng civilë shqiptarë, shumica e të cilëve u evidentuan të zhdukur dhe si të tillë kanë mbetur edhe sot e kësaj dite. Pra, pas plot 13 vjetësh nga përfundimi i kësaj lufte në Kosovë, treva e Drenicës, mbetet njëra ndër viset më të dëmtuara, me shumë të vrarë dhe të zhdukur.

Ndër masakrat e mëdha dhe të tmerrshme të kësaj treve, ku u vranë dhe u masakruan, u dogjën dhe u zhdukën shumë shqiptarë, ishin ajo në Izbicë, Rezallë, Qirez, Paklek e të tjera.

Aktualisht, komuna e Drenasit i ka edhe 66 të pagjetur. Komuna e Skenderajt i kishte gjithsej 520 qytetarë të evidentuar, prej tyre janë gjetur 364, ndërsa kanë mbetur edhe 156 ende të pagjetur. Të vrarë, në komunën e Skenderajt janë evidentuar 850 qytetarë shqiptarë.

Prandaj, sikur edhe në viset tjera të Kosovës, për këta njerëz të pagjetur është bërë shumë pak deri më tash. Prandaj, do të ishte mirë të dimë se çka parashihet të ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës për tejkalimin e kësaj gjendjeje shumë të rëndë, me të cilën përballen familjarët e të pagjeturve të vendit dhe të kësaj treve kaq shumë të goditur nga pasojat e luftës së fundit në Kosovë. Pra, do të ishte mirë të dimë nëse ka ndonjë plan pune apo strategji dhe për këtë të informohet opinioni ynë.

(Afrim Hoti, d. v.)

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Është shumë e dhembshme që nganjëherë identiteti politik po dominon mbi atë njerëzor dhe po më vjen shumë keq që po tregohet i gjithë ky oportunizëm politik në raport me një temë që nuk është as politike, as partiake, as pozitive, as opozitive, por po flasim për një diçka që mbi të gjitha është njerëzore, e nganjëherë po harrojmë që përtej politikës është njerëzorja. Prandaj, do ishte mirë të flasim në formë dhe mënyrë pak më pragmatike dhe të gjithë t'i kryejmë punët tona pak më mirë, e të provojmë t'i obligojmë ata që janë përgjegjës ta kryejnë punën e tyre më mirë dhe ta kemi një përgjigje dhe rezultate më konkrete.

Po kthehem te ajo se si ka shkuar ky proces. Prej fillimit, është e vërtetë se nuk kemi pasur transparencë dhe shumë herë nuk është thënë e vërteta për dialogun me Serbinë. Shumë herë është folur për vija të kuqe nga zëvendëskryeministrja dhe Qeveria, mirëpo edhe vetë këto vija të kuqe shumë herë janë shkelur.

Kosova, edhe me këtë rast, ka bërë koncesione të mëdha dhe nuk e kemi pasur asnjë të arritur, as më të voglën. Dhe, kjo e arritur do të ishte të paktën që të kemi informata, të kemi detaje, të kemi të dhëna rreth të pagjeturve. E dimë që ka qenë luftë, ka qenë proces shumë i vështirë, mirëpo nuk po shihet që ekziston një gatishmëri që nga të gjitha këto koncesione që i ka bërë Kosova të përfitojë vetëm një, në një segment, ose në një fushë. Absolutisht, jo!

Ne kemi pyetur në vazhdimësi se çka po ndodh. Pyetjeve tona se ky dialog po bëhet me qëllim të lehtësimit të jetës së qytetarëve, unë ua kisha dhënë sot një përgjigje zëvendëskryeministres.

Të paktën, në raport me të pagjeturit, nuk po shihet se është bërë një lehtësim, e nëse është bërë, e nëse kemi afate kohore, ju lutem të dilni e të na raportoni.

Ju treguat për angazhimet tuaja, po ato nuk janë veprime që kanë rezultuar me suksese. Çka të presin familjarët e të pagjeturve nëse ju, me gjithë prezantimin tuaj, treguat se cilat kanë qenë angazhimet tuaja, por nuk dhatë asnjë përgjigje se çka mund të presin këta njerëz, cilat janë afatet kohore, a ka afate kohore dhe a ka shpresë se do të ketë informata se ku janë këta njerëz, ku kanë mbetur dhe a do të kemi në të ardhmen, bazuar në dialogun të cilin ju po e udhëhiqni, në emër të të drejtave të njeriut dhe lehtësimit të jetës së qytetarëve, të marrim informata që janë me prioritet.

Unë kisha dashur t'ua bëj këtë pyetje. Kisha dashur që pas një kohe të shkurtër të vini e të na raportoni konkretisht në Parlament për rezultatet, për pritjet dhe për afatet kohore.

Dhe, krejt në fund, kisha dashur t'i dija veprimet, të cilat i keni ndërmarrë, për marrëveshjet që ju po i quani të suksesshme dhe veprimet, të cilat janë ndërmarrë në raport me të pagjeturit - a e keni marrë bekimin e kryeministrit Hashim Thaçi. Pra, a qëndron ai prapa këtyre vendimeve, veprimeve dhe konkluzioneve të ndërmarra nga ju? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Veoma mi je teško da danas govorim o ovom pitanju, o pitanju gde se danas beskrupulozno bombardujemo informacijama o stravičnim zločinima na našim prijateljima, komšijama, sugrađanima, a o čijoj se neizvesnoj sudbini samo nagađa.

Mislim da je krajnje vreme da se problem nestalih i kidnapovanih stavi na dnevnom redu između dve strane, između Beograda i Prištine, dva bitna faktora koji odlučuju o sudbini stanovništva na Kosovu, a koji bi što hitnije trebali da pređu i na ovu tačku. Ali, da bi rezultati bili bolji po ovom pitanju i međunarodna zajednica treba da uloži maksimalne napore.

Gospodo poslanici,

Ova tuga traje već 8, 10 ili 13 godina. I da li se od nas neko zapita kako je porodicama nestalih i kidnapovanih, koji sa suzama i strepnjom očekuju osvit zore.

Da li se neko pita kako je sestrama, majkama, koje ne gube nadu, suprugama koje ne prestaju da pišu pisma, zahteve i molbe za pomoć.

Problem nestalih i kidnapovanih lica za nekog su teret prošlosti, a za mnoge, na žalost, predstavljaju sadašnjost i budućnost sve dok se krivci ne nađu i izvedu pred licem pravde.

Gospodo poslanici,

Veoma je važno izjednačiti sve žrtve, bez obzira na pol, rasu, nacionalnu pripadnost. Takođe, veoma je važno da sledimo principe istinitosti, operativnosti, humanosti,

zakonitosti a da u granicama zakona nastavimo da tražimo istinu, upravo istinu koja je više nego teška.

Postavljam pitanje, vama gospođe Tahiri: Da li vi mislite da je problem nestalih važan samo za albansku stranu, i da rasvetljavanje sudbine nestalih treba da bude usmereno samo za Albance?

Pitanje nestalih je itekako veoma važno i za Srbe, i za sve druge kidnapovane i nestale na Kosovu, i ne samo u periodu 1998. i 1999. godine, nego i posle ratnih sukoba kidnapovano je. Vi ne trebate potiskivati jednu stranu, jer kidnapovano lice je svako lice čija se sudbina ne zna, bez obzira na nacionalnost, boju kože, pol i drugo.

Želim, gospođo Tahiri, da vas podsetim na još jednu činjenicu. Da ste vi u dijalogu sa Beogradom predstavnica celokupnog naroda na Kosovu. Hvala vam!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Do ta dorëzoj me shkrim!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit shumë, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Mysafirë nga familjet që i përfaqësoni familjarët e zhdukur, me një dhimbje të madhe, e cila po vazhdon ta vuani, së pari ju, dhe njerëzit e vullnetit të mirë.

Unë ndoshta isha pajtuar me mendimin me kolegen Izmaku, sepse është shumë e paarsyeshme të sulmohet zëvendëskryeministrja e Kosovës, e mandatuar për bisedime, sepse është dashur të jetë kryeministri i Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, i cili e ka edhe përgjegjësinë politike të Ekzekutivit të vendit dhe mendoj se arsyeja kryesore ekziston te vullneti politik i Qeverisë dhe kushtëzimet që i bëhen në raport me njerëzit, në mënyrë individuale.

E dyta, nuk ka faj ndoshta zëvendëskryeministrja e Kosovës, se ministri i Punës së Mirëqenies Sociale e ka ndërprerë aplikimin për pension me arsyetimin se Fondi Monetar ka kërkuar verifikimin e njerëzve se a janë të zhdukur - po, ose jo? Prandaj, ky është obligim i Qeverisë.

Nuk ka faj zëvendëskryeministrja e Kosovës që ministri i Drejtësisë për 5 muaj nuk mund ta gjejë një ekskavator që të verifikohen vendet, të cilat trajtohen se mund të ketë persona të zhdukur gjatë luftës.

Mendoj se nuk ka faj as zëvendëskryeministrja..., qe shkoi edhe kjo, fatkeqësisht, sepse as ministri i FSK-së, si komandant i Shtabit të Përgjithshëm, në emër të zonave të lira, kur masakroheshin nga 100 persona në ditë, siç është rasti i Lubeniqit, janë disa çështje

që mendoj se edhe kolegët deputetë, në raport me interpelancën e kërkuar nga Grupi Parlamentar me shumë arsye, duhet t'i trajtojnë në mënyrë pak më shumë të ndershme.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri duhet të dijë, sepse është shumë e qartë që ekzistojnë edhe raporte ndërkombëtare për personat e zhdukur, për të cilët flitet qartë, se në vende, sikur është Batajnica, ka pasur djegie masive të kufomave. Dhe, kjo duhet ta kërkojë përgjigjen te Stefanoviqi, apo te dikush tjetër.

E dyta, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri duhet ta ketë të qartë se në procesin juridik të trajtimit të krimeve të luftës dhe barazimit me krimet e pasluftës, gjatë zhvarrimeve të gjurmimeve për të zhdukurit nuk lejohet asnjë prokuror, gjykatës hetues, ekspert i mjekësisë ligjore nga stafi vendor. Dhe, kjo është tema që zonja Edita Tahiri, në koncesionet që i bën me miqtë, edhe ndërkombëtarë, e s'po flas për palën serbe, sepse e dimë cili është trajtimi i tyre në raport me Kosovën, duhet të mendojë mirë e qartë, sepse është një tendencë, jo vetëm e arsyeve humanitare, por është një tendencë e përgjegjësisë shtetërore për Serbinë dhe krimet e gjenocidin që i ka bërë, të trajtohen apo të barazohen dhe t'i ikin drejtësisë nëpërmjet fakteve relevante që i paraqet drejtësia dhe ligjet ndërkombëtare.

Prandaj, unë e kuptoj gjuhën e saj diplomatike, që thirret në konventat, se kjo është çështje humanitare. Ekziston se duhet të jetë çështje humanitare, por kjo ka të bëjë me krimet që janë kryer gjatë luftës dhe vazhdojnë deri sa personat janë të zhdukur, e vazhdohet të kryhet prapë krim në vazhdimësi, jo vetëm ndaj familjeve, por ndaj Kosovës, si tërësi.

Prandaj, këto pyetje dhe pyetjet tjera që zonja Edita Tahiri duhet t'ua shtrojë edhe miqve ndërkombëtarë, pasi po fshihen pas tyre, edhe serbe tash në bisedimet e autorizuara nga kryeministri Hashim Thaçi dhe t'ua bëjë të qartë se si është e mundur që akoma 400 trupa që janë në murg, familjarët e tyre nuk kanë informata se pse qëndrojnë ato aty dhe prej cilave vende janë ata trupa. Prandaj, unë i shoh se janë të vendeve të krimit, të kryera gjatë luftës.

Pyetjet për zonjën Edita Tahiri, e cila duhet t'ia adresojë palës serbe. Të kërkojnë informatat ku janë, kush i fsheh, cili është qëllimi i kësaj? A po tentohet të barazohet gjenocidi e krimi me elementet, që i përmendën edhe kolegët tjerë?

Prandaj, kolegë të nderuar deputetë, edhe kolegët të cilët kanë kërkuar interpelancë parlamentare me zëvendëskryeministren Edita Tahiri për trajtimin e çështjes së fatit të zhdukur, mendoj se nuk duhet ta kufizojnë në një rajon të caktuar, por si tërësi, si një dhembje e madhe që vazhdon t'u shkaktohet jo vetëm familjeve, por gjithë njerëzve të vullnetit të mirë.

Dhe, ajo që është më kryesorja, është të themi se kjo qeveri, konkretisht Edita Tahiri ka rrëshqitur, me dashje a pa dashje, pra ka rrëshqitur në një çështje, e cila tash do të jetë shumë më shumë problematike - trajtimi i krimeve dhe gjenocidi që ka ndodhur gjatë luftës me kushtëzime, të cilat janë krime ordinere, të kryera pas luftës. Dhe, kjo nuk

duhet të lejohet. Ose duhet të stopohet tash me 18 maj, ose duhet me formë të kushtëzimit, jo vetëm në raport me trajtimin e bisedimeve apo të ashtuquajtura negociata, edhe pse përgjegjësia politike po shihet edhe sot nga kabineti qeveritar, po shihet edhe nga detyrimi i deputetëve që vetëm me interpelancë të raportohet në seancë plenare dhe të njoftohen edhe shoqatat e familjeve dhe i gjithë opinionin se çfarë do të ndodhë, por edhe arsyet e institucioneve tjera më të larta shtetërore, e mos të harroj ta cek edhe presidenten e vendit, e cila fatkeqësisht ose fatmirësisht, duhet të them, që nuk gjen kohë për çështje të rëndësishme, por gjen kohë, të themi, edhe me paratë publike të marrë pjesë në “ballo”, të cilat janë shumë më pak të rëndësishme se sa përkujtimi për ditët e të zhdukurve. Prandaj, nuk duhet ta lejojmë ne si deputetë, të cilët kemi përgjegjësi si organ më i lartë ligjvënës, që këto tema të mos të trajtohen vetëm shkarazi politike, por të përcillen në vazhdimësi, e për këtë arsye është edhe Komisioni Funkcional. Ju falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Zemaj! Fjalën e ka deputetja, zonja Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Falemnderit, kryesues!

Do të provoj të flas sa më shkurt! Nuk do të lexoj letër sot, por do të flas në emër të të pagjeturve, jo vetëm si deputete e këtij Parlamenti, por para së gjithash si bashkëfamiljare dhe bashkëvendësve e shumë prej të zhdukurve nga fshatrat Izbicë, Likoshan e Qirez të komunës së Skenderajt.

Sot, kur po e diskutojmë fatin e të pagjeturve, nuk mund t'i anashkaloj edhe 41 bashkëfshatarë të mi të fshatit Rezallë, të cilët 13 vjet më parë u pushkatuan, u hodhën në një gropë, e vetëm 11 ditë më vonë u zhvarrosën për të mos u gjendur ende, me qëllim që të fshihet krimi makabër i pushtetit ushtarako-policor i Serbisë.

Familjarët e tyre, ditë më parë, e kanë përkujtuar përvjetorin e 13-të me të njëjtën pyetje, e cila po i mban në ankth 1.781 familje kosovare. E kjo pyetje duhet ta ngacmojë edhe ndërgjegjen tonë.

Çështja e të pagjeturve është shtruar edhe më herët në dialogun teknik Prishtinë-Beograd në Bruksel, konkretisht në rundin e katërt të bisedimeve. Me këtë rast, Qeveria ka bërë përpjekje që këtë çështje ta ngrejë në nivelin e trajtimit të Bashkimit Evropian, duke kërkuar që Bashkimi Evropian ta marrë rolin udhëheqës në zgjidhjen e këtij problemi.

Hapja e arkivave të ushtrisë dhe të policisë serbe për periudhën e viteve të luftës, si dhe të viteve të paraluftës, do të na ndihmonte në gjetjen e informatave të besueshme rreth zgjidhjes së çështjes në fjalë. Kërkesat për t'u hapur këto arkiva kanë ekzistuar edhe në vitin 2004, në vitin 2005 por edhe në vitin 2006, në bisedimet e Vjenës për statusin final të Kosovës.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar familjarë të të zhdukurve,

Unë konsideroj se të gjitha këto të dhëna duhet të na shërbejnë që të mos shpenzojmë energji kundër njëri-tjetrit, por të orientohemi aty ku është problemi. Presioni, kërkesat tona, por edhe energjia duhet të orientohen në një vend. Prandaj, në emër të të gjithë

familjarëve të të zhdukurve, kërkoj nga EULEX-i dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare që ta intensifikojnë presionin mbi Serbinë konform konventave ndërkombëtare. EULEX-i duhet t'i bëjë presion dhe t'i vërë kushte Serbisë që t'i kthejë trupat e të pagjeturve tanë në Kosovë, e jo të provojë të na bindë duke bërë kampanje mediale. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Do të flas shumë shkurt. Shkurt e shqip, asnjë minutë nuk është dashur të humbë me Serbinë, pa e zbardhur fatin e të zhdukurve. Ky do të ishte minimumi i humanes dhe i seriozitetit të dy qeverive, i Qeverisë serbe dhe i Qeverisë së Kosovës, por edhe i ndërmjetësve ndërkombëtarë, si çështje elementare njerëzore. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Falemnderit, nënkryetar!

Unë do të flas shumë shkurt.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se po të punonte si duhet UNMIK-u dhe tani EULEX-i, pjesa për trajtimin e të gjeturve të luftës do të kishte zbuluar dhe gjetur shumë nga trupat e më të dashurve tanë, siç janë: doktor Hafir Shala dhe Xhavit Haziri, që janë arrestuar në prill, përkatësisht në shtator të vitit 1998, nga inspektori i policisë serbe Fadil Suleviq, i përkëdheluri i UNMIK-ut, i cili nga themelimi i Shërbimit Policor të Kosovës është bërë pjesë e saj dhe tani është ngritur në detyrën më të lartë të Policisë së Kosovës - si hetues për krime serioze.

Merreni me mend, sa krime kanë bërë tjerët, dhe ky kriminel, i cili punon në krime serioze, ua hedh të tjerëve. Prandaj, unë e kisha thirrur EULEX-in të merret më shumë me këta kriminelë, që na i kanë arrestuar e kidnapuar të dashurit tanë, të tregojnë se ku janë varrezat dhe trupat e tyre dhe të nxirren në përgjegjësi. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit zoti Lladrovci! Fjalën e ka nënkryetari, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Falemnderit, zoti kryesues!

Zonja zëvendëskryeministre, Tahiri,

Çështja e debateve për të pagjeturit, si çështje politike dhe çështje humanitare është diskutuar gjithë këto vite dhe ka pasur brenga edhe të familjarëve, edhe të shoqërisë, edhe të komuniteteve.

Në vitin e kaluar, kjo çështje u shqyrtua më thellësisht, në bankat e këtij Kuvendi, pikërisht atëherë kur duhej të fillonin bisedimet për çështje teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Më lejoni të kujtoj, sepse këtu po flasim me gojë. Por, sido që të jetë, shkrimi mbetet, thonë latinët. Dhe, ju mund t'i merrni fjalët që i kemi thënë këtu për këtë problem, duke kërkuar që, nëse duhet, si obligim ndërkombëtar të bisedohet për çështje teknike me Serbinë, të kërkohej të mos bisedohet për këto çështje para se Serbia të japë përgjegjësi për tri-katër çështje, e njëra prej këtyre ka qenë kjo.

Po rezymoj. Nëse është kështu, e kështu ka qenë, sepse tekstet ekzistojnë, janë thënë në këto banka, atëherë është momenti që ky kushtëzim, që nuk është bërë atje, të bëhet tash. Dhe, arsyet janë të shumëfishta.

Të mos bisedohet për asgjë me Serbinë përpara se të marrë vullnetin politik, detyrimin ndërkombëtar, veprimin konkret që kjo çështje të shqyrtohet me obligim dhe detyrim ndërkombëtar.

Sepse, po e përsëris këtu, çështja e të pagjeturve nuk është çështje e një komuniteti, por i të gjithëve. Dhe, këtu, mendoj se nuk duhet të flitet për shifra. Shifrat, thonë, nuk janë të baraspeshueshme, por të pagjeturit janë individë, janë fate, janë njerëz, secili ka emër, mbiemër, rreth familjar. Dhe, çdo njëri është rast i veçantë, sepse shifrat u universalizojnë dhe i rrafshojnë jetët e njerëzve. Pra, çdo jetë është një.

Prandaj, nënvizoj edhe një herë, çështja e të pagjeturve është çështje e të gjithëve. Përtej kësaj, është çështje e të pagjeturve që ne i themi me një fjalor pak më të butë, është çështje e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Është çështje humanitare dhe është çështje psikologjike. Është çështje e të drejtave të njeriut dhe, më në fund - është çështje e drejtësisë. Dhe, përfundimisht, është çështje e rëndë politike.

Mos u frikoni! Unë po e shoh këtu, s'po di si po e definojnë politikën disa kolegë të mi, po thonë s'është çështje... Po, si nuk është çështje?! Kjo është çështje e rëndë politike!

Tjetër është nëse mendohet në politikanizëm, që i thonë me një fjalor pak hipokoristik, në kuptimin që e bën të parëndësishëm, e bën pazar të keq. Jo, jo! Kjo është çështje e rëndë politike.

Unë e dëgjova zëvendëskryeministren që bëri një paraqitje shumë të strukturuar, do të thosha, të problemit, duke pasur parasysh, në radhë të parë, debatin ose çështjen, duke e vendosur në një kuadër të gjerë të debatit ndërkombëtar, duke përmendur kode, ligje, norma, detyrime. Dhe, kjo është krejt në rregull. Kjo i bie që ligjet ekzistojnë, normat ekzistojnë, detyrimet ekzistojnë, e problemi është që ato nuk zbatohen dhe ne po bisedojmë për moszbatim detyrimesh, kodesh universale, ligjesh, rreth krimeve, luftës, rrëmbimeve, varrosjeve, zhvarrosjeve që secilën herë e merr edhe nga një ngjyrë të dytë të krimit.

Pra, zonja zëvendëskryeministre, ajo që presim ne, e që pret edhe ti sigurisht, të gjithë si shoqëri, si komunitet dhe si Kuvend, si institucion që është, çfarë të bëjmë ne në këtë dialog që është iniciuar, nuk është hapur, në kuadër të BE-së, që BE-ja të mos na prijë me kode, se ne i dimë, por të jetë e zonja, nëse hyn në këtë lojë, t'i bëjë të detyrueshme këto kode për qeveritë respektive, unë po them për Serbinë në këtë rast, por edhe për Kosovën.

Sepse, kolegë të nderuar, këtu nuk kemi të bëjmë me një çështje filozofike shkencore të zbulimit të vërtetës, që është punë e mirë - një e vërtetë universale. Problemi është se zbulimi i kësaj të vërtete, derivon pasoja. Nuk është e thjeshtë. Nuk është puna se përgjegjësit politikë të gjenocidit, të krimeve, një pas një, kushdo qoftë, e kanë çështje akademike të zbulimit të vërtetës. Kur zbulohet kjo e vërtetë, ka përgjegjës, e përgjegjësit i nxjerr para ligjit. Prandaj, procesi është i komplikuar, nuk është aq i thjeshtë, siç mendojmë ne.

Dhe, në këtë kuptim, çështja bëhet e rëndë politike dhe e drejtësisë. Unë po them që nga kjo, ne sot, bashkë me zonjën zëvendëskryeministre që ka ardhur këtu në interpelancë, është që të bëhemi konkretë dhe të arsyeshëm. Nëse bashkësia ndërkombëtare, unë po e vë në kllapa (BE-ja), sepse ajo është implikuar në iniciativën që të bisedohet për këto probleme, sepse ashiqare nuk është biseduar fundamentalisht, atëherë ajo të marrë përgjegjësi që ta bëjë detyruese, edhe një herë po e nënvizoj: t'i bëjë detyruese ligjet ndërkombëtare dhe vendore për ndriçimin e të pagjeturve, që domethënë gjykimin e krimeve të luftës dhe nxjerrësit e përgjegjësve para gjyqit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami, e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Kolegë deputetë,

Përsëri po rikthehet debati për të pagjeturit, një debat që e kemi pasur jo më larg se në seancën e kaluar dhe përsëri po kthehet një retorikë e njëjtë politike.

Unë, edhe herën e parë kur diskutova, diskutimin e fillova me atë se të pagjeturve dhe familjarëve nuk u kanë munguar premtimet, nuk u kanë munguar as deklaratat politike. Atyre u kanë munguar rezultatet konkrete në zbardhjen e fatit të më të afërmeve të tyre dhe prej neve, si deputetë, por edhe prej institucioneve tjera kërkohet të jemi të sinqertë, të tregojmë realisht se çfarë mund të bëjë Kosova dhe të ndërmarrim krejt çfarë është e dinjitetshme, që është detyrë e shtetit, pra e Republikës së Kosovës.

Unë pajtohem me shumë diskutime, se kjo çështje, nga një çështje humanitare, është shndërruar në një çështje politike dhe është një mbetje e gjenocidit serb, është një relik i gjenocidit serb dhe e politikave jovepruese ndërkombëtare. Sepse, vlerësoj, po të kishte politika vepruese e të sinqerta ndërkombëtare, kjo çështje do të mund të mbetej në suazat e çështjeve humanitare, nuk do të merrte ngjyrimë politike dhe nuk do të ishte një adut i Serbisë që nëpërmjet saj të ketë edhe përfitime politike.

Si një nga personat që ka përvojë nga bisedimet e Rambujesë dhe të Vjenës, mendoj se kjo çështje nuk është trajtuar mirë me dokumentet ndërkombëtare. Këtu kemi edhe disa deputetë që kanë qenë në Rambuje dhe u kujtohet se ne e kemi pasur një aneks, me të cilin është përcaktuar obligimi i Serbisë sa i përket liritë të të burgosurve politikë.

Fatkeqësisht, në Vjenë nuk e kemi pasur një aneks të marrëveshjes së Ahtisarit, me të cilën Serbia, si ushtruese e gjenocidit në Kosovë, do të merrte detyrime konkrete legale e

ndërkombëtare, që brenda një periudhe të caktuar kohore ta zbardhte fatin e të pagjeturve dhe do të krijohej një mekanizëm i presionit ndërkombëtar që Serbia disi të lëvizte. Fatkeqësisht, kjo nuk është trajtuar atëherë siç duhet në procesin e Vjenës, se përndryshe do ta merrte karakterin e një dokumenti të obligueshëm, siç janë dokumentet dhe anekset tjera të pakos së Ahtisarit.

Çfarë realisht mund të bëjmë dhe çfarë premtimesh mund të japim për zbardhjen e fatit të familjeve të të pagjeturve, një çështje që e rëndon dhe mbetet peng i Kosovës, edhe pas pavarësisë.

Realisht, aduti kryesor është që ne ta kemi një qëndrim shumë të fuqishëm karshi faktorit ndërkombëtar, që ai të veprojë në drejtim të Serbisë. Serbia nuk do të veprojë vetëm për shkak të kërkesave të Republikës së Kosovës. Serbia, po të kishte vullnet të mirë, këtë çështje do ta zgjidhte, do t'i gjente lokacionet dhe do të ndihmonte në zbardhjen e këtij fati. Pra, e vetmja mënyrë mbetet që ne të kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare, e cila po bën nganjëherë presione jokorrekte ndaj Kosovës dhe po e detyron të pranojë edhe kompromise mjaft të zorshme, që ajo së paku në këtë çështje humanitare të tregohet korrekte dhe të ushtrojë presione ndaj Serbisë, që Serbia t'i përfillë detyrimet kombëtare karshi të pagjeturve.

Ne këtë duhet ta bëjmë në të gjitha format. Mos të harrojmë se ne e kemi shpallur sivjet vitin e përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. A do të lejojmë që ndërkombëtarët të shkojnë pa u zbardhur fati i të pagjeturve dhe a do të lejojmë që mbikëqyrja e pavarësisë të mbyllet pa e pasur një hap konkret, dhe ne do ta ushtrojmë presionin ndaj të gjithë faktorëve ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë që ata të bëjnë presion te Serbia dhe ta detyrojnë atë të lëvizë.

Në aspektin e brendshëm - aspektin kombëtar, në aspektin e detyrimeve ligjore të institucioneve, unë pashë këtu këto rekomandime dhe pashë një kopje të rekomandimeve që i kemi pasur në debatin për fatin e të të pagjeturve, po më duket se edhe gjuha është e njëjtë. E vetmja gjë që është, është se ne duhet të ndërtojmë strategji, sepse kemi sjellë ligje, kemi sjellë akte tjera dhe na duhet një strategji konkrete shtetërore me një plan të veprimit, ku Qeveria do t'i përcaktonte në mënyrë të qartë obligimet, veprimet dhe afatet kohore, jo me retorikë, por me gjëra konkrete. Parlamenti do t'i përcaktonte detyrimet e veta, dhe të gjitha instrumentet do t'i përcaktonin detyrimet e veta.

Nuk e di nëse jemi vonë që kjo çështje të ndërlidhet me çështjen e negociatave teknike tani. A jemi vonë që të themi tani se na ka rënë ndërmend që nuk vazhdojmë me negociatën, në qoftë se tani nuk zgjidhet kjo çështje.

Ne kemi hyrë në atë proces dhe nuk është krejt proces i lirë për të dalë sa herë të duash, sepse është një proces ndërkombëtar, një proces i cili ka të bëjë edhe me politikat ndërkombëtare, të cilat, fatkeqësisht, Kosova nuk i krijon, por sillen rreth tyre. Por, le të bëjmë si shtet me plot dinjitet, si shtet me plot përgjegjësi, me plot vendosmëri, gjithçka që mund të bëjmë, që ta kemi një veprim proaktiv të bashkësisë ndërkombëtare, në mënyrë që Serbia, cilado qeveri në Serbi, qoftë qeveritë e reja, apo të vjetra, të detyrohen

që më në fund të veprojnë karshi detyrimeve ndërkombëtare dhe të fillojnë të bashkëpunojnë. Kështu që mendoj se në këto debate që po i zhvillojmë, është mirë që po i zhvillojmë, por asgjë të re s'po bëjmë. I marrim stenogramet e debateve para një viti, a para dy vjetëve... Unë jam vazhdimisht prej pasluftës në këtë sallë të Parlamentit dhe ne vazhdimisht kemi nxjerrë konkluzione të mjaftueshme, kemi dhënë premtime, por problemi nuk është zgjidhur. Tani do të duhej ta ndërrojmë formën dhe në vend të retorikës, apo nganjëherë edhe debateve që më tepër janë edhe debate politike, nganjëherë qëndrojmë edhe në debate partiake, ta ndërtojmë këtë strategji shtetërore dhe të jemi shumë të sqartë, sepse kjo kategori është kategoria më e ndjeshme në Kosovë, e cila është ngopur me premtime. Ajo ka nevojë tani për zotime, për përcaktime konkrete, ka nevojë që të shihet se shteti i Kosovës e ka vendosur në një nga prioritetet e saj për ta zgjidhur dhe për ta hequr nga agjenda ditore çfarë ne e trajtojmë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Ju falemnderit, kryesues!

I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Problemi i të zhdukurve dhe i të pagjeturve është një problem shumë i ndjeshëm dhe shumë i rëndë. Aq sa është i rëndë dhe sa është serioz ky problem, po të ishin marrë kjo Qeveri dhe zëvendëskryeministrja me të me aq seriozitet, me siguri se do të kishim pasur rezultate. Por, dua të them se nuk janë marrë me atë seriozitet, prandaj edhe nuk kemi rezultate të duhura.

Unë desha ta diskutoj një çështje, se çështja e të pagjeturve nuk është problem vetëm i luftës së fundit, ngase kemi të zhdukur e të pagjetur edhe nga më herët, edhe para kësaj lufte, edhe para Luftës së Dytë Botërore, edhe para Luftës së Parë Botërore, prandaj do të ishte mirë që edhe të kërkojmë të zbardhen edhe këto raste dhe zgjidhet ky problem.

Asgjë nuk ka më të vështirë për një familje që e ka një rast të të zhdukurit, e të shpresojmë vazhdimisht se personi i zhdukur një ditë do të lajmërohet, apo të gjendet. Asgjë nuk ka më të vështirë që të lihet dera e shtëpisë e hapur dhe çdo ditë të pritët që personi i zhdukur të lajmërohet.

Unë nuk do ta kisha zgjatur më tepër, pjesën tjetër do ta dorëzoj me shkrim, prandaj meqë u përmendën shumë sende këtu, të mos i përsëris ato. Falemnderit!

(Diskutim, pjesërisht i dorëzuar me shkrim)

NAZANE BRECA: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar familjarë të të pagjeturve.

Edhe sot, 12 vjet pas luftës së fundit në Kosovë, Kosova lëngon nga një prej dhembjeve më të ndjeshme të saj për fatin e mbi 1800 personave të pagjetur.

Fat ky që është ngushtë i lidhur me dhembjen e vazhdueshme dhe të rëndë të familjarëve të saj, e sigurisht edhe i të gjithë qytetarëve të vendit tonë.

Nuk është e lehtë të biesh në gjumë e të zgjohesh me ndjenjën dhe dhembjen se ende nuk janë gjetur varret apo eshtrat e më të dashurve. Pyeteni secili veten se si ndihen familjarët e këtyre personave, në mënyrë permanente dhe pa ndërprerje?

Qeveria jonë jep fjalë e premtime kontinuele, por gjithmonë të kota dhe shpeshherë krijon përshtypjen se e bën vetëm për të lënë dëshmi, qoftë edhe boshe, se ka folur për këta persona, që aq shumë na mungojnë ne të gjithëve, e në veçanti familjarëve të tyre, nënave e baballarëve, fëmijëve e të afërmve të tyre.

E dhembshme e shumë tronditëse për të gjithë, e sa e dhimbshme është për Qeverinë tonë? Pyeteni secili veten!

Edhe pas 12 vjetësh liri, të gjithë ne dhe familjarët tanë e ndiem dhe iu gëzuam lirisë së vendit tonë, ndërsa familjarët e të pagjeturve, pyeteni veten prapë, ngase familjarët nuk keni guxim e kurajë t'i pyetni.

Tash e 12 vjet pas luftës, ne përpiqemi ta sensibilizojmë Qeverinë tonë që të bëjë diçka për ta, po si duket fjalët tona i merr era, i ngjajnë shkrimit të shkruar në akull e të kthyer nga dielli.

Prapë ju lutem, pyeteni veten se si ndihen ata familjarë me dhembjen që i rëndon si gurë, e aq më rëndë, i lutem Qeverisë së vendit të vet me aq përmallim e dhembshuri, sikur këta të gjerë e dhanë jetën për tjetërkënd, e jo për shtetin, që e qeverisin këta njerëz!

Ankthi dhe dhembja shpirtërore dhe fizike e familjarëve të të pagjeturve dhe të gjithë neve nuk përfundon as sot e 12 vjet pas luftës së fundit, e druaj se me qeveri të tillë dhe qeverisje të tillë do të vazhdojë edhe më!

Të nderuar kolegë,

Sa janë serioze institucionet e Qeverisë sonë? Sa mekanizma e angazhime konkrete ka aktivizuar Qeveria jonë për të bërë më shumë, për këtë kategori të njerëzve tanë? Kam frikë se me fjalomani të tilla e premtime shkel e shko të Qeverisë dhe qeveritarëve tanë, kjo dramë e ky ankth do të zgjasë edhe më shumë.

Propozohet të ndërtohen lapidare e monumente për të pagjeturit, nuk jemi kundër çdo iniciative, sa humane, aq edhe obliguese të Qeverisë, por familjarët kërkojnë eshtrat e më të dashurve të tyre, e jo fjalë e lapidare. Kërkojnë angazhim konkret, e jo fjalë boshe e premtime, që ju ngjajnë fushatave elektorale. Më shumë se kaq, familjarët dhe mbarë populli i Kosovës kërkon hapa konkretë dhe që sjellin rezultate.

Kujtojeni të gjithë edhe njëherë se pa gjetjen e eshtrave të fundit të të pagjeturit te fundit, Kosova nuk mund të flejë lirshëm dhe e qetë. Kur them Kosova, them për secilin qytetar të saj, meqë liria që sot e gëzon secili qytetar e ka vulën dhe peshën e gjakut dhe eshtrave të secilit martir, dëshmor, invalid lufte dhe, mbi të gjitha, secilit të pagjetur. Tekefundit,

ky seriozitet e tregon edhe fuqinë dhe fatin e shtetit tonë, qoftë në reputacionin vendor, apo ndërkombëtar.

Kuptohet se krahas angazhimeve konkrete të Qeverisë dhe institucioneve tona, kërkohet edhe trysni shumë më e madhe e faktorit ndërkombëtar mbi autoritetet serbe, që ta tregojnë edhe varrezën e fundit masive dhe gjetjen e eshtrave të fundit të më të dashurve tanë, meqë tanimë ata janë të të gjithë neve. Andaj kërkohet angazhim i të gjithë faktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Serioziteti i institucioneve dhe Qeverisë varet shumë nga konkretizimi rreth gjetjes së personave të pagjetur, varrezave masive dhe eshtrave të tyre. Adresa është e ditur për të gjithë ne, ajo është Qeveria e Serbisë dhe arkivat e tyre, qofshin ato shtetërore, ushtarake, paraushtarake dhe ndihmuesve të tyre, që bënë pastrime etnike dhe gjenocidale.

Por, si duket, për këtë Qeveri dhe qeverisje, ky obligim, sa moral, aq edhe kombëtar, do të ngelë premtim elektorale në vazhdimësi, meqë jemi mësuar nga kjo Qeveri se është e premtimeve boshe dhe të parealizueshme. Edhe për këtë pyeteni veten seriozisht!

Kuptohet se angazhimet e asociacioneve, shoqërisë civile dhe familjarëve kanë qenë të mëdha. Por, të nderuar qeveritarë dhe institucione të shtetit, sa më shumë që angazhoheni ju konkretisht dhe pa ekuivokë rreth kësaj çështjeje, aq më parë do të mund të mbyllet kjo plagë, që ende kullon. E deri atëherë dhimbja dhe ankthi i familjarëve, e i të gjithë neve me ta, do të vazhdojë. Ju falemnderit!

(Nazane Hamza-Breca, d.v.)

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Falemnderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolegë,

Tema e cila po debatohet për personat e pagjetur është mjaft e ndjeshme dhe unë do të lidhem me temën me Ukshin Hotin, me Xhavit Hazirin dhe të tjerët, të cilët janë të zhdukur ku presidenti e ka shpallur Xhavit Hazirin hero të Kosovës, ndërsa ende nuk dihet asgjë për ta.

Është mirë të dihet, ose të paktën zëvendëskryeministrja ta shtrojë çështjen në bisedime, kur shkon me delegacionin, se ku është një hero i Kosovës, për të cilin nuk dihet se ku i ka eshtra.

Çështjen e Ukshin Hotit e kemi diskutuar sa e sa herë. Dihet njerëzit të cilët e kanë marrë nga burgu, dihen edhe njerëzit ku e kanë dërguar dhe ku e kanë lënë, prandaj këtu kërkoj nga zëvendëskryeministrja që në ato bisedime ta shtrojë çështjen e akuzave drejtpërdrejt ndaj atyre njerëzve që kanë bërë krime e gjenocid ndaj të burgosurve, por edhe atyre që janë të zhdukur.

Prandaj, tani këto zgjedhjet që u kryen më 6 maj 2012, në Serbi, të cilat e përcaktojnë të njëjtën politikë që e ka zgjedhur Milosheviqi. Të njëjtit njerëz, nënkryetari i atëhershëm i

Partisë Socialiste, Daçiqi, tash është dhe bën koalicion pikërisht dhe kërkon të bëhet kryeministër i Serbisë, po i njëjti njeri që ka bërë krime. Prandaj, strukturat e njëjta që kanë bërë krime në Serbi janë prapë dhe vijnë në pushtet, ndërsa zëvendëskryeministrja duhet ta shtrojë bisedën pikërisht te këto organe, të cilat e dinë rrjedhën e krimeve që i kanë bërë dhe të paktën të nxirren njerëzit para drejtësisë dhe këto familje që i kanë të zhdukurit të dinë se ku i kanë eshtrat e tyre.

Prandaj, kërkoj që zëvendëskryeministrja të bëjë presion të drejtpërdrejtë në Bruksel, se nuk është lehtë të hysh në bisedime me një mori njerëzish të zhdukur që nuk dihen se ku janë, sepse ne jemi si pjesë e presionit të familjeve tona, të cilat bëjnë presion të vazhdueshëm për t'u gjendur të zhdukurit. Pra, jemi pjesë e Kuvendit dhe pjesë e Ekzekutivit dhe duam, ose nuk duam, por nuk kemi mundësi ta bëjmë një presion. Prandaj, zëvendëskryeministrja duhet që drejtpërdrejt, edhe në bisedimet që janë atje, të ngulë këmbë dhe të kërkojë kushte që të dihet ku janë personat e tillë.

Ne nuk mund të heshtim, kur nuk e dimë se ku është një hero i Kosovës, si Xhavit Haziri. Ne nuk dimë dhe nuk mund të heshtim ku është Ukshin Hoti, një njeri, një personalitet i Kosovës. Dhe, nëse ne i heshtim në këto raste, atëherë cila është arsyeja që të shkojmë në bisedime, të diskutojmë ose të debatojmë, kur të njëjtit njerëz kanë ardhur në pushtet dhe përsëri do ta vazhdojnë gjenocidin e heshtur tash ndaj popullatës shqiptare. Falemnderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

RAMË VATAJ: I nderuari, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar familjarë të të zhdukurve,

Sot, kur po diskutojmë për personat e zhdukur në luftën e fundit në Kosovë, nuk mund të mos jemi pjesë e dhimbjes së familjeve, të cilat i kanë humbur më të dashurit e tyre dhe të cilët ende nuk e kanë një vend ku mund të vendosin lule, apo edhe të çmallen pranë vendprehjes së tyre.

U bënë 13 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe ankthi i familjeve të personave të zhdukur nuk ka përfunduar. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të familjarëve, shoqatave të të zhdukurve dhe institucioneve të Kosovës për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, shteti i Serbisë nuk ka treguar asnjëherë vullnet politik për këtë çështje. Shikuar nga këndvështrimi i shtetit serb, kjo është e arsyeshme, sepse me hapjen e dosjeve të krimeve dhe dhënies së informacioneve mbi personat e zhdukur dhe varrezat masive, të cilat janë apo mund të jenë në Serbi dhe në Kosovë, me këtë do t'i legjitimonin krimet e tyre, të bëra në mënyrë të organizuar shtetërore. Gjatë luftës në Kosovë dihet se ushtria dhe policia serbe kanë pasur strukturë komanduese mirë të organizuar dhe çdo veprim operacional luftarak është bërë me plan të përgatitur paraprakisht, prandaj edhe mund të kenë të dhëna të sakta për çdo veprim të tyre. Me vetëdëshirë apo nga aspekti humanitar, Serbia nuk do ta bëjë këtë asnjëherë, prandaj për këtë do të duhet ndihma e bashkësisë ndërkombëtare, e cila do të mund t'i bënte presion shtetit të Serbisë.

Ne duhet ta pranojmë faktin se vetëm nuk kemi aq fuqi që ta detyrojmë Serbinë që ta zbardhë faktin e personave të zhdukur, po ashtu zyrtarisht çështja e personave të zhdukur është kompetencë e UNMIK-ut dhe EULEX-it. Prandaj, duhet që institucionet e Republikës së Kosovës të angazhohen seriozisht së bashku me institucionet ndërkombëtare që kanë kompetenca në këtë çështje. Këtë angazhim duhet ta fuqizojmë me një mocion që do të aprovohet në këtë Kuvend dhe besoj që këtu do të jemi të gjithë unikë.

Ju falemnderit për vëmendje!

(Ramë Vataj, d.v.)

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

ALBANA GASHI:

Letër drejtuar Qeverisë nga familjarët e personave të pagjetur nga Vushtrria:

“Gjatë periudhës së luftës 1998-99, në Kosovë u rrëmbyen dhe u zhdukën rreth 6.000 persona. Në Vushtrri, më 22 maj 1999, kriminelët serbë rrëmbyen 78 shqiptarë, prej tyre 53 ende të pagjetur.

Familjarët e të pagjeturve edhe pas 13 vjetësh përballen me kushte të rënda ekonomike. Ligji për persona të pagjetur deri më sot nuk po zbatohet, ngase ka shumë hapësira për interpretim e për keqpërdorim.

Në një takim, ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, na premtoi se fotografitë e personave të pagjetur, që qëndrojnë të varura në rrethojat e Kuvendit, do të vendosen në një vend më të dinjitetshëm. Na premtoi që do të bëhet gjithçka që është e mundur për këtë kategori, por deri më tash nuk është bërë asgjë.

Qeveritarët tanë angazhohen t’i përkëdhelin serbët, t’i avancojnë e t’i rehatojnë. T’i plotësojnë të gjitha kërkesat e tyre, në mënyrë që ata të ndihen sa më komodë. Përderisa kryeministri i përqafon fëmijët e serbëve, nënave shqiptare nuk po u kthehen as 3-4 eshtra në qese të plastikës nga Serbia.

Po dëgjojmë në lajme që ushtarët e UÇK-së po gjykohen për arsye se kanë luftuar për lirinë e popullit të vet. Madje, po bëhen hetime për trafikim të organeve të serbëve. Vallë, a qe e mundur një gjë e tillë? Ushtarët tanë që nuk patën as fasha e barna elementare për t’i kuruar plagët e tyre?

Faji qëndron vetëm te ata që i kidnapuan më të dashurit tanë para syve të familjarëve e i dërguan në Serbi, ku një numër i kufomave është bartur me kamionë-frigoriferë. Serbët janë ata që kanë pasur mundësinë për të bërë trafikimin e organeve. Ne, nënat e të pagjeturve, shpeshherë e kemi diskutuar këtë çështje, mirëpo askush nga pushtetarët nuk e çan kokën për këtë gjë.

Zotërinj të Qeverisë, mandatin e keni nga shqiptarët, e jo nga Serbia. Mos i mbyllni sytë për të pagjeturit!

(Albana Gashi, d.v.)

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Sipas Rregullores, fjalën e ka zëvendëskryeministrja Edita Tahiri për t'i dhënë përgjigjet në pyetjet që janë shtruar dhe për ta paraqitur fjalën e saj përmbysë lidhur me këtë çështje. Zonja Tahiri, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Ju falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për këtë debat, i cili ishte, jo vetëm konstruktiv, por jam e bindur se është kontribut shumë i rëndësishëm në drejtim të forcimit të angazhimeve institucionale për t'i dhënë zgjidhje të plotë çështjes së të pagjeturve dhe mund të ju them se gati në shumicën e diskutimeve u theksua se është një plagë e rëndë e luftës dhe pas luftës dhe u pajtuam që kjo çështje është thellësisht humanitare dhe natyrisht si problematikë nga ajo, mund të shihen edhe dimensione tjera, por çështja e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur është çështje thellësisht humanitare dhe është obligim ndërkombëtar i të gjitha shteteve që janë nënshkruese të konventave ndërkombëtare.

Me këtë rast, dua të them se nga historia jonë e rëndë dhe tragjike, por edhe nga historitë e popujve tjerë të shtypur, është parë se ata që e bëjnë gjenocidin ndaj një populli, në radhë të parë i shkelin ligjet ndërkombëtare humanitare dhe të njëjtën e bëjnë pastaj edhe kur vjen koha për ta riparuar atë çka është e mundur në kuadër të dëmeve të luftës.

Pra, nuk duhet pasur pritje të mëdha nga Serbia që t'i përmbushë obligimet ndërkombëtare. Pse? Sepse është ajo që e ka bërë gjenocidin dhe natyrisht se vazhdon me tendenca të politizimit.

Prandaj, ne si Qeveri, duke pasur parasysh se ky problem tashmë vazhdon për 13 vjet dhe ndonëse një pjesë e problemit është zgjidhur, vazhdon edhe një pjesë e pazgjidhur me 1.781 persona të pagjetur, strategjia jonë ka qenë që këtë çështje ta bëjmë pjesë të agjendës dhe obligimit të Bashkimit Evropian, gjithnjë me besimin që ish-okupatori i Kosovës Serbia ka shprehur aspirata të bëhet anëtare e BE-së, andaj edhe në këtë relacion krijohet obligimi që ajo t'i plotësojë kërkesat, e jo t'i fshehë informatat për të zhdukurit, si dhe të bashkëpunojë, e jo ta sabotojë këtë çështje.

E dyta, ne si Qeveri e Republikës së Kosovës, që nga fillimi i këtij procesi, sepse është proces i gjatë me të cilën janë marrë katër qeveri e katër parlamente, por nuk ka pasur rezultat përfundimtar, asnjëherë nuk i kemi vënë as shenjë etnike, as shenjë politike këtij procesi. Ne flasim për të pagjeturit, prandaj nuk duhet të përmenden shqetësimet apo paragjykimet se flitet për një apo një përkatësi tjetër etnike.

Por, mbi të gjitha, dhe duke u pajtuar se ky është një proces humanitar, unë do të them se sot gjatë debatit u desh ta demonstrojmë ndershmërinë më të lartë duke mos u politizuar me këtë çështje. E ato momente që ne politizuam dhe bëmë përpjekje që të bëjmë përfitime politike, ne prekëm dhe rënduam plagën e të pagjeturve.

Dhe, të jem edhe më e drejtpërdrejtë. Edhe disa letra që më erdhën nëpërmjet partive politike apo deputetëve, është një politizim, sepse Qeveria ka adresë dhe dihet pra cilët janë mekanizmat shtetërorë që merren me çështjen e të pagjeturve.

Unë jam në cilësinë e udhëheqjes së delegacionit për bisedime në Bruksel, mirëpo ne kemi edhe adresa tjera, të cilat e trajtojnë çështjen e të pagjeturve, janë Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qeveritar për të Pagjetur dhe aty është adresa e dorëzimit të letrave. Dhe jo politizim me ata për të cilët ne të gjithë po e bëjmë luftën, angazhimin e dhimbjen për të ditur për fatin e tyre.

Tutje! Më lejoni të ju them se dëgjova edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, kyçeni mikrofonin, le t'i vazhdohet mundësia për diskutim!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: ...e në anën tjetër, kishte kritika që pa kërkuar nuk mund t'i gjejmë. Ju lutem, kjo është kontradiktë.

Më lejoni të ju them se të gjitha ato që i kam thënë...

KRYESUESI: Zonja kryeministre, duhet të ju njoftoj se i keni 5 minuta, në bazë të Rregullores. Unë mund të ju zgjas kohën pak, por ta keni parasysh!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Po, po e përfundoj, zoti kryesues!

Kjo pra ishte mundësia jonë dhe unë do të thosha se theksi duhet të bjerë në Bruksel. Është Bashkimi Evropian që sot ka mundësi që me të vërtetë me e obliguar e detyruar Serbinë që të bashkëpunojë në këtë drejtim. Prandaj, edhe Rezoluta duhet të merret me apel të Bashkimit Evropian. Nëse kemi pasur shumë pritje për bisedime, vetëm ta kthejmë historinë, prej vitit 2006 bisedohet. Komisionet qeveritare të dy shteteve, me ndihmën e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, janë duke e bërë një punë, janë duke biseduar, por ja që nuk kemi zgjidhje të plotë.

Dhe, në fund, atë që desha ta them, është kështu: Jo për t'u dukur se s'ka pasur rezultate dhe, fundja, nuk është përgjegjësi vetëm e këtij mandati, por e të gjitha këtyre mandateve. Në historinë e luftërave, një prej plagëve që vazhdon më së shumti, e dikush e përmendi edhe Bosnjën që tash e 20 vjet nuk ka pasur zgjidhje, është ky problem. Po kjo do të thotë se ne të gjithë së bashku - edhe Qeveria, edhe Parlamenti, edhe të gjitha institucionet t'i rritim angazhimet, t'i forcojmë mekanizmat tanë kompetentë për këtë çështje, t'i ngremë kapacitetet, sepse edhe u përmend me vend - Departamenti për Mjekësinë Ligjore, që

duhet të ketë kapacitete shumë më të larta dhe më profesionale, të fuqizohet procesi, do të thosha, i gjetjes së fatit të të pagjeturve dhe, në anën tjetër, vërtet, sepse një pjesë e madhe, përveç gjeneratës së re këtu, kemi qenë edhe luftëtarë të lirisë dhe kemi qenë pjesë e përgjegjësisë dhe e rezultatit.

Prandaj, do të thosha kështu: Është shumë me rëndësi që në çështjen e të pagjeturve ta demonstrojmë ndershmërinë e nivelit nacional, sepse pikërisht kur e kemi pasur interesin nacional para interesave tjera, ne gjithmonë kemi pasur suksese. Ju falemnderit!

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Falemnderit! Po, por nuk ju është përmendur emri!

(Ndërhyrje)

Po, nëse keni dërguar letra, atëherë për dy minuta, mund të keni replikë.

(Ndërhyrje)

Po, veç me Rregullore ka të drejtë, në qoftë se i referohesh një fjale të diku, ose veprimi që është bërë, dhe unë nuk mund ta ndryshoj Rregulloren tash. Fjalën e ka deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Zonjë, ju lutem, lexojë Rregulloren. Iu referove fjalimit, por edhe letrave që ne t'i dërguam, e kjo është shumë e padrejtë për faktin se si po merresh, a t'i kemi dërguar ne ato letra apo t'i ka dërguar dikush tjetër? Më e drejtë do të ishte që gjatë këtyre 5 minutave të përgjigjeshe pikë për pikë, për secilën pyetje që ta parashtruam ne, edhe në emër të shoqatave, por edhe në emër të subjektit politik.

Pra, ato retorika politike janë të kota, kështu që më mirë do të ishte të përgjigjeshe për pyetjet konkrete. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën tani e ka, sipas Rregullores, propozuesi i interpelancës. I keni 5 minuta në dispozicion, sipas Rregullores, dhe shpresoj se e keni përmbledhur fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: Falemnderit, kryesues!

Unë nuk do të flas gjatë. U thanë ato që u thanë, mirëpo u kisha bërë kërkesë të gjithë deputetëve që ta votojnë mocionin, të cilin e kemi paraqitur. Andaj, edhe një herë, po e lexoj dhe ju lutem t'i votoni këto

R e k o m a n d i m e:

1. Duke shprehur interesimin për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë nga forcat ushtarako-policore serbe gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë, kërkojmë nga Qeveria

e Republikës së Kosovës ta kushtëzojë vazhdimin e bisedimeve të mëtejshme me Serbinë me zbardhjen e plotë të fatit të tyre.

2. Kërkojmë nga të gjithë organizmat e përfshirë në procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur ta intensifikojnë punën me qëllim të identifikimit të mundshëm të mbetjeve mortore, si dhe përkrahjen në sigurimin dhe procedimin e informatave të reja.

3. Kërkojmë nga Instituti për Krime të Luftës i Republikës së Kosovës që të grumbullojë dokumente e fakte për krimet e bëra nga ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe në Kosovë në periudhën kohore 1998-1999.

4. U bëjmë thirrje medimeve të shkruara dhe elektronike që të vazhdojnë ta kenë në fokus çështjen e të zhdukurve dhe ta japin kontributin e tyre nëpërmjet vetëdijesimit të aktorëve ndikues që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.

Falemnderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Tani, mendoj se është radha t'i lexoj rekomandimet deputetja Rita Hajzeraj, të dakorduara nga seanca e kaluar.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, kryetar!

Nuk e di nëse është e nevojshme, sepse ne prapë i harmonizuam këto rekomandime dhe, për ta respektuar Rregulloren, mendoj se është e arsyeshme të mblidhet edhe një herë Komisioni dhe të miratohen ato e pastaj, në pjesën e dytë të seancës, t'i votojmë si Parlament.

KRYETARI: Atëherë, tash të bëjmë pauzë dhe në fillim të seancës së radhës i votojmë dy rekomandimet. A jeni dakord?

Atëherë, në orën 15:30, seanca do ta vazhdojë punën.

(Ndërhyrje)

Jo, deri në orën 16:00 është vonë. Mjafton të kemi pauzë deri në orën 15:30.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca e vazhdon punën)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Po vazhdojmë me seancën, por meqenëse nuk kemi kuorum, vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës, e cila fillimisht nuk e kërkon këtë.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës e ka përgatitur dhe parashtruar në Kuvend Raportin financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Komisioni funksional për buxhet dhe financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës, e ka shqyrtuar Raportin financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza që ta paraqesë raportin para deputetëve.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari, kryetar i Kuvendit,
E nderuara zëvendëskryeministre,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që para jush ta paraqes Raportin përfundimtar për ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011.

Rritja ekonomike për vitin 2011 vlerësohet se ka qenë 5.3%. E dimë që Kosova ka nevojë për një rritje më të madhe ekonomike, mirëpo në të njëjtën kohë është rritja më e madhe ekonomike, e shënuar në vendet e regjionit.

E kemi pasur një përmbushje të planit përmbi 100% dhe performansa e mirë e të hyrave ka mundësuar që Kosova t'i kryejë të gjitha obligimet e veta, duke përfshirë edhe rritjen e pagave, duke përfshirë edhe financimin e projektit të autostradës dhe duke përfshirë edhe kryerjen e të gjitha obligimeve ndaj operatorëve ekonomikë.

Kjo performansë e mirë e të hyrave ka bërë që pavarësisht se procesi privatizimit të PTK-së nuk është finalizuar në kohë, ne t'i kryejmë të gjitha obligimet tona dhe në fund të vitit ta kemi bilanc bankar pozitiv, e që bruto-bilanci ka qenë 203.6 milionë euro.

Kosova, për vitin 2011 e ka pasur një deficit prej 1.5% në raport, dhe nëse i shtohet edhe servisimi i borxhit, ky deficit arrin në 1.8%.

Si rezultat i ruajtjes së stabilitetit makro-fiskal, Banka Botërore në fund të vitit të kaluar ka derdhur në buxhetin e Kosovës mbi 24.000.000 euro.

Ky raport është përgatitur sipas kërkesave të Ligjit për menaxhimin e financave publike e përgjegjësitë dhe duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për raportimin në sektorin publik.

Veçoritë kualitative të këtij raporti, janë:

- ngritja substanciale në të hyra;

- tejkalimi i planit të të hyrave në disa kategori;
- ngritja kualitative, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale në atë pjesën ku më së tepërmi përfitojnë qytetarët e Kosovës, dhe
- rënia simbolike e shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, me gjithë zgjerimin e dukshëm të fushëveprimit dhe institucioneve të reja.

Në vazhdim, deputetë të nderuar, më lejoni ta paraqes një përmbledhje të Raportit për t'i pasqyruar të dhënat në formë analitike dhe krahasuese për periudhën në fjalë.

Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2011, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve dhe fondet në mirëbesim, kanë qenë 1.303.328.000 euro dhe paraqesin 101% të planit të përgjithshëm vjetor. Kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor, ndërsa kemi një rritje prej 10.6 krahasuar me vitin paraprak, do të thotë me vitin 2010.

Të hyrat e mbledhura në kufij arrijnë në 64% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 827.7 milionë ose 99.7% të planit, ndërsa krahasuar me vitin 2010 kemi një ngritje prej 18.1%.

Të hyrat e brendshme të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës, arrin në 20% të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumën prej 261.134.000 euro, ose 100.1% të planit vjetor, dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një ngritje prej 18%.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë me 4% në shumën prej 55.621.000 euro dhe, në krahasim me vitin paraprak, kemi një rritje prej 6.9%.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror në totalin e përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë me 5%, dhe janë në shumën prej 59.912.000 euro, ndërsa, krahasuar me vitin paraprak, kemi një rritje prej 23.7%.

Të hyrat jotatimore qeveritare paraqesin 3% të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumën prej 45.525.000 euro.

Grandet për përkrahje të buxhetit nga Banka Botërore janë në shumën prej 19.240.000 euro.

Të hyrat e arkëtuara nga dividenda janë në shumë 60.000.000 euro, nga të cilat 55.000.000 janë nga Postë-Telekomi i Kosovës, ndërsa 5.000.000 euro janë dividendë nga Aeroporti.

Huazimet nga institucionet financiare ndërkombëtare, gjatë vitit 2011 kanë qenë 5.076.000 euro.

Gjatë vitit 2011, kthimet nga të hyrat kanë qenë 1.112.000 euro nga Doganat e Kosovës dhe 29.774.000 euro nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Në vazhdim do t'i paraqes të dalat, ku gjatë vitit 2011, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondet në mirëbesim, kanë qenë 1.387.810.000 euro dhe paraqesin 92% të planit të përgjithshëm vjetor. Krahasuar me vitin paraprak, shihet si një rritje kualitative vjetore e shpenzimeve prej 9.1%, kryesisht në kategorinë e pagave dhe mëditjeve prej 23.6% dhe në kategorinë e investimeve kapitale, ku e kemi pasur një ngritje 16%, në krahasim me vitin 2010.

Shpenzimet nga kategoria e pagave dhe të mëditjeve janë 385.033.000 euro ose 28% të shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa krahasuar me planin vjetor për këtë kategori ato janë realizuar me 96%, ndërsa krahasuar me vitin 2010 në vitin 2011, e theksova, kemi një ngritje 23.6%.

Shpenzimet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë 156.559.000 euro ose 11% të shpenzimeve të përgjithshme, me realizim 90% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie prej 3.7%.

Shpenzimet nga kategoria e shërbimeve komunale janë në shumën prej 20.376.000 apo 1% të shpenzimeve të përgjithshme vjetore, ndërsa realizimi ndaj planit është 95%. Subvencionet dhe transferet janë 256.166.000 euro ose 18% të shpenzimeve të përgjithshme, me realizim vjetor të planit prej 96%.

Shpenzimet kapitale janë në shumën prej 528.186.000 euro, ose 38% e shpenzimeve të përgjithshme vjetore. Realizimi vjetor në krahasim me planin për këtë kategori është 87%, ndërsa krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 kemi një ngritje prej 16%.

Nga buxheti i Republikës së Kosovës janë bërë edhe pagesa tjera, si vijon:
Pagesa në emër të borxhit të jashtëm të Kosovës, në shumë prej 11.491.000. Përveç kësaj pagese, me rëndësi është të theksohet se në formë të donacionit për këtë qëllim direkt nga Qeveria Amerikane janë paguar 8.755.000 euro dhe Qeveria zvicerane 527.000 euro.

Nga buxheti i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2011 janë bërë pagesa në emër të kredisë së dhënë KEK-ut në shumë prej 30.000.000 euro.

Grandet e përcaktuara të donatorëve - Fondi i përgjithshëm i grandeve të përcaktuara të donatorëve për vitin 2011, duke përfshirë edhe bartjen nga viti 2010 është në shumën prej 23.350.000 euro. Nga ky fond, gjatë vitit 2011 janë shpenzuar 16.371.000 si dhe 556.000 kthime të donacioneve.

Gjendja e fondeve të pashpenzuara nga grandet e përcaktuara të donatorëve më 31 dhjetor 2011 është 6.423.000 euro, fonde të cilat do të barten dhe janë bartur në vitin fiskal 2012.

Gjendja e fondeve me 31 dhjetor 2011 - Gjendja e fondeve më 31 dhjetor 2011 është 203.629.000 euro. Nga kjo gjendje, rrjedhin detyrimet si në vijim:

- Fondi i donatorëve - 6.423.000 euro;

- Të hyra vetjake që barten në vitin 2012 - 29.284.000 euro dhe
- Fondet tjera në mirëbesim - 7.924.000 euro.

Nga kjo, shihet se gjendja e fondeve të buxhetit të Kosovës, më 31.12.2011, e lirë për shpërndarje është 159.998.000.

Në fund, të nderuar deputetë, më lejoni të them se Raporti është edhe një tregues lehtësisht i matshëm për sukseset e institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese, si dhe një dëshmi e pakontestueshme për potencialin e tyre në rrugëtim të sforcimit të shtetit të Kosovës dhe ngritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë.

Ju falemnderit për bashkëpunim dhe mbështetje të sinqertë në periudhën e deritanishme. E kam besimin e plotë dhe me mbështetje të tillë do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, ministër! Fjalën e ka kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 është i detajuar dhe gjithëpërfshirës, ku pasqyrohen të gjitha të hyrat dhe shpenzimet në nivelin qendror e komunal, si dhe të hyrat nga donatorët. Po ashtu, në kuadër të këtij raporti, janë të pasqyruara edhe të gjitha shpenzimet të cilat janë të krijuara nga institucionet e pavarura, të cilat raportojnë në Kuvend.

Gjithashtu, janë të prezantuara tabelat që i pasqyrojnë depozitat, huazimet, kthimet, pasuritë jofinanciare, klasifikimin e shpenzimeve sipas karakterit funksional e ekonomik, raportin e faturave të papaguara, të dhënat për transferim nga fondi rezervë dhe stoqet e organizatave buxhetore.

Në raport shohim performansë më të mirë të institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të parasë publike. Vërehet se ka pasur ngritje të të hyrave buxhetore, meqë kemi një rritje të të hyrave, të cilat janë realizuar nga Doganat dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Po ashtu, nga Raporti vërejmë se në një numër të madh në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ka rënie të këtyre shpenzimeve, me gjithë zgjerimin e fushëveprimtarisë së institucioneve të Kosovës dhe krijimin e institucioneve tjera.

Në tabela shihet se kemi një rritje të mbledhjeve të hyrave në krahasim me projeksionin e ligjit të buxhetit, si dhe në krahasim me vitin 2010, që dëshmon një stabilitet fiskal dhe një projeksion real, i cili është bërë gjatë vitit 2011.

Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2011, siç e theksoi edhe ministri, janë diku 1.303.000.000 euro, që do të thotë se është një tejkalim i planit të të hyrave vjetore, e kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor, ndërsa kemi një rritje prej 11%, krahasuar me vitin paraprak 2010.

Për të vlerësuar sa është edhe rritja e të hyrave komunale, që tregon se komunat do të kenë një stabilitet dhe rritje më të shpejtë të shkallës së vetëfinancimit të tyre, si dhe shpenzimet kapitale, në të cilat përfitojnë më së shumti qytetarët dhe që janë interes për zhvillimin ekonomik, janë realizuar diku 87% apo 16% më shumë, krahasuar me vitin e mëparshëm 2010.

Po ashtu, ka vazhduar performansa e mirë e Doganave dhe e Administratës Tatimore në inkasimin e të hyrave.

Shpenzimet gjatë vitit 2011, duke mos i përfshirë grandet e donatorëve dhe njëkohësisht edhe fondet në mirëbesim, sikur që u cek edhe nga ministri, janë diku të realizuara 92% nga plani i përgjithshëm vjetor. Dhe, krahasuar me vitin paraprak, shihet një rritje kualitative vjetore e shpenzimeve prej 9%, kryesisht në kategorinë paga dhe mëditjet, ku janë rritur shpenzimet diku afërsisht 24%, por që është më kryesorja ka pasur rritje në kategorinë e shpenzimeve kapitale që janë diku 16% më të larta të kjo kategori, ku përfitojnë qytetarët, në krahasim me vitin 2010.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2012, e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se raporti i përmbush obligimet ligjore, që dalin nga neni 46 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Numër 03/L-048 dhe Ligjit Numër 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Po ashtu, Raporti përmban një strukturë të përgjithshme të realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore dhe shprehja e tyre në përqindje, që është një rekomandim i Komisionit për buxhet e financa me rastin e shqyrtimit të Raportit për vitin 2010, prandaj Komisioni u rekomandon deputetëve të Kuvendit ta miratojnë Raportin financiar për vitin 2011.

Nëse më lejohet, kryetar, e kisha prezantuar qëndrimin edhe në emër të Grupit Parlamentar, për të mos marrë kohë prapë.

Pra, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, po ashtu e ka shqyrtuar Raportin financiar dhe ka vlerësuar se janë bërë përparime të dukshme, qoftë në mënyrën e raportimit, qoftë në përmirësimin e performansës së shpenzimeve dhe performansës në krijimin e të hyrave personale, për çka ka reflektuar edhe në rritjen ekonomike. Njëkohësisht, viti është përfunduar me një bilanc pozitiv, prandaj deputetët e Partisë Demokratike do ta përkrahin këtë raport dhe rekomandojmë që ai të miratohet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të LDK-së, kush e kërkon fjalën? Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si LDK nuk e kemi votuar buxhetin e vitit 2011 dhe rrjedhimisht nuk pajtohemi që ta votojmë mënyrën se si është shpenzuar buxheti i vitit 2011, edhe pse nga Raporti, në krahasim me Ligjin e buxhetit, ka diskrepanca të mëdha.

Ne i kemi dhënë vërejtjet tona për shpenzimet e Qeverisë, format arbitrare të shkurtimeve të buxhetit dhe sot, meqenëse e kemi në rend dite, do t'i theksojmë të gjitha edhe një herë.

Ajo çka bie në sy në këtë raport është se gjatë vitit 2011 kemi pasur shkurtime të shpenzimeve të parapara në buxhet, shkurtime këto që janë bërë pa kriter dhe në kundërshtim me ligjin.

Politika e aprovimit të buxhetit, që parasheh shpenzimet e larta, të cilat pastaj duhet të shkurtohen, ngase burimet e të hyrave janë të pasigurta, tregon edhe njëherë paaftësinë e Qeverisë Thaçi 2 për të menaxhuar me paranë publike.

Disa nga mospërputhjet ndërmjet buxhetit të aprovuar me ligj dhe buxhetit të realizuar, janë këto:

Investimet kapitale për vitin 2011 janë paraparë me Ligjin e buxhetit që të jenë 572.000.000 euro. Tash në këtë raport, këto shpenzime dalin të jenë vetëm 528.000.000 apo 42.000.000 më të ulëta, për shkak të mosprivatizimit të PTK-së dhe mungesës së mjeteve nga donatorët.

Për më tepër, vendimet për shkurtime të shpenzimeve kapitale kanë qenë edhe shumë jotransparente.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere, të parapara me ligj, kanë qenë në vlerë prej 271.000.000 euro. Kanë qenë gjithashtu më të ulëta për 15.000.000 euro. Në raport, prandaj, del se janë shpenzuar vetëm 256.000.000 euro.

Këto janë kursyer nga mosaprovimi i Ligjit për pensionet gjatë vitit 2011, si dhe i Ligjit për veteranët dhe dëshmorët e luftës.

Kursimet janë bërë edhe për shkak se Qeveria nuk i ka paguar pagat me rritje për të gjithë punëtorët në sektorin publik për muajt janar dhe shkurt të vitit 2011, edhe pse ky ka qenë një vendim nga Qeveria. Sindikatat e punëtorëve kurdoherë mund ta paditin Qeverinë për këtë mashtrim.

Në Ligjin e buxhetit, mallrat dhe shërbimet janë paraparë të jenë 184.000.000. Në fakt, janë shpenzuar vetëm 156.000.000, apo 18.000.000 më pak.

Furnizime me barna, me material shkollor dhe mallra tjera - Shpenzimet në këtë kategori, në vitin 2011, edhe ashtu kanë qenë më të ulëta për 6.000.000, sesa në vitin paraprak, duke e ulur ndjeshëm cilësinë e furnizimeve me mallra konsumuese të institucioneve

publike, me një inflacion prej 7.1%, që nënkupton se sasia e furnizimeve për institucionet shëndetësore, arsimore dhe institucionet tjera publike ka qenë dukshëm më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet.

Vlen gjithashtu të theksohet atë që e konfirmon raporti financiar, humbjen e 50.000.000 eurove nga Komisioni Evropian si grand për përkrahje të buxhetit. Por, si qëndron situata kur flitet për shpenzimet e udhëtimit, drekat, darkat dhe shpenzimet e telefonit.

Qeveria Thaçi 2 i ka rritur shpenzimet e tjera, nga 32.000.000 në 38.000.000, apo për 16%. Janë shpenzuar 8.1 milionë shpenzime të udhëtimit, që është 6% më shumë se një vit më herët. Janë shpenzuar 4.000.000 në komunikim, që është për 5% më shumë se në vitin paraprak, megjithëse çmimet e telefonisë mobile kanë rënë dukshëm gjatë këtij viti.

Po ashtu, janë shpenzuar 23.000.000 në derivate, apo 24% më shumë se në vitin paraprak, edhe pse për të tri këto lloje të shpenzimeve Qeveria Thaçi 1, në vitin 2008, në mbledhjen e tretë të Qeverisë së saj, pati marrë tri vendime për shkurtim të këtyre shpenzimeve dhe sot, pas kaq vitesh, ne kemi vetëm tendencë të rritjes.

Qeveria Thaçi, gjithashtu, ka qenë mjaft gjeneroze me ndërmarrjet publike. Gjatë vitit 2011 ato janë subvencionuar me 60.000.000. Prej këtyre, 30.000.000 kanë shkuar vetëm në KEK, kompani e cila po e gllabëron buxhetin e Kosovës. Gjatë dy mandateve të Qeverisë Thaçi, nga viti 2008 deri në vitin 2011, kësaj ndërmarrjeje i janë paguar 177.000.000, apo 42.000.000 për çdo vit. Kjo shumë është dy herë më e lartë se mjetet që shpenzohen për asistencë sociale, që është rreth 28.000.000.

Një çështje tjetër janë obligimet e papaguara të Qeverisë ndaj bizneseve. Vlera e faturave të papaguara dëshmon për menaxhimin e keq të parasë publike. Në faqe 63 dhe 64 të Raportit financiar, faturat e papaguara të institucioneve qeveritare kapin vlerën prej 21.000.000. Kujtojeni se faturat e papaguara në vitin 2010 kanë qenë 15.000.000, ndërsa në vitin 2009, 3.000.000.

Praktika e tillë e moskryerjes së obligimeve është mashtrim me opinionin për gjëja qëndrueshmërinë e arkës së shtetit, në ndërkohë që mjetet që gjenden në arkën e shtetit janë në fakt obligime dhe borxhe ndaj bizneseve dhe personave të tjerë.

Me fatura të papaguara prin Ministria e Infrastrukturës me 6.7 milionë; Ministria e Arsimit me 3.9 milionë; Ministria e Punëve të Brendshme me 3.4 milionë dhe Ministria e Shëndetësisë me 2.3 milionë.

Këto shifra konfirmojnë qartë vërejtjet e LDK-së dhe gjithashtu të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për nivelin e lartë të obligimeve të papaguara nga Qeveria, gjë që po u shkakton probleme bizneseve që janë në marrëdhënie kontraktuale me Qeverinë.

Ne besojmë se raporti i shpenzimeve duhet të shikohet dhe të krahasohet me Ligjin e buxhetit, me buxhetin e Kosovës, buxhet ky i cili nuk është rishikuar. Ne të gjithë e dimë

se nuk ka pasur rishikim të buxhetit, ndërkohë që ka pasur shkurtime buxhetore për kategori të ndryshme të shpenzimeve sa herë ka dashur dhe qysh ka dashur Qeveria.

Në mbledhjen e Komisionit, kundërpërgjigjet e Qeverisë kanë qenë se shpenzimet janë rritur më tepër në nivelin lokal. Ne e përkujtojmë Qeverinë se, ju - partia juaj, e udhëheq shumicën e komunave. Gjithashtu, është thënë se shpenzimet më të mëdha i bëjnë agjencitë e pavarura. Ne gjithashtu ju përkujtojmë se këto agjenci, të ashtuquajtura “të pavarura” përbëhen 100% nga persona militantë të partisë suaj dhe janë votat e këtij Kuvendi, votat e mazhorancës, që i kalojnë qoftë raportet financiare, qoftë buxhetet - kërkesat buxhetore në mënyrën se si ata i kërkojnë. Prandaj, ne kërkojmë që të merrni përgjegjësi për shpenzimin e parasë publike. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në përgjithësi, ky raport nuk mund të shërbejë për ndonjë analizë të përgjegjësisë së Qeverisë në shpenzimin e parasë publike, meqë tabelat janë të mangëta në shumë aspekte. Kështu, për shembull, në tabelat në fillim radhiten shpenzimet e vitit 2011 dhe të njëjtat krahasohen me vitet paraprake.

Me rëndësi është të krahasohen shpenzimet buxhetore për secilën pikë me mjetet e alokuara, e jo me vitet e mëhershme.

Në faqen 13, që është vështirë t’i referohemi ndonjë tabele, meqë asnjëra prej tyre nuk ka numër rendor, vërehet shumë mirë impakti i kësaj Qeverie në ambientin biznesor të vendit.

Për herë të parë, që nga futja e sistemit tatimor në Kosovë, të hyrat nga tatimi në korporata janë më të ulëta sesa të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale. Kjo flet për një situatë shumë shqetësuese për shumicën e bizneseve të vendit.

Në tabelat vijuese, në faqen 14, shihet një përsëritje e dhembshme e zhvillimeve të viteve të mëhershme sa i përket përkushtimit të komunave me shumicë të komunitetit serb ndaj sistemit fiskal të vendit.

Të gjitha komunat me shumicë të komunitetit serb, është fjala për Leposaviqin, Shtërpçën, Ranillugun, Klllokotin dhe Zubin-Potokun, që grumbullojnë më pak se 400 000 euro nga të hyrat vetjake, që është sa gjysma e të hyrave që grumbullon ndonjë komunë me shumicë shqiptare.

Në faqen 19, në tabelën që pasqyron të hyrat në llogarinë e Bankës Qendrore nga interesi shihet diçka shumë e dyshimtë. Edhe pse në shpjegimin e ofruar thuhet se paraja publike investohet që nga viti 2007, megjithatë në tabelë figurojnë zero euro të hyra nga

investimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Qindra milionë euro janë investuar, kurse në buxhet nuk rrjedh asnjë cent nga interesi.

Krahasuar me vitet paraprake, Qeveria e Kosovës ka ngritur pothuaj se të gjitha llojet e shpenzimeve. Por, është një fushë ku Qeveria e Kosovës është kujdesur që ta kursejë paratë publike. Për këtë, Qeveria e ka zgjedhur segmentin më të rrezikuar të shoqërisë. Kështu janë ulur shpenzimet për pensionet bazë, për pensionet e personave me aftësi të kufizuara dhe me ndihma sociale.

Nga tabela në faqen 36 shihet se gjatë vitit 2011 kemi pasur një realizim prej 85% në ekzekutimin e shpenzimeve kapitale. Nëse kësaj ia heqim shpenzimet për autostradë, që përfshin pjesën më të madhe të shpenzimeve kapitale, dhe ku kemi pasur realizim prej 100% të planit të shpenzimeve, del se në pjesën e mbetur implementimi nuk e ka kaluar as 50% të planit.

Tabelat e anekseve në fakt vetëm i krahasojnë shifrat e planifikuara me ato të realizuara, por një krahasim i tillë është i pavlerë nëse tabelat nuk e tregojnë edhe atë nëse paraja publike është shfrytëzuar në qëllimet dhe projektet e destinuara.

Kjo për arsye se gjatë vitit 2011, në vazhdimësi është raportuar për rastet kur projektet e miratuara janë stopuar dhe paratë e grumbulluara janë orientuar në destinacionet e tjera. E gjithë kjo e vë në pikëpyetje vetë logjikën e përpilimit dhe aprovimit të draftbuxhetit nga Parlamenti. Falemnderit!

KRYETRI: Falemnderit! Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit, i nderuari zoti kryetar!

Zoti ministër, kolegë deputetë,

Unë do të ndalem në pika të shkurtra për raportin e shpenzimeve të buxhetit të vitit 2011. Dëgjuam këtu mjaft shifra, por do të fokusohem në diçka tjetër.

Ministri tha se ka rritje ekonomike 5%, ka rritje të zhvillimit ekonomik. Unë besoj që ka pasur mundësi të ketë rritje më të madhe të zhvillimit ekonomik, besoj që ka pasur më tepër mundësi të ketë të hyra nga Administrata Tatimore, ka pasur mundësi që Qeveria të bëjë më shumë për zhvillimin ekonomik, e jo vetëm të marrë të hyra doganore.

Është e vërtetë që Qeveria dhe ministri duhet t'i hedhë anët pozitive, edhe të ministrive, edhe të agjencive buxhetore, ndërsa ne t'i prekim ato pikat më të dobëta.

Unë shpresoj se gjatë raportimeve të agjencive të ndryshme, kemi shumë sosh të cilat janë duke shpenzuar, sidomos qira marramendëse. Shpeshherë në Komisionin e Buxhetit vijnë agjenci që janë me 5-6 të punësuar dhe paguajnë qira mujore me 3.500, 4.000 dhe 5.000 euro, që do të ndikonte më shumë në zvogëlimin e qirasë me qëllim të rritjes buxhetore.

Një problem tjetër është se kemi rritje të shpenzimeve të udhëtimit, që do të thotë se gjatë vitit 2011 nuk kemi pasur ndonjë njohje më shumë ndërkombëtare, por më pak, ndërsa shpenzime kemi pasur më shumë.

Gjithashtu, te subvencionet, sidomos ndaj KEK-ut, ne kemi pritur që KEK-u të fillojë veç ta kthejë kredinë që për shumë vite me radhë e ka marrë nga buxheti i Kosovës dhe prapë po vazhdon subvencionimi i kësaj ndërmarrje, e cila nuk është rentabile.

Një shqetësim që do të kisha cekur janë edhe obligimet e papaguara, që kanë një shumë mbi 20 milionë dhe kjo është mirë që të mos ndodhë në të ardhmen, për arsye se mund të hyjmë në një deficit, e nuk di se çka po ndodh me këto obligime të papaguara.

Një problem tjetër do ta kisha shtuar edhe shpenzimin e karburanteve, të cilat janë 24% më të mëdha. Unë do të them se ka rritje të çmimit të naftës dhe deri diku arsyetohet. Mirëpo, ka mundësi që të shpenzohet më pak, ndërkaq nuk mund t'i arsyetoj shpenzimet mbi 5% të telefonisë, ku ka rënie të çmimeve në këtë aspekt. Unë besoj që në këtë aspekt buxheti mund të kursejë më shumë, të ruhet më shumë, të menaxhohet më mirë dhe të mos na ndodhin shkurtime në disa aspekte që e godasin ndonjë shtresë. Falemnderit.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovën e Re, deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari zoti kryetar i Kuvendit, Të nderuar kolegë deputetë dhe ministra, Koalicioni për Kosovën e Re mendon se raporti i sivjetmë në aspektin metodologjik dhe përmbajtësor shënon një përparim, mundëson një pasqyrë më të qartë se sa herët e kaluara lidhur me krijimin e të ardhurave buxhetore dhe shpenzimet buxhetore.

Gjithashtu ky raport dëshmon se është rritë performansa e grumbullimit të të ardhurave, domethënë janë realizuar planet dhe në atë drejtim domethënë po demonstron një lloj qëndrueshmërie. Mirëpo, më në të ardhmen, në aspektin e asaj çka duhet të përmirësohet, ende ka mundësi të përmirësohet raporti. Në rend të parë, ne mendojmë se ky raport ka tepër karakter teknik, apo evidentues, kontabël, më pak analitik në aspektin e pasqyrimit të arritjes së qëllimeve të politikave ekonomike dhe të performansës. Ju mund të thoni se ligji e ka përcaktuar një strukturë të tillë teknike, por për Kuvendin është shumë me rëndësi që të shohë se sa realizohen nëpërmjet buxheteve vjetore përcaktimet e politikave ekonomike të Qeverisë dhe vendimet e Kuvendit.

Në këtë drejtim, ne edhe me raportet vjetore të buxhetit duhet të ndjekim sa po realizohen prioritetet e zhvillimit. Në qoftë se ne deklarojmë se e kemi prioritet të zhvillimit arsimin, shëndetësinë edhe sektorë të caktuar, edhe në këtë raport ne duhet ta krahasojmë përqindjen e mjeteve të shpenzuara në këta sektorë prej viti në vit, sepse një diferencë pozitive në zhvillim mund të ndiqet dhe mund të realizohet vetëm nëse jemi të qëndrueshëm në prioritetet, e jo kur kërcejmë nga prioriteti në prioritet. Domethënë, sugjerimi ynë është që raporti, krahas përqindjeve që i ka dhënë lidhur me të ardhurat, edhe shpenzimet prej viti në vit, në të ardhmen duhet t'i përcjellë sektorët e shpenzimeve

prej viti në vit në përqindje, në shumë absolute dhe në përqindje, në mënyrë që ta shohim performansën e këtyre sektorëve.

Raporti gjithashtu duhet të merret pak edhe me suksesin, mënyrën e menaxhimit të financave publike, të zbatimit të ligjit. Këtu u përmendën shkurtimet, ma merr mendja se me Ligjin për financat publike Qeverisë i është dhënë mundësia diku deri në një përqindje të bëjë disa ndryshime brenda përqindjeve, brenda zërave të caktuar. Mirëpo, kjo duhet të pasqyrohet dhe të arsyetohet në raport. E jo deputetët tash i shikojnë në disa tabela. Unë nuk e di çka përfitohet në këtë punë. Më mirë është, në qoftë se janë zvogëluar investimet publike për 44 milionë, që u përmend këtu, në raport duhet të thuhet se janë zvogëluar për këtë arsye për këtë arsye, janë zvogëluar në këtë projekt etj. Kjo domethënë që në këtë drejtim është e nevojshme, meqë në raportet e ardhshme të rritet niveli i pasqyrimit të shpenzimeve dhe niveli i transparencës, edhe pse është në krahasim me vitin 2010 kualiteti pak më i madh.

Çështja tjetër është sa jemi ne të kujdesshëm si Kuvend dhe si komisione, dhe çka duhet të bëjmë që ta avancojmë menaxhimin e financave publike. Ma merr mendja që edhe në komision, por edhe në Kuvend, ne merremi shumë me raportet e shpenzimit të disa agjencive të pavarura, që është plotësisht e arsyeshme, sepse secila euro e parasë publike duhet të shihet nëse është shpenzua në destinimin e caktuar dhe në pajtim me vendimet e Kuvendit dhe me politikat ekonomike. Mirëpo, po më duket se neve na ikin nga dioptria e një analize dhe përcjellje më serioze e shpenzimeve të shpenzuesve më të mëdhenj, e sektorëve më të mëdhenj. Ne diskutojmë për këtë projekt, por komisionet përkatëse, edhe Komisioni për Buxhet, por edhe komisionet përkatëse, siç është arsimi, shëndetësia, infrastruktura e tjera, duhet brenda vitit ta shohin shpenzimin, rrjedhat e shpenzimeve, arrijen e objektivave, në mënyrë që me parane publike të arrijmë efekte sa më të mëdha.

Me këto sugjerime për vitet e ardhshme, ne do ta mbështetim këtë raport.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputetja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Samostalna Liberalna Stranka je razmatrala realizaciju budžeta za 2011. godinu i glasaće se za ovaj izveštaj. I pored problema u realizaciju budžeta, raduje nas to što su punjenje budžeta povećana u odnosu na ranije godine. Posebno budžetskih prihodi od poreza na dodatu vrednost, ali i drugih poreza uopšte. Sopstvenih prihodi opština takođe su uvećani u odnosu na raniji period, a kao predstavnicu srpske zajednice radujem činjenica da su posebna povećanja sopstvenih prihoda zabeležena u novoformiranim opštinama na Kosovu.

Smanjenje grantova donatora je evidentno i moramo brzo raditi na stvaranju sopstvenih preformanciji, jer u budućnosti ne možemo ozbiljno računati na njih. Očigledno i hronično manjkanje stranih investicija vidljivo je i u ovom godišnjem izveštaju. Naše potrebe prevazilaze našim mogućnosti, pa je rad na dovođenju stranih investicija, prioritet za nas.

Loš finansijski položaj, najvećih prirednih giganta posebno u energetici, takođe opterećuju naš budžet. Plate i dnevnice, kao i potrošnja robe i usluga, ne prate predviđenih trend, pa zahtevaju poseban oprez. Posebno kada se ima u vidu preporuka Međunarodno monetarnog fonda o smanjenju javne potrošnje.

Poslanička grupa Samostalna Liberalne Strane glasa će za usvajanje ovog izveštaja, smatrajući da je kao izveštaj dat korektno i u skladu sa pravilima izveštaja. Hvala vam!

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Po e shoh se nga interesi për të diskutuar për raportin për buxhetin ekziston një tendencë të kalohet me lehtësi ajo çfarë ka ndodhur. Mirëpo, unë po përpiqem në pika të shkurtra t'i shpreh disa shqetësime që janë shprehur edhe vitin e kaluar, kur është aprovuar buxheti, dhe me pasoja që ka prodhuar aprovimi i atij buxheti.

Përveç problemeve teknike, sa i përket diskrepancës në pasqyra, sa i përket shkurtimit të shpenzimeve dhe ndryshimeve pa kaluar nëpër Kuvend, që i përmendi kolegja Bajrami, unë po kthena pak në origjinën e problemeve të vërteta.

Ne, kur u aprovua buxheti, patëm thënë se aty janë paraparë disa të hyra që do të vijnë nga donatorët ndërkombëtarë të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, të cilat do ta stimulojnë buxhetin e Republikës së Kosovës dhe që realisht, me veprimet që do të ndërmerre Qeveria, me rritjen e pagave, do të rrezikoheshin këto donacione dhe do të shkactohej efekti zinxhiror i një inflacioni, si rezultat i rritjes së pritshmërisë në treg për imputin e parave që do të kishte Qeveria e Kosovës në treg. Të gjitha këto konstatime që Lidhja Demokratike i pati bërë në atë kohë, fatkeqësisht po e them, dolën të vërteta. Doli e vërtetë që Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore e donatorë të tjerë ndalën me dhjetëra miliona euro ndihmë për Kosovën, për të mos thënë një shifër ekzakte që kalon mbi 120 milionë euro.

Po ashtu, lindi problemi tjetër se si rezultat i rritjes së pritshmërive të tregut për rritjen ekonomike dhe për rritjen e pagave ndodhi edhe inflacioni dhe rritja e çmimeve. Ky ishte një problem shumë i madh, me të cilin edhe sot përballet Kosova. Dhe, përveç kësaj, prodhoi edhe pasoja tjera të humbjes ekonomike dhe të mungesës së zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në Kosovë. Si rezultat i këtij buxheti, i cili u realizua në vitin 2011, dhe i defekteve strukturore të buxhetit, të cilat u realizuan nga kjo Qeveri, ndodhi defekti i madh dhe dëmi i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Kosovës.

Neve sot këtu na prezantohet si zhvillim ekonomik i Kosovës investimi në autostradë dhe bile futja e këtij investimi si investim direkt i jashtëm, që realisht nuk do të duhej të ishte dhe nuk do të duhej të ndodhte kështu.

Këto edhe probleme tjera janë probleme të cilat pastaj Qeveria e Kosovës u mundua t'i sanojë dhe t'i anulojë si probleme që kanë ndodhur në këtë vit, duke propozuar ligje dhe

duke i detyruar deputetët e mazhorancës së këtij Kuvendi që t'i kalojnë ligjet që realisht janë kundërshtim me interesin e qytetarëve të Kosovës, siç ka qenë Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, me ç'gjë pjesa e ekonomisë kanë pësuar dëmtim shumë të madh, sepse është operuar në tregun bankar të Kosovës për rreth 12 vjet dhe nuk është paguar asnjë para në buxhetin e Kosovës.

Po ashtu, u tha se është arritje shumë e madhe e Republikës së Kosovës që po kthehemi ku ishim para një viti e gjysmë. Tash, a ishte arritje e madhe në momentin kur tha Qeveria se u prish marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar, apo ishte arritje e madhe momenti kur u kthyem, siç tha Qeveria bëmë arritje prapë, se u kthyem ku ishim.

Unë them se rezultat i këtij raporti, i cili po trajtohet sot, janë edhe këto dështime që i ka pasur Kosova dhe ekonomia kosovare.

Sot kemi nivel më të ulët të mirëqenies sociale, sot kemi investime më të ulëta në infrastrukturën publike, sot kemi të hyra më të vogla në buxhetin e Kosovës dhe probleme edhe me të hyrat në Dogana dhe në Administratën Tatimore, e të gjitha këto vijjnë dhe shkaktojnë probleme në qëndrueshmërinë ekonomike dhe fiskale të Kosovës.

Prandaj, unë mendoj dhe jam i bindur se buxheti i vitit 2011 ka qenë shkaktar i dëmeve të vazhdueshme për ekonominë e Kosovës dhe se ky raport është pjesë e këtyre dëmeve që kanë ndodhur. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Ministër, urdhëro, e ke fjalën përfundimtare!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Falemnderit, zoti kryetar!

Fillimisht dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës për kontributin e tyre dhe sqaroj edhe një herë se ky raport është përgatitur në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, konkretisht me nenin 46.1 dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, të bazuar në para të gatshme.

Se është në harmoni me këtë ligj dhe me këto standarde flet edhe raporti i Auditorit për raportin e buxhetit për vitin 2010, i cili e ka pasur njëjtin format, të njëjtin standard, me disa përmirësime, për të cilin kanë dhënë kontribut deputetët e Kuvendit të Kosovës, dhe po i referohem këtij raporti të Auditorit, në faqe 18, ku thuhet: "Pasqyrat financiare e japin në të gjitha aspektet materiale një prezantim të vërtetë dhe të drejtë të financave dhe gjendjes financiare në raportin vjetor financiar mbi buxhetin e Republikës së Kosovës", e ky është një opinion i pakualifikuar.

Unë e di që, edhe u cek, duke e vlerësuar të drejtën e deputetëve të votojnë sipas bindjes së vetë, mirëpo e kam thënë edhe me rastin e aprovimit të buxhetit, e po e përsëris sot, që do të ishte mirë të votohet buxheti. Se vota kundër buxhetit ka qenë votë kundër rritjes së pagave, ka qenë votë kundër vazhdimit të punimeve të autostradës, ka qenë votë kundër rritjes së të ardhurave për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Nganjëherë më

shumë thotë një grafikon se shumë fjalë, e kjo flet më së miri. Këtu e kemi krahasimin e të hyrave nga viti 2007, ky është trendi, ky është grafikon.

Tjetër, e kemi krahasimin e shpenzimeve nëpër vite, nga 661 milionë, në vitin 2007 ne kemi arritur në një miliard e 388 milionë. Asnjë prej neve nuk pajtohem se është mjaft. Të gjithë e dimë se ka nevojë më shumë, edhe ka vend për më shumë. Dhe, mbi të gjitha, e kemi grafikonin me krahasimin e shpenzimeve kapitale, se e tha zoti Gashi, tha kemi rënie të investimeve kapitale, por grafikoni nuk po thotë ashtu. Po thotë ndryshe, po thotë nga 155 milionë në vitin 2007 kemi arritur në 528 milionë, që është 241%. Prandaj, nuk ka rënie të të hyrave, nuk ka rënie të investimeve kapitale.

Në vazhdim, në mënyrë telegrafike, do të flas për disa çështje që u shtruan këtu.

U cek shkurtimi i shpenzimeve. Ligji i buxhetit i jep disa mundësi dhe nëse e krahasojmë Ligjin e buxhetit të Kosovës me Ligjin e buxhetit të vendeve të tjera, Ligji i buxhetit të Kosovës nuk ka shumë fleksibilitet. Por, edhe Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë mbi bazën e të cilave hartohet Ligji për buxhetin jep mundësi tjera, jep mundësinë e ridestinimit brenda së njëjtës organizatë buxhetore; kur del në një lartësi deri në 5%, e ka të drejtën organizata buxhetore, mbi 5% deri 15% e ka të drejtën, me kërkesë të organizatës buxhetore, Ministria e Financave, deri në 25% Qeveria, dhe mbi 25% Kuvendi.

Mospërputhje ndërmjet buxhetit dhe raporteve - Aty kemi pasur bartje të të hyrave vetjake nga viti paraprak, që është shpërndarë nëpër organizata buxhetore dhe nëpër komuna të caktuara. Pastaj, kemi pasur bartjen e rezervës së Qeverisë nëpër projekte të caktuara.

U përmend humbja e donacioneve. E theksova në paraqitjen time të parë, që Banka Botërore, si rezultat i përmbushjes së marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, i ruajtjes së stabilitetit makro-fiskal, në fund të fitit të kaluar e ka bërë derdhjen e 25 milionë në buxhetin e Kosovës. Nesër do të nënshkruhet marrëveshja e re me Bankën Botërore dhe pritet që deri më 30 qershor të vijjnë edhe 50 milionë dollarë për buxhetin e Kosovës.

Ndërsa Fondi Monetar Ndërkombëtar, si rezultat i arritjes së marrëveshjes, i ka derdh në buxhetin e Kosovës 5 milionët e parë.

Obligimet e papaguara, detyrimet e papaguara janë rreth 39 milionë euro në nivelin qendror dhe lokal. Janë detyrime të cilat kanë të bëjnë me muajin dhjetor, kryesisht. Ne jemi të obliguar dhe është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar që të mos kemi obligime të papaguara më tepër se 30 ditë. Do të thotë, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që brenda 30 ditëve t'i bëjnë pagesat, ndërsa faturat janë të dhjetorit dhe normalisht që janë paguar në janar.

Sa i përket asaj që u tha se tabelat janë të mangëta, unë e theksova se janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike.

U përmend kredia e KEK-ut. Të gjithë e dimë se nuk ka qenë e lehtë për të vendosur, mirëpo kemi qenë në situatë kur kemi zgjedhur midis dy gjëra jo fort të mira: të mos e financojmë KEK-un dhe të përballemi me situata më të rënda në sektorin e energjisë, se sa kjo që është, apo ta përkrahim KEK-un dhe të kemi përmirësim të furnizimit me energji elektrike. E prej këtyre dy gjërave, kjo e fundit ka qenë më e arsyeshme, prandaj ka ndodhur kjo.

Të hyrat nga donatorët janë duke ardhur. Këto ishin disa sqarime në disa çështje të cilat u shtruan. Ju falënderoj edhe një herë për kontributin. Sigurisht se raportet e ardhshme do t'i marrin në konsideratë edhe kërkesat e deputetëve. Ne në kërkesat individuale të deputetëve apo të komisioneve kemi obligim që të prodhojmë edhe raporte shtesë, që janë në përputhje me kërkesat e deputetëve. Falemnderit!

KRYETARI: Arben Gashi ka të drejtë në replikë, pasi i është përmendur. Jo në emër të grupit, sepse është fjala përfundimtare e ministrit. Arben Gashi, replikë!

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Unë desha vetëm t'i konfirmoj disa gjëra, meqë edhe ministri duke u munduar të bëjë fizkulturë për të ikur prej nominimit të saktë ose emërimit të saktë të atyre çfarë kanë ndodhur, doli me disa probleme, defekte edhe në të menduar.

Sa u përket investimeve kapitale, ministri tha se investimet kapitale janë 530 milionë, diku aty përafërsisht, por ministri nuk e tha që këta 530 milionë pothuaj se 90 e sa për qind e këtyre 530 milionëve janë për 36 kilometra autostradë. Dhe, investimet kapitale dhe efekti i multiplikatorit në ekonomi është shumë i ulët, sepse dihet se shumica e këtyre parave kanë dalë jashtë, jashtë tregut të Kosovës.

Ministri tha se po vijnë paratë e Fondit Monetar dhe të Bankës Botërore, sepse ka qenë e prishur ajo marrëveshja, e tash paskan filluar të vijnë, por me dy vjet mungesë. Tregut të Kosovës i kanë munguar 140 milionë euro vitin e kaluar. Ky është një dëm shumë i madh për ekonominë e Kosovës.

Po ashtu, një element tjetër shumë i rëndësishëm, dëmi tjetër që po i bëhet ekonomisë së Kosovës dhe interesi të qytetarëve të Kosovës është me Ligjin për institucionet mikrofinanciare, meqë 120 milionë euro dalin edhe bëhen si shoqëri aksionare, prandaj ka hapësirë për abuzime të mundshme.

Këtu u tha që dikush paska votuar dhe në këtë rast i bie se ne kemi votuar kundër atij buxheti, sepse kemi votuar kundër pagave, sepse kemi votuar kundër rritjes së pensioneve dhe gjëra tjera. Ne kemi votuar kundër atij buxheti, sepse kemi votuar kundër abuzimit me interesin e qytetarëve të Kosovës, kemi votuar kundër rritjes së inflacionit si rezultat i përditshmërive të tregut, kemi votuar kundër humbjes 140 milionë eurove, kemi votuar

kundër dështimit të njëpasnjëshëm të kësaj Qeverie, kemi votuar kundër prishjes së marrëdhënies me Fondin Monetar Ndërkombëtar, kemi votuar kundër prishjes së marrëdhënieve edhe me Bankën Botërore dhe me institucionet tjera donatore në Republikën e Kosovës, kemi votuar kundër dhënies në ekonominë e Kosovës të 140 milionë euro. Kjo është ajo çfarë kemi votuar.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E kemi përmbyllur debatin. Të pranishëm janë 66 deputetë. Votojmë miratimin e Raportit financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011. Votojmë tash!

Me 36 vota “për”, 29 “kundër”, miratohet raporti financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Tani i votojmë rekomandimet e interpelancës. Votojmë tash!

Me 55 vota “për”, 9 “kundër”, asnjë abstenim, miratohen rekomandimet që dolën nga interpelanca.

Kurse tash i votojmë rekomandimet e seancës së kaluar, të dalë nga debati. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 57 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimet e seancës së kaluar, që kanë dalë nga debati për të pagjeturit.

Vazhdojmë tutje me pikat e radhës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

Lus deputetët të rrinë në sallë, se na duhet votimi. Regjia, fjalën deputetit Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar Ligjin për marrëdhënien e detyrimeve, i cili është një ligj shumë voluminoz, ka mbi 1.060 nene. Është një ligj, i cili rregullon një fushë shumë specifike, për krijimin dhe shuarjen e raporteve juridiko-civile, barazinë e pjesëmarrësve në këto raporte dhe rregullat për autonominë e vullnetit në raportet juridiko-civile.

Ky projektligj, përmban edhe rregulla për ndershmërinë dhe dëgjueshmërinë e subjekteve në këto raporte, si dhe rregulla për ndalimin e keqpërdorimit të të drejtave, me rastin e krijimit të marrëdhënieve të detyrueshme.

Rregullativa juridike, me sistematizim të qartë të materies dhe që rregullon dhe materien që e përmban ky ligj në 1061 nene, parasheh të gjitha ato marrëdhënie juridiko-civile, të cilat duhet të ndërtohen dhe si funksionojnë dhe si shuhen ato.

Mendoj se është njëri prej ligjeve më të rëndësishme, që miratohet nga ky Kuvend dhe është një punë e cila është bërë jashtëzakonisht, për një kohë të gjatë.

Puna në këtë ligj, ka disa muaj që bëhet nga komisioni, mirëpo sa i përket grupeve punuese, para se të vijë në Kuvend, ka vazhduar me vite të tëra dhe janë përdorur praktikatat më të mira të mundshme, në hartimin e marrëdhënieve juridiko-civile.

Prandaj, Komisioni për Legjislacion rekomandon që të aprovohet ky ligj dhe kërkon përkrahjen e deputetëve. Falemnderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Falemnderit!

Keni kërkuar fjalën, është paraqitur dikush për diskutim për ligjin, apo... ju kanë mbetur emrat kështu!

Deputetja Bajrami. Albulena... për ligjin... Jo, s'ka diskutime, vetëm për amendamente.

(Ndërhyrje)

Po, po ua mundëson. Në rregull, në rregull. Po, nuk është si rregull për të diskutuar sipas... për të paraqiturit, po. Për të paraqitur si deputetë mund të thuash në emër të Grupit, s'ka asnjë problem.

Atëherë, fjalën e ka për ligjin, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Atëherë, unë dua t'i bëj me dije qëndrimet e subjektit "Vetëvendosje" në lidhje me Ligjin e detyrimeve.

Së pari, ende nuk po kuptohet qartë qëllimi i bërjes së këtij ligji në këtë formë dhe me këtë përmbajtje dhe kjo akrobaci e radhës e Ministrisë së Drejtësisë është edhe më e rëndë se ajo me Kodin Penal, pra përkatësisht me nenet 410 që ishte "thirrja për rezistencë", mandej 37 dhe 38. Ky ligj duhet të kishte marrë formën e Kodit civil, këtë kam insistuar edhe në grupin punues dhe në komision. Ministria e Drejtësisë duhet ta kishte propozuar një iniciativë, do të ishte shumë më praktike sikur të punohej ende për të ardhur me një kod të unifikuar për këto marrëdhënie siç është tradita e vendeve gjermanike dhe e vendeve të së drejtës civile, prej të cilave vjen edhe tradita jonë në këtë fushë. Në të njëjtën kohë mund të bëhej një studim i praktikës së zbatimit të ligjit aktual, lëndët gjuhësore të studiojë problematikat të tyre.

Kalimi i këtij ligji sot, nënkupton rikthimin sërish për të bërë të njëjtën gjë, por për Kodin Civil pas disa viteve. Ç'farë kuptimi ka kjo punë e dyfishtë dhe kjo sjellje amatoreske prej Ministrisë? Sa i përket përafrimit me legjislacionin e BE-së, Parlamenti ka kaluar disa projektligje kohët e fundit, një pjesë e mirë e të cilave mund të ishin pjesë e këtij ligji, ndërkohë ato janë ligje të veçanta. Nga ana tjetër kanë kaluar projektligje që kanë dispozita të ngjashme me këtë ligj për mbrojtjen e konsumatorit. Qeveria e Kosovës njëjtë si me nenin 410 që ishte për "thirrjen për rezistencë" dhe neni 37, 38 të Kodit Penal nuk lë rast pa vendosur forma brutale të shkeljes të së drejtave dhe lirive politike dhe civile.

Çështje shqetësuese që e kam ngritur gjithashtu edhe në grupin punues, por edhe në komision, është që ky ligj nuk përmban asnjë përkufizim për termat juridikë që janë thelbi i projektligjit. Pra, mungojnë përkufizimet: kontratë, detyrim, përgjegjësi dhe asnjë qytetar nuk është në dijeni çka mund të thonë këto terma dhe do të ishte shumë më mirë sikur të përfshiheshin këto përkufizime, gjë që nuk ka ndodhur. Miratimi i këtij ligji është dështim i plotë profesional dhe juridik dhe është po ashtu sabotim qeveritar i krijimit të marrëdhënieve korrekte juridike në shoqëri dhe si të tillë, kështu si është ne nuk do ta votojmë. Falemnderit!

KRYESUESI: Atëherë i votojmë amendamentet një nga një.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka

Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? S'ka

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? S'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 6
Kundër” s’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 7
Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.
Amendamenti 8
Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 9
Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 10
Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 11
“Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 12
“Kundër”? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 13
Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 14
Kundër? S’ka.
Abstenim? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 16
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 17
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 18
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 19
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 20
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 21
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 22
“Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 23
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 24
Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 25
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 26
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 27
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 28
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 29
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 30
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 31
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 32
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 33
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? S'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? S'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 43
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 44
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 45
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 46
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.
Amendamenti 47
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 48
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 49
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 50
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 51
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 53
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 54
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 55
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 56
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 57
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 58
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 59
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 60
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 61
Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 62
Kundër? S'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 63
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 64
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 65
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Amendamenti 66, i fundit.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë janë 66 deputetë. Regjia votojmë tani.

Konstatohet se me 48 vota “për”, 9 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për marrëdhëniet e detyrimit.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e këtij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesen e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeten Nazane Breca, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Breca e keni fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjet e mbajtura ka shqyrtuar projektligjin dhe ka pasur mjaft debate për këtë projektligj.

Projektligji nga të gjithë anëtarët e Komisionit është konsideruar shumë i rëndësishëm, i cili rregullon një fushë që ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve të reja për të qenë përfitues i ndihmave sociale, eliminimin e disa kriterëve financiarë për ndihmë sociale, të cilat nuk kanë qenë në funksion dhe në përputhshmëri me gjendjen reale dhe materiale të familjeve përfituese nga skema sociale. Diskutim ka pasur, sidomos rreth kriterëve të kategorisë së dytë ku është vërejtur një kriter diskriminues sa i përket fëmijëve deri në moshën 5-vjeçare, edhe pse pas shumë diskutimeve Komisioni nuk ka arritur ta largojë këtë kriter nga ligji për shkak të implikimeve buxhetore. Me shumicë votash anëtarët e Komisionit kanë miratuar amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur, më 3 prill 2012, ka përfunduar raportin dhe amendamentin dhe në të njëjtën e ka proceduar te komisionet kryesore: Komisioni për Legjislacion, Komisioni për Buxhet, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Komisioni për Integritet Evropian. Nga asnjëra prej këtyre komisioneve nuk kemi pasur vërejtje, përpos Komisionit të Legjislacionit që ka pasur vërejtjen për amendamentin 5. Për t'i shkurtuar procedurat, unë do ta jap një arsyeshmëri edhe do t'i lus deputetët ta votojnë.

Pra, nga Komisioni për Legjislacion kemi marrë vërejtjen për amendamentin 5. Sa i përket vërejtjes së amendamentit është i pa objekt, është një gabim teknik i cili është përmirësuar që duhet të jetë paragrafi 6 e jo 7. Sa i përket përmbajtjes së amendamentit, Komisioni mendon se amendamenti duhet të miratohet, sepse është harmonizim dhe plotësim i ndryshimit që është bërë me amendamentin 3 sa i përket kategorive të familjeve të përzgjedhura për ndihmë sociale dhe kjo është bërë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ministrinë përkatëse.

Me amendamentin 3, neni 4 të ligjit në fuqi është ndryshuar edhe kategoritë 4. 1a dhe 4. 1b, tani me projektligjin e ri janë 4.4 dhe 4.5. Prandaj, edhe neni 6 i ligjit në fuqi duhet harmonizuar me ndryshimet e bëra me amendamentin 3. Në emër të Komisionit funksional ju ftoj ta votoni amendamentin 5 dhe projektligjin në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe për sqarimin lidhur me amendamentin e 5-të e votojmë me elektronikë kuptohet për arsyet që dihen.

Është lajmëruar Liburn Aliu për diskutim.

Zoti Aliu e keni fjalën.

LIBURN ALIU: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” Projektligjin për ndryshim dhe plotësim për skemën e ndihmës sociale të Ligjit për skemën e ndihmës sociale, amendamentet do t'i votojmë “për”, ndërsa ligjin nuk do ta votojmë “për”, do të jemi “kundër”. Arsyet janë që ligji edhe përkundër amendamenteve që janë pozitive dhe e

përmirësojnë në shumë pika vazhdon të mos i plotësojë as për së afërmi qëllimin për atë se për çka edhe është bërë. Në fakt që t'i plotësojë nevojat për ndihmë sociale të qytetarëve të Kosovës.

Që në pikat e para ky ligj i diskriminon personat me aftësi të kufizuara, pra ata që marrin pension për shkak të aftësive të kufizuara dhe nuk i heq nga lista e skemës sociale. Duhet ta kemi parasysh që këta persona pensionet i marrin për arsye subjektive dhe pensionet ata i bëjnë që sadopak të mund të jenë të pranueshëm në shoqëri dhe ata prapë vazhdojnë të jenë në familjet që kanë nevojë për ndihmë sociale. Po ashtu, edhe personat të cilët janë përfitues të pensioneve si rezultat i kontributeve dhe sakrificës apo pasojave të luftës së UÇK-së, prapë arsyeja për këto pensione është e karakterit subjektiv dhe rrjedhimisht ata pensionin e marrin për arsye subjektive, ndërsa mund të vazhdojnë ende të jenë, do të duhej të ishin në skemën e ndihmës sociale, sepse mund t'u takojnë familjeve që kanë nevojë për ndihmë sociale.

Elementi tjetër është- personat studentë, të cilët janë në studime të rregullta deri në moshën 24- vjeçare dhe të cilët janë nën përkujdesjen e familjes. Pra, sipas Ligjit të familjes, prindërit, të cilët kanë fëmijë studentë që janë në studimet e rregullta kanë obligime familjare që si prindër t'i mbajnë ata. Dhe, meqenëse Ligji për familjen i obligon prindërit që t'i mbajnë fëmijët e tyre studentë ata nuk do të duhej të hiqeshin nga kjo listë, sepse është diskriminim, pra bie në kundërshtim me ligjin tjetër që është Ligji për familjen.

Për sa i përket personave, familjeve të cilët hiqen për shkak se fëmijët mund t'i kalojnë moshën 5- vjeçare edhe ky është një ndër aspektet që nuk ka mund të zgjidhet si duhet, dhe unë konsideroj se megjithatë është e paarsyeshme që nuk zgjidhet me këtë ligj. Elementi tjetër që e bën totalisht të papranueshëm këtë ligj është neni 13 për beneficionet që janë si subjekt i vështirësive fiskale, ku parashihet që në kur krijohen tendosjet e parapara fiskale në buxhetin publik i jepet e drejta Qeverisë që të bëjë shkurtimin apo edhe heqjen totale të ndihmës sociale. Këtë nen e kemi në shumë ligje tjera, por të mos harrojmë këtu kemi të bëjmë me një ligj të veçantë, me një kategori të veçantë që është kategoria që merr ndihmë sociale dhe kjo është e përcaktuar në bazë të kalorive. Kur flitet për kaloritë që duhet t'i plotësojë një person, nënkuptohet ekzistenca.

Nënkupton pra, elementin ekzistencial i cili do të duhej të ishte i garantuar nga shteti në çfarëdo shtate. Pra, nëse ndonjëherë do të mund të binim në situata që shteti të detyrohej të bënte kursime për shkak të vështirësive fiskale, këto nuk do të duhej të bëheshin asnjëherë në kurriz të kategorive sociale, respektivisht të personave të cilët marrin ndihmë sociale nga shteti, sepse kjo ndihmë është thjeshtë ndihmë elementare. Prandaj, me amendamentet tjera gjatë trajtimit në komision kemi bërë përpjekje që t'i ndryshojmë, të gjitha këto amendamente e përmirësojnë, por natyrisht ky ligj vazhdon të mos jetë i pranueshëm kësajsoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, Liburn! Shihni a ka deputetë në bife apo ku kanë mbetur? S'kemi kuorum.

Faleminderit! U arrit kuorumi. Atëherë, fillojmë me votimin e amendamenteve një për një.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5. Janë dy propozime, i Komisionit funksional, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion.

A dëshiron dikush të sqarojë diçka? Jo. Atëherë, votojmë me elektronikë këtë meqenëse janë dy. Pra është amendamenti i Komisionit funksional i pari votohet dhe nëse është “kundër” atëherë fiton varianti i Komisionit për Legjislacion. Votojmë, tani. Tani, i pari i Komisionit funksional.

Po, kërkoj falje. E dini praktika është që kur të votohet varianti “pro” është gjithmonë për Komisionin funksional, “kundër” është për vërejtjet e komisioneve tjera ose kandidatëve, ose deputetëve tjerë. Faleminderit!

E përsërisim votimin edhe njëherë meqenëse kishte paqartësi. Votojmë tani. Faleminderit!

Më 55 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, fiton varianti i Komisionit funksional, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion.

Amendamenti 6

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 8
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 9
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 10
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Tani e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Më 45 vota “për”, 9 vota “kundër”, 2 abstenime, konstatohet që Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011

Raportin e punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni funksional për Legjislacion dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Tani unë besoj që s'është obligim për ta diskutuar secili grup përveç në qoftë se ka ndonjë vërejtje.

Sipas radhës, kryetari i Komisionit Funksional për Legjislacion zoti Gashi e ka fjalën. Nuk është këtu.

Në emër të Komisionit, zoti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni e ka shqyrtuar raportin e punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe e rekomandon Kuvendit aprovimin e tij.

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Në bazë të nenit 6.1 të Ligjit për Institutin Gjyqësor të Kosovës, ky Institut i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, meqenëse e shfrytëzon buxhetin e Kosovës dhe duhet t'i raportojë Kuvendit së bashku me raportin e punës. Në kuadër të këtij raporti duhet të përfshihet edhe raporti që ka të bëjë me financat në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Në raportin e shpenzimeve, për vitin 2011 të Institutit Gjyqësor të Kosovës janë pasqyruar shpenzime për të gjitha kategoritë ekonomike të përmbledhura dhe në mënyrë të detajuar. Ky Institut ka pasur një buxhet prej 596 mijë e 449 euro, ka shpenzuar 578 mijë e 895 euro, çka do të thotë se ka shpenzuar diku 97% të buxhetit që ka pasur të ndarë për vitin 2011. Po ashtu, në raport janë të paraqitura edhe të dhënat për kategoritë ekonomike ku vërehet që 92% janë shpenzuar për paga dhe mëditje, 99% për mallra dhe shërbime dhe shpenzimet komunale, 69%.

Raporti po ashtu, përfshin edhe të dhënat të cilat kanë të bëjnë me mbështetjen e donatorëve që ia kanë dhënë këtij Instituti, mandej edhe detyrimet që i ka Instituti Gjyqësor, ende të pa përmbushura. Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e datës 11.4.2012, pasi e ka shqyrtuar raportin ku kanë qenë pjesëmarrës edhe përfaqësues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe pasi ka marrë sqarimet për çështjet e ngritura nga anëtarët e Komisionit, sidomos te kategoria mallra dhe shërbime për nënkategorinë e shpenzimeve për shërbime, ku janë shpenzuar diku 254 mijë e 619 euro, e ka përkrahur njëzëri këtë raport dhe i rekomandon Kuvendit që të njëjtin ta miratojë, pasi që raporti i përmbush kërkesat që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj është lajmëruar në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARMEND ZEMAJ: Atëherë vetëm të theksoj se edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011, në mënyrën më të mirë të mundshme e shohim që avancimi i punës në këtë Institut, ka treguar rezultate konkrete edhe me trajnimin e gjyqtarëve edhe të prokurorëve. Mbetet sfida edhe për këtë vit programi fillestar për arsimimin ligjor, i cili ka filluar në vitin 2010. Kjo është konstatuar edhe nga takimi në Komisionin funksional.

Ne i japim përkrahje dhe dëshirojmë që Instituti Gjyqësor të tregojë rezultate edhe në praktikë, siç është rasti në avancimin edhe në aspektin e punës së prokurorëve dhe të gjyqtarëve.

Prandaj, këto trajnime dhe me këtë përmbajtje të detyrave, të cilat janë të përfshira, mendoj që kanë avancuar në këtë drejtim, ndoshta edhe ajo që është ideja për konstituimin e një shkolle, e cila në të ardhmen do të quhej shkolla gjyqësore e Kosovës për përgatitje të kuadrove, siç janë prokurorët dhe gjyqtarët vendorë.

Ne i japim përkrahje, vota jonë është “për”, për punën dhe aktivitetin që ata janë duke e zhvilluar. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Albulenë Haxhiu!

ALBULENË HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Edhe ne si grup parlamentar e kemi analizuar raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011. Për atë që kemi vërejtur në raport, ky institut me përgjegjësi e ka kryer detyrën e vet, e që është aftësimi i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Pra, kjo është një ndër pjesët më të rëndësishme të këtij raporti, pasi sistemi i drejtësisë është në nevojë për përgatitjen e kuadrove të reja.

Ajo që është shqetësuese e që vërehet në këtë raport, është mungesa e buxhetit. Është krijuar njëfarë praktike, e cila është e qëllimshme, që institucioneve të pavarura, sidomos atyre të drejtësisë, po u bëhet shkurtime i buxhetit pa analiza konkrete paraprake. Pra, pa kurrfarë arsytimi po u bëhet njëfarë reduktimi arbitrar i buxhetit.

Dhe, ky shkurtime buxhetor ka sjellë për pasojë mosrealizimin e shumë projekteve nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, pasi buxheti me të cilin ky institut ka operuar ka qenë i pamjaftueshëm. Ky shqetësim ka qenë edhe nga zoti Krasniqi, i cili ka raportuar në komision, pra Lavdim Krasniqi.

Shkurtime të tilla buxhetore janë në kundërshtim me vetë Ligjin për gjykatat, me të cilin kërkohet përgatitje për gjyqtarët. Është në kundërshtim me reformat në sistemin gjyqësor, mirëpo, si duket, kjo Qeveri është e interesuar që kjo reformë të mos ndodhë.

Mbetet për t’u bërë më shumë nga ky institut në kryerjen e veprimeve të tjera profesionale, sidomos në atë të hulumtimeve. Ne e çmojmë dhe e mbështetim punën dhe angazhimin e deritanishëm të punëtorëve të këtij instituti, edhe pse vazhdon të mbetet sfida funksionimi i pavarur i sistemit të drejtësisë, me çka ballafaqohen që në fillim këto kuadro. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit!

ALBULENË HAXHIU: Kryesues, më fal! Vetëm harrova të tregoj që ne do ta përkrahim këtë raport. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Edhe ne do ta përkrahim, edhe pse pajtohemi me sfidat e mëdha dhe vërejtjet, që dhanë edhe dy grupet e tjera parlamentare, para nesh. Dhe, me shpresë që do t'i lejohet një funksionim i pavarur, duke marrë parasysh që në Kosovë deri tani e kemi parë të kundërtën, do të votojmë “pro”. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah punën e Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011 dhe shpresojmë që në të ardhmen ky institut të përforcohet edhe më shumë, që të kemi drejtësi dhe ligj për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Të paraqitur të tjerë nuk ka. Atëherë, konstatoj se në mbledhje janë të pranishëm... Nuk ka kuorum. Atëherë, vazhdojmë me diskutimin e raporteve tjera, nëse jeni dakord, meqë nuk ka kuorum, t'i votojmë nesër. Se janë 51... Po, tash... unë... jo, deputetët po i thërrasim edhe një herë, por...

(Ndërhyrje)

(Ndërprerje nga regjia)

Atëherë, të nderuar deputetë, falemnderit për korrektësinë, jini të mirë! Nuk e ndërpremë. Në sallë janë 64 deputetë.

Votojmë për Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011. Votojmë tani!

Falemnderit! 57 vota “për”, 2 abstenime, asnjë kundër.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011

Raportin vjetor të punës së Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011, e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur të Medieve për vitin 2011 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 3, pika 8, të Ligjit të Komisionit të Pavarur të Medieve, brenda dy muajve, pas përfundimit të çdo vitit kalendarik, Komisioni i Pavarur për Media ia paraqet Kuvendit Raportin vjetor të punës.

Komisioni FunkSIONAL, në mbledhjen e mbajtur më 18.4.2012, e shqyrtoi Raportin vjetor të punës për vitin 2011 të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Në këtë rast, Komisioni FunkSIONAL vlerësoi se Raporti vjetor i punës për vitin 2011, i parashtruar nga Komisioni i Pavarur për Media, është në pajtim me nenin 3, pika 8, të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit!

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, kryesues!

Raporti financiar i Komisionit të Pavarur për Media përfshin pasqyrat financiare të këtij komisioni, mbi aktivitetet e tij, në periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2011.

Ky institucion ka pasur gjithsej buxhet të ndarë 901.939 euro. Ka shpenzuar 706.059 euro, kurse 79.558 euro kanë mbetur të pashfrytëzuara, që do të thotë se Komisioni i Pavarur i Medieve ka shpenzuar diku rreth 89% të buxhetit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin financiar të Komisionit të Pavarur të Medieve, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e KPM-së.

Më 11 prill 2012, anëtarët e komisionit kanë kërkuar informata më të hollësishme për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit të këtij institucioni dhe për shërbime të ndryshme intelektuale.

Po ashtu, ka kërkuar edhe informata më të detajuara në lidhje me kategorinë e investimeve kapitale, për çka kanë qenë të ndara diku 450.000 euro. Kurse, janë shpenzuar vetëm 8.120 euro, domethënë kjo kategori nuk është shpenzuar. Dhe, arsyetimet e Komisionit të Pavarur të Medieve kanë qenë se këto mjete janë shpenzuar vetëm për projektin ideor, kurse nga pamundësia që të ndahet një parcelë, ku do të ndërtohet objekti i këtij komisioni nga Komuna e Prishtinës, mjetet kanë mbetur të pashfrytëzuara.

Pas marrjes së përgjigjeve nga Komisioni i Pavarur i Medieve, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka përkrahur Raportin financiar dhe i rekomandon deputetëve të Kuvendit ta miratojnë këtë raport.

KRYESUESI: Falemnderit! Komisionet dhe grupet parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Falemnderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media dhe e vlerëson si një raport shumë më pozitiv se vitet e tjera. Shohim që zyra e Ekzekutivit me të vërtetë e ka kryer një punë shumë të mirë, në krahasim me anëtarët e Bordit, të cilët sikur i japin shpeshherë vetes komoditet, dhe sigurisht se rezultatin e punës së tyre e kanë përfituar edhe anëtarët e Bordit.

Në këtë rast, vërejtjet theksohen të çështja që KPM-ja, në bashkëpunim me industrinë mediale dhe institucionet relevante, e ka vazhduar punën nëpërmjet grupeve punuese në projektin me rëndësi nacionale, strategjinë për kalim në digjitalizim. Realisht, vërejtja qëndron se në Ligjin e ri për KPM-në, çështja e procesit të digjitalizimit ka mbetur të bëhet me një ligj të veçantë dhe kjo është një çështje që i takon edhe sferës së sigurisë dhe do të ndërlidhet me shumë aktorë të tjerë dhe kështu konsideroj se ndoshta nuk ka pasur nevojë që të flitet në raport për këtë çështje.

Mirëpo, realisht, zyra ekzekutive ka realizuar projekte të shumta të monitorimit të të gjitha subjekteve transmetuese në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me përjashtim që çështjet që janë parashtruar të kërkesat për frekuenca nuk ka arritur t'i realizojë, për arsye që i dimë, ngase Bordi nuk është plotësuar. Prandaj, është një çështje që neve, Kuvendit, na takon ta realizojmë.

Është e rëndësishme të theksohet se puna e KPM-së, vite me radhë është vlerësuar pozitivisht edhe në raportet e progresit nga organizmat tjerë ndërkombëtarë dhe na mbetet si Kuvend që të bashkëpunojmë sa më shumë me këto institucione dhe t'i përkrahim ato në sfidat që kanë për t'u përmbushur misioni dhe obligimet e dala nga ligji.

Po ashtu, më lejoni ta përgëzoj punën e stafit të Ekzekutivit, një punë që e kanë kryer, domethënë shërbyesit civilë, të cilët nuk kanë qenë edhe të inkurajuar aq shumë me pagë, mirëpo kanë qenë të trajnuar vite me radhë, kështu që, me të vërtetë, vitet tjera na mbetet t'i përkrahim edhe të çështja e financave.

Grupi ynë parlamentar e përkrah këtë raport dhe do të votojë “pro”. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ferati e ka fjalën!

SADRI FERATI: Falemnderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e Komisionit FunkSIONAL.

E vlerësojmë pjesën e kontributit, që pasqyrohet në këtë raport, sidomos pjesa që lidhet me bashkëpunimin e KPM-së, në nxjerrjen e tij. Gjatë gjithë fazës së punës, pra që në hartimin dhe draftimin e Ligjit për KPM-në, po ashtu vazhdimësia në monitorimin e medieve elektronike, si dhe dëshirën e mirë, që ta zhvillojë strategjinë për digjitalizimin e medieve elektronike.

Por, ajo që mund të quhet mungesë e zhvillimit dhe progresit më tutje lidhet me rrethanën objektive të mungesës së kuorumit në Bord. Pra, siç dihet, Bordi ka mbetur vetëm me dy anëtarë dhe besojmë se Kuvendi do të jetë bashkëpunues, ngase tani është në dorën e Kuvendit, ngase janë krijuar të gjitha rrethanat që Bordi të emërohet sa më shpejt, në mënyrë që KPM-ja të mund t'i vazhdojë punët e veta.

Dhe, ne do ta përkrahim rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL që të votohet “pro” këtij raporti.

KRYESUESI: Falemnderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, Alma Lama apo dikush tjetër? Afrim Kasolli? Zoti Kasolli e ka fjalën! Janë dy të paraqitur.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2011.

Pajtohemi me shqetësimet e deputetëve, që paraprakisht e vunë në spikamë, sidomos paralizimin plotësisht sa u përket aftësive vendimmarrëse të këtij institucioni kushtetues, që ka për obligim rregullimin e frekuencave audio-vizuale në Republikën tonë. Po ashtu, edhe vetë raporti, të cilin e kemi në dorë, praktikisht ka ardhur i pamiratur nga Këshilli i KPM-së, e të cilin kanë pasur për obligim ta miratojnë për shkak se Këshillit të KPM-së i mungon kuorumi për të marrë vendime.

Rrjedhimisht, shumë nga objektivat, të cilat janë paracaktuar nga KPM-ja, nuk kanë mundur të realizohen dhe ato janë bartur në vitin tjetër, pikërisht nga mungesa e kuorumit dhe anëtarëve të Këshillit të KPM-së.

Përfundimisht, ky raport duhet më tepër të na ndërgjegjësojë, që si Kuvend sa më shpejt të intervenojmë, në mënyrë që t'i plotësojmë vendet vakante sa i përket aspektit strukturor dhe organizativ të këtij mekanizmi. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Haxhiu.

TETUA HAXHIU: Falemnderit, nënkryetar i Kuvendit!

Pas leximit të kujdesshëm të Raportit të punës për vitin kalendarik 2011, nga Komisioni i Pavarur për Media, konsideroj se në përgjithësi raporti e pasqyron gjendjen, në të cilën ky komision ka operuar gjatë vitit paraprak, pa funksionimin e organit vendimmarrës.

Pra, e pasqyron punën e realizuar në nivelin e zyrës ekzekutive për arritjen e objektivave të parapara për vitin 2011.

Shtrohet pyetja, a ka mjaftuar kjo? Në kuadër të objektivave të KPM-së për vitin 2011, janë përmendur përcaktimi i politikës së kalimit të platformës digjitale, të medieve elektronike të Kosovës, pastaj zhvillimi i tregut medial në funksion të të gjithë qytetarëve të Kosovës, si dhe zhvillimi i politikave të transmetimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Çështja është, kur do të përmbushen apo finalizohen objektivat e sipërpërmendura nga vetë Komisioni i Pavarur për Media?

Në raport, në faqen 16, thuhet se Departamenti Ligjor gjatë vitit 2011 ka shqyrtuar raste të ndryshme të subjekteve transmetuese, ofruesve të shërbimeve programore dhe operatorëve kabllorë, për shkelje të dispozitave të Ligjit 02 L-15, për Komisionin e Pavarur për Media dhe transmetimin e akteve tjera nënligjore të KPM-së.

Në raport, ndër të tjera, thuhet se për transmetim ilegal janë përcaktuar 4 raste për shkelje të nenit 11.1 të Ligjit të KPM-së, sipas të cilit për të ushtruar transmetim në Kosovë, sipas kushteve të këtij ligji, kërkohet licenca për transmetim dhe neni 20.5 i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se kushdo që operon pa leje të vlefshme transmetimi, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim.

Ndërkaq, subjekti nuk mund të ankohet te Bordi i Ankesave.

Për njërin nga këto katër raste, thuhet se është një subjekt ilegal transmetues në regjionin e Gjakovës, madje edhe përmendet me emër si rast i mbyllur, me ç'rast BAM-i ka vërtetuar vendimin e Këshillit të KPM-së për konfiskimin e pajisjeve, përderisa tre operatorë ilegalë barten për vitin e ardhshëm.

Shqetësuese janë gjetjet nga monitorimi, sidomos shkeljet e Rregullores për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore. Pothuajse, shkelje të tilla janë gjetur tek të gjitha televizionet. Është vërtet e papranueshme, do të thosha, si shoqëri, shkelja e rregullores në fjalë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve, gati në të gjithë transmetuesit televiziv, përfshirë televizionin nacional dhe atë në regjione, në periudha të ndryshme të monitorimit.

Në raport, gjithashtu janë paraqitur shumë raste për shkeljet e kushteve dhe të termave të përgjithshëm të licencës, siç janë transmetimet pa të drejtë autoriale, mosmbajtja e arkivit, shfrytëzimi i frekuencave pa autorizim të KPM-së, si dhe mospagesa e taksës për licencë.

Të gjitha këto vërejtje të paraqitura tregojnë se në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të KPM-së, ende ka shumë para vetes për të bërë, në mënyrë që përgjithësisht të kemi një ngritje mediale në nivelin e dëshirueshëm, me një mision të qartë, i cili pashmangshëm do të ishte në funksionim të zhvillimit demokratik të shoqërisë sonë edhe në këtë aspekt.

Pra, kërkohet më shumë punë, më shumë përkushtim dhe objektivitet, në këtë rast nga Komisioni i Pavarur për Media, por pse jo edhe nga gjithë aktorët tjerë në këtë veprimtari. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! SLS-ja, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovane kolegice i kolege,

Razmatranje izveštaja o radu nezavisne agencije za medije najbolji je način da se pokaže kako nepostojanje sistema stvarala probleme na terenu. Trebali bi jasno i nedvosmisleno reći, Kosovo nema funkcionalnu nezavisnu agenciju za medije.

Posledica ovog je i potpuno opravdana negativnim ocenama u Progres Reportu Evropske Komisije.

Mi iz SLS-a, svoje učešće u Vladi ne dosvoljavamo kao bezuslovno branjenje svih poteza vladajuće stranke, već privilegije da stvari menjamo nabolje, a kad nastane problem o tome otvoreno razgovarati. Najpre, sebi a onda i građanima, čiji smo prestavnici u ovom domu, moramo reći - Kosovo nije položilo ispit, kada je u pitanju rad nezavisne agencije za medije.

Ma koliko nalazili izgovore o tome da je rad nezavisne agencije za medije opterećen nekom svojom specifičnošću, sistemskim greškama i lošim počecima, moramo da učinimo sve da stvari pomerimo sa ove, rekao bih početne tačke.

Kao poslanik u ovom Parlamentu, naravno da me porazila činjenica da ovaj izveštaj Skupštine na razmatranje, nije uputio savet nezavisne komisije za medije, jer on naprosto, ne postoji.

15.og decembra 2010. godine, dakle pre više od godinu i po dana, istekao je mandat četvoro od sedam članova ovog saveta. Zaista su iluzorni bilo koji pokušaji da se tu nađe opravdanje. Savet nezavisne komisije za medije je najveći organ ove nezavisne institucije. Bez predmetno je sada analizirati dalji rad. Bez saveta nezavisne komisije za medije, ova institucija ne postoji. Za to i izveštaj, koji je pred nama, osim ispunjavanja zakonskih obaveza, samo skup nerešivih problema, na koji ukazuju zaposleni ove institucije.

U ovom telu nema predstavnika srpske zajednice. Dakle, još jednu svoju zakonom zagarantovanu slobodu, pripadnici srpske zajednice ne mogu da ostvare.

Želim da vam jasno kažem, da to što srpska zajednica nije po ovom pitanju jedina, i da isti problem imaju i drugi građani, nije uteha.

To je, što više razlog da se zapitamo, kuda ovo vodi?

Jedini podatak iz izveštaja, a koji se tiče manjina je, citiram: “Monitoring sproveden u periodu od 17-og do 23-čeg juna 2011. godine, pokazuje da i pored povećanja količine programa za manjine sa 12,69% na 13,40%, RTK u pomenutom periodu, nije delovao u potpunosti, u potpunoj saglasnosti sa članom 6., tačka 6., Zakona o RTK.

Dakle, kompletan problem manjinskih prava u oblasti informisanja, sveden je na monitoring od 7 dana i konstatacije da se Zakon o RTK krši, naravno bez pozivanja na odgovornost.

Poštovane kolegice i kolege, SLS će samo iz razloga proceduralnih problema, koje bi izazvalo neusvajanje godišnjeg izveštaja, glasati za njega.

Naš politički uslov, i ono na čemu insistiramo kod naših koalicionih partnera je, da se hitno, u najkraćem mogućem roku, pokrene rad saveta i odgovornih i stručnih ljudi, kako bi konačno počeli da radimo na ovom problemu. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Radha është e deputetëve. Deputetja, zonja Deliu-Kodra e ka fjalën!

BLERTA DELIU-KODRA: Falemnderit, kryesues!

Do të flas në emër të Komisionit për Integritet, pasi kam qenë edhe raportuese e Ligjit për KPM-në.

Sot, kur po e shqyrtojmë Raportin e punës së Komisionit të Pavarur të Medies, është vështirë të flitet për një funksionim të mirëfilltë të këtij komisioni. Sidomos, kur e kemi parasysh faktin se KPM-ja për një vit e gjysmë ka funksionuar pa këshill.

Për ta përmbushur detyrën e vet dhe misionin, për të cilin është thirrur, KPM-ja, para së gjithash, duhet të jetë e plotë në përbërje, në mënyrë që t'i përmbushë edhe obligimet e veta ligjore.

Shqyrtimi i këtij raporti duhet edhe njëherë të na përkujtojë që ne si Kuvend t'i kemi parasysh edhe obligimet që kemi karshi këtij institucioni. Në këtë mënyrë, KPM-ja e ka pas të pamundur që të marrë vendime për rastet që janë proceduar, si dhe për shkeljet e gjetura, e të mos flasim për projekt-rregullore dhe për projekte të rëndësisë nacionale, siç është përfundimi i draft-strategjisë. Sepse, duhet të ketë këshill me fuqi të plotë, për të marrë vendime, për të miratuar edhe draftet e përgatitura dhe për t'i vazhduar tutje në konsultime publike.

Pasi është vetëm këshilli ai që mund të nxjerrë vendime ndaj medieve dhe për mediet, ai duhet të ketë kuorum prej 4 anëtarëve, që të mbajë takime dhe të marrë vendime. Kurse ky këshill, një kohë relativisht të gjatë, ka funksionuar me vetëm dy anëtarë, nga shtatë sa duhej t'i ketë gjithsej.

Vonesat në emërimin e pesë anëtarëve të këtij këshilli janë bërë edhe për shkak se është pritur miratimi i Ligjit të ri për KPM-në. Ligji i ri i KPM-së, i cili ka hyrë në fuqi më 21 prill, parasheh që Komisioni i Pavarur i Medies të përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët do të emërohen nga Kuvendi.

Data 16 maj është përcaktuar si datë, kur edhe pritet të përfundojë emërimi i anëtarëve të ri të KPM-së.

Vonesat në emërimin e anëtarëve të Këshillit do ta prolongojë edhe më tej punën e këtij këshilli, prandaj pasi jam edhe pjesë e Komisionit për Integritet Evropian, dua të them se mosemërimi i anëtarëve të Këshillit të KPM-së ka qenë edhe brengë e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën, i cili i ka bërë thirrje Kuvendit që sa më parë t'i emërojë anëtarët e Këshillit.

Kjo është theksuar edhe në takimin e procesit të dialogut për Stabilizim-Asociim, që është mbajtur javën e kaluar në Bruksel.

Dhe, për fund, dua të them se do ta votoj Raportin e punës së Komisionit të Pavarur të Medies. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim.

Në sallë janë 62 deputetë. Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të punës së Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011! Votojmë tani!

Atëherë me 51 vota “për”, 2 abstenime, 8 “kundër”, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të punës të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011.

Zonja Kadaj-Bujupi e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për shkak se është bërë vonë dhe po shihet që ka rënë koncentrimi, ndërkohë që i kemi edhe 3-4 pika goxha të rëndësishme, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon që kjo seancë sot të përfundojë, e të vazhdojmë nesër.

Dhe, kërkojmë përkrahjen edhe të grupeve tjera parlamentare. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Ky është mocion i një grupi parlamentar. Zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Pajtohem! Është mirë të vazhdohet me koncentrim më të madh, se edhe ashtu sonte nuk kryhen të gjitha ato pika.

KRYESUESI: Në rregull. Zoti Ymeri?

VISAR YMERI: Edhe ne pajtohemi, zoti kryesues. Edhe ashtu në mbledhjen e Kryesisë, pak a shumë e kemi pasur parasysh që kjo seancë do të zgjasë dy ditë, domethënë të

enjten dhe të premten, dhe po shihet se nuk mund ta përfundojmë, kështu që më mirë ta ndërpresim dhe ta shtyjme për nesër.

KRYESUESI: Zoti Reçica?

ELMI REÇICA: Dakordohemi, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Zonja Selmani?

MYZEJENE SELMANI: Pajtohem me shefat e grupeve parlamentare që seanca të shtyhet për ditën e nesërme.

KRYESUESI: Sasha?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!
Mi mislimo da treba da se nastavi sad. Šalim se! Naravno da smo i mi za, da se odloži sa sutra. I mi smo “za”, da se nastavi sutra.

KRYESUESI: Atëherë, votojmë me votim formal, seanca do të vazhdojë nesër, në orën 10:00. Faleminderit!

- - -

(Vazhdimi i seancës plenare, më 11.5.2012, ora 10:30)

(Seancën e kryeson nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Zonja zëvendëskryeministre,
Ministra tjerë..., s’paska,
I vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 10 maj 2012, me pikat e mbetura.

Para të fillojmë pikën e dhjetë, Grupi Parlamentar i PDK-së, respektivisht kryetari i grupit, zoti Grabovci, ka kërkuar një mocion në emër të Grupit Parlamentar. Zoti Grabovci, e keni fjalën!

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, nënkryetar!

Kolegë të nderuar,

Unë e përshëndes unitetin tonë, që po e karakterizon Parlamentin e Kosovës, kur janë në pyetje interesat nacionale. Dhe, vërtet, kjo është për t’u përshëndetur nga të gjithë, sepse kemi dëshirë që të jemi unikë.

Mirëpo, ne si grup parlamentar, vlerësojmë se në seancën e djeshme i kemi nxjerrë dy dokumente për të njëjtën çështje, të votuara dje, edhe nga interpelanca, edhe nga debati, materien e kemi pasur të njëjtë. Tema e debatit ishte për personat e zhdukur dhe kthimi i tyre në Kosovë, apo gjetja e tyre.

Ne mendojmë se kanë dalë dy dokumente për këtë çështje të paharmonizuara me njëra-tjetrën, prandaj i propozojmë seancës që të bëjë harmonizimin e këtyre dy dokumenteve. Pra, dy palë rekomandime, njëra që ka dalë në emër të komisionit, dhe tjetra në emër të Hykmete Bajraktarit.

Prandaj, unë i kisha lutur të gjithë deputetët të bëjmë harmonizimin dhe të dalim me një dokument unik, me një dokument të përbashkët, me qëllim që institucioneve tona t'u mundësojmë të veprojnë si duhet.

Vetvetiu shtrohet pyetja, cili dokument është i vlefshëm, në këtë rast? Ai që është votuar më herët, apo ai që është votuar më vonë? Prandaj, nëse ne jemi dashamirë dhe e kemi me sinqeritetin më të madh, dhe jemi të shqetësuar për fatin e të pagjeturve, dhe duam t'u ndihmojmë atyre familjeve, duhet ta harmonizojmë dhe ta nxjerrim një dokument të përbashkët, që i obligon institucionet përkatëse që vërtet të ndikojnë pozitivisht në gjetjen e këtyre personave. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit!

Tani fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare për t'u prononcuar lidhur me propozimin.

Zoti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, e keni fjalën!

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zotni kryesues!

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, votimi ka përfunduar dje. Çdo gjë ka qenë sipas procedurave. Tani është e kundërta e asaj, që tentohet, ose më mirë të thuhet, kjo që sot po tentohet është shkelje e procedurave.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk dëshiron të jetë pjesë e shkeljeve të rënda, që ky Kuvend mund t'i bëjë me këtë propozim. Të mos harrojmë, rekomandimet kanë qenë këtu në Kuvend plot dy javë, i kanë parë të gjithë, e janë lexuar edhe në fillim, edhe në fund. Nuk është problem i deputetëve të LDK-së që të tjerët nuk e kanë marrë vesh se çka po votojnë. Ky është problem tjetër.

Ne nuk dëshirojmë të bëhemi pjesë e shkeljeve të procedurave nga institucioni më i lartë i vendit, nga institucioni ligjvënës. Andaj, ne nuk do të qëndrojmë në sallë dhe nuk do ta përkrahim këtë mocion. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryesues!

Edhe ne jemi absolutisht kundër kthimit të këtij mocioni përsëri në votim në Kuvend, pasi janë kryer të gjitha procedurat e rregullta për votimin e këtyre dy rekomandimeve.

Po ashtu, është absolutisht e pavërtetë, e madje kisha thënë hiç pa keqardhje, pallavra janë ato që i tha kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

Nëse i lexoni me kujdes pikat e të dy rekomandimeve, shihet që nuk ka asnjë kundërthënie më të vogël dhe të dyja janë të zbatueshme dhe duhet të zbatohen për shkak se janë votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Pra, kjo kërkesë është absolutisht e pabazuar, për shkak se ky nuk na tha asgjë, përveç që dëshirës së tyre për ta kthyer në rivotim këtë mocion, ngase u ka ikur ndonjë pikë.

Unë nuk dua të besoj se në Kuvendin e Republikës së Kosovës ka deputetë të tillë idiotë, të cilët kur i lexojnë katër pika nuk i marrin vesh se çfarë kanë lexuar, edhe pse e kanë pasur rastin t'i lexojnë e t'i kuptojnë këto pika, sepse janë përsëritur disa herë, dhe kemi pasur afat goxha të gjatë kohor për t'i trajtuar të gjitha.

Pra, ato kanë kaluar edhe në komision, një pjesë e tyre, dhe ato që janë diskutuar dhe në interpelancë, në fakt, nëse dëgjohen diskutimet e shumicës së deputetëve, janë pikërisht në përputhje me pikat, të cilat i kemi votuar në fund. Asnjëherë nuk ka qenë ideja, as në mbledhjet e Kryesisë, as në seancë plenare, që këto dy dokumente të harmonizohen, meqenëse janë dy dokumente, që dalin nga dy pjesë të ndryshme të diskutimeve në Kuvend.

I pari që është votuar dhe është nga interpelanca, që u zhvillua dhe, ndërsa i dyti që është votuar dhe është nga debati parlamentar, që ne e kemi kryer javën e kaluar.

Dhe, në këtë drejtim, konsideroj se këto dy dokumente nuk duhet të harmonizohen, për shkak se janë dy dokumente, që dalin nga dy diskutime të ndryshme dhe janë dy dokumente, të cilat nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën në asnjërën prej pikave. Pra, duhen zbatuar si tërësi.

KRYESUESI: Falemnderit! Për replikë, zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Nuk e kam në traditën time, as familjare, e as shoqërore, për ta fyer askënd, aq më tepër kur kemi të bëjmë me një çështje tepër të ndjeshme, që ka të bëjë me fatin e njerëzve dhe familjeve tona.

Mirëpo, atyre që u mungon minimumi i edukatës, normalisht që i fyejnë të tjerët. Por, le të mbetet në ndërgjegjen dhe karakterin e gjithsecilit, veç e veç.

Ju lutem, unë thashë se i kemi dy dokumente. Se a përputhen apo jo, unë nuk hyra në elaborimin e tyre. Ju kisha lutur të gjithë deputetëve, t'i merrni e t'i analizoni një nga një.

Unë nuk po kërkoj as më shumë, as më pak. Por, është një absurditet që të nxirren në të njëjtën seancë, të votohen dy palë dokumente, dhe deputetët, të cilët qenkan shumë të mençur, e votojnë edhe njërin dokument komplet, e votojnë edhe dokumentin tjetër.

Prandaj, këtu është një shpërputhje. Unë nuk po kërkoj as më shumë, as më pak. Parlamenti është unik në votim. Po kërkoj që të dalim me një dokument të përbashkët, dhe ai të jetë i unifikuar. Nga dy dokumentet të dalim me një. I bëjmë, jo 4 pikë, po 10 pika, por të dalim vetëm me një dokument.

Ky është qëllimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

KYMETE BAJRAKTARI: Falemnderit, zoti kryesues!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e kundërshton propozimin e Partisë Parlamentare të PDK-së për shkak se konsiderojmë se dje, të dy dokumentet janë votuar në mënyrë të rregullt, edhe mocioni, edhe rekomandimet e komisionit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar e Koalicionit Kosova e Re, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryesues!

Duke marrë parasysh propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe prononcimet e të gjithë shefave të grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës, duhet të kemi kujdes, meqë këtu bëhet fjalë për njerëz që janë të zhdukur.

Dhe, në rast se ne dëshirojmë të bëjmë politikë në favor të këtyre njerëzve dhe familjarëve të tyre, gjë që është shumë e dhimbshme, unë kërkoj që gabimi që ka ndodhur dje, të votohen dy mocione për një çështje, njëra ka qenë çështja e interpelancës, ndërsa çështja tjetër ka qenë çështja e debatit, të mos përsëritet. Të kemi kujdes të mos i thyejmë zemrat e atyre familjarëve, atyre prindërve, që presin t'i gjejnë mbetjet mortore të familjarëve të tyre, se është shumë e dhimbshme të bëhet politikë me kufomat. Dhe, ato kufoma ende nuk dihet se ku janë.

Kërkoj të gjithë t'i brejë ndërgjegjia, ta nxjerrim një rekomandim të përbashkët të të gjitha grupeve parlamentare, duke marrë parasysh se edhe në interpelancën e djeshme është parë se i gjithë Kuvendi ka qenë për atë që t'u ndihmohet familjarëve për të pagjeturit. Të kemi kujdes! Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! SLS-ja, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Mi smo juče insistirali da se predlog 12 poslanika, koji su tražili jučerašnju mociju uskladi sa predlogom, koji je dala na prethodnoj sednici komisija za ljudska prava, međutim nismo naišli na razumevanje. Ovamo smo supeli da se usklade naši zahtevi sa

preporukama, koje je dala komisija za ljudska prava i za te preporuke smo glasali „za“, za preporuke mocije, koja je juče bila, glasali smo „protiv“. I mi isto smatramo da to treba da su uskladi i da ima jedne preporuke za obe mocije su i prethodna i jučerašnja sednica govorile o nestalim licima. Hvala!

KRYESUESI: Falemnderit! Grupi „6+“, deputeti Damka.

FIKRIM DAMKA: Falemnderit, kryesues!

Edhe Grupi „6+“ e përkrah mocionin e PDK-së, që të harmonizohen këto dy dokumente. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të grupeve parlamentare u deklaruar të gjithë. Më vjen keq, por çështjet janë harmonizuar çdo herë. Megjithatë, unë duhet ta nxjerr në votim!

(Ndërhyrje)

Jo, nuk jeni grup parlamentar.

Më duhet ta nxjerr në votim çështjen!

(Deputetët opozitarë dalin nga salla)

(Ndërprerje nga regjia)

Në rregull, sa deputetë janë në sallë? Atëherë, nuk ka kuorum për t'u votuar mocioni.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë, ose në qoftë se mendoni se duhet të vazhdojnë negociatat, mund ta bëjmë një pauzë prej 10-15 minutash. Zoti Grabovci?

ADEM GRABOVCI: Zoti kryesues,

Ne po e shohim se kemi të bëjmë, vërtet, me një çështje tepër të ndjeshme dhe ky nuk është rasti i parë, që po na ndodh për çështje shumë, shumë të ndjeshme. Opozita e luan këtë rol, që është e drejtë e tyre, por kur kemi të bëjmë me këto raste nuk është e përgjegjshme dhe kjo e dëshmon një papërgjegjshmëri totale.

E kemi pasur edhe rastin e një bojkoti të tillë, që na ka ndodhur edhe gjatë aprovimit të Ligjit mbi bankat, kur ka qenë në pyetje nënshkrimi i marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe fitimi i një ndihme financiare, që u dëshmua e drejtë ajo përpjekje e jona maksimale, që u pasua me nënshkrim të marrëveshjes dhe me fitimin apo derdhjen e mjeteve në buxhetin e Kosovës, që kanë filluar të ndikojnë dhe që do të ndikojnë dukshëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Po ashtu, po ndodh edhe rasti tash, që ne vlerësojmë se është vërtet tepër i ndjeshëm dhe ne kërkojmë, dhe vlerësojmë, dhe jemi të bindur se është në dobi të gjithë atyre familjeve dhe personave të pagjetur, që ta kemi një dokument të unifikuar.

Ne do të bëjmë përpjekje përsëri që ta gjejmë një gjuhë të përbashkët me grupet parlamentare, që ky dokument të unifikohet dhe vërtet të punojmë në të mirën e gjetjes së të zhdukurve.

Prandaj, meqë u krijua kjo situatë, unë kisha propozuar për një pauzë dhe të bëjmë edhe një herë përpjekje për ta gjetur një gjuhë të përbashkët. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Në rregull, atëherë pauzë prej 15 minutave dhe pastaj vazhdojmë! Ju lus që në orën 11:00 të jeni në sallë dhe të mos të vonohemi!

(Vazhdimi i seancës, më 11.5.2012)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Sipas gjendjes së krijuar, pas propozimit të Grupit Parlamentar të PDK-së për t'i rishqyrtuar përfundimet pas debatit ose mocionit të djeshëm, konstatoj se gjendja është e tillë që në sallë të mos kemi deputetë të mjaftueshëm për ta vazhduar seancën.

Besoj dhe shpresoj se grupet parlamentare do të bashkëpunojnë dhe do ta bashkërenditin idenë e harmonizimit lidhur me këtë çështje dhe meqenëse në sallë nuk ka kuorum, sepse janë gjithsej 36 deputetë, propozoj që seanca e ardhshme, ose seanca e sotme të shtyhet për ditën e martë, në orën 10:00.

Ju, kryetarët e grupeve që jeni këtu, besoj se do ta keni parasysh këtë e të komunikoni me të gjitha grupet tjera parlamentare dhe brenda mundësive t'i harmonizoni këto çështje. Faleminderit!

Mirupafshim të martën!

Seanca plenare e vazhdoi punën më 15.5.2012

Kryeson seancën, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI:
Të nderuar deputetë, ju lus t'i zini vendet.
I nderuar zoti kryeministër Hashim Thaçi,
Zëvendëskryeministër,
Ministra,
Deputetë, kolege deputete,

Po fillojmë me vazhdimin e seancës me çështjet që kanë mbetur pa u përfunduar. Dhe, tash për ta vazhduar seancën, duhet të bisedojmë.

Fjalën e ka kërkuar, në emër të Grupit Parlamentar, deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Unë dola këtu të propozoj që debati, që këto ditë ka qenë aktual edhe në medie edhe në Parlament, për fatin e të pagjeturve, të mos politizohet, të mos jetë objekt i përplasjeve midis partive politike, sepse kjo çështje është një çështje thellësisht fundamentale, është çështje shtetërore, të mos jetë objekt i përplasjeve ndërmjet komuniteteve dhe unë propozoj që ne të ndalim këtë debat, nganjëherë debat që më së paku u bën nderë të pagjeturve dhe debat që zgjidh këtë çështje që është një plagë e rëndë e shtetit të Kosovës.

Fati i të pagjeturve dhe zbardhja e tyre është në detyrim shtetëror dhe kushtetues i të gjitha institucioneve të Kosovës dhe të gjitha institucionet e Kosovës duhet t'i përmbushin detyrimet kushtetuese. Dhe, kjo çështje është një brengë dhe detyrim permanent deri sa nuk zgjidhet përfundimisht, është krejtësisht jo korrekte, është krejtësisht shërbim jo i mirë për të pagjeturit në qoftë se ne përplasemi politikisht karshi kësaj plaje të Kosovës.

Në anën tjetër, angazhohem edhe personalisht, por edhe në emër të Grupit Parlamentar që të jemi shumë më vigjilentë rreth proceseve të votimit, sepse ne duhet të kemi një proces jashtëzakonisht të mirë të votimit, në parlamente serioze, në demokracitë parlamentare, proceset e votimit janë procese shumë transparente dhe shumë profesionale dhe angazhohem që udhëheqja e Parlamentit të mos qet në votim gjëra kontradiktore, por t'i studiojë mirë, në mënyrë që mos të bien Parlamentin në një situatë çfarë kemi qenë.

Thjesht, unë angazhohem që ne mos të diskutojmë më për këtë çështje. Kjo çështje mbetet një detyrim shtetëror i Republikës së Kosovës dhe të vazhdojmë seancën pa përplasje dhe angazhohemi që këtë çështje vërtet ta trajtojmë jo me atë se cila parti po bën më shumë e cila më pak, por ta trajtojmë si një detyrë të pazgjidhur të tërë Republikës së Kosovës dhe si një detyrim permanent i të gjitha institucioneve shtetërore dhe që duhet të raportojnë në mënyrë periodike për atë se çfarë kanë bërë, por në një mënyrë që t'i përmbushin detyrimet kushtetuese karshi kësaj krize apo këtij problemi humanitar të pazgjidhur.

Kështu që unë propozoj që ne të vazhdojmë me pikat tjera të seancës, nuk ka procese të kthimit prapa, dhe kisha propozuar që të mos ketë as debate për këtë çështje, sepse të pagjeturit nganjëherë po presin edhe gjëra të pamundshme, e të mos luajmë me fatin e tyre. Fati i tyre është një brengë e të gjithë qytetarëve dhe të gjitha partive të Republikës së Kosovës dhe të vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

KRYESUESI: Falemnderit!

Në sallë janë 88 deputetë.

Zoti Besim Beqaj, në emër të Qeverisë e ka kërkuar fjalën, për një mocion.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë propozoj që si pikë e parë e rendit të ditës le të trajtohet sot – Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Në emër të Qeverisë së Kosovës, dëshirojmë të jemi prezentë gjatë trajtimit të kësaj teme, e cila është e një rëndësie të jashtëzakonshme, prandaj këtë propozim e bëj në emër të Qeverisë, në mënyrë që të gjithë që jemi këtu ta procedojmë një proces, i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të ardhmen energjetike dhe të ardhmen ekonomike të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, jam i obliguar që fillimisht t'i pyes kryetarët e grupeve parlamentare, e pastaj ta qes në votim.

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Grabovci.

ADEM GRAGOVCI: Faleminderit, kryesues!

Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes të cilën e shtroi zoti ministër Beqaj dhe me qëllim që të jetë prezent dhe ta lirojmë për shkak të obligimeve që i ka, ne si Grup Parlamentar, e përkrahim që të futet në rend të ditës si pikë e parë e diskutimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit zoti kryesues!

Ne nuk e përkrahim që në vazhdim të seancës, ky është vazhdim i seancës, të futet pikë tjetër e rendit të ditës.

Po ashtu, janë edhe arsytet tjera që i kemi thënë edhe herën e kaluar për shkak të kualifikimeve, por në atë s'dëshiroj të lëshohem.

Por, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e përkrah që të futet një pikë e rendit të ditës në vazhdim të një seance të mëhershme, çka t'i bjerë në mend dikujt, e aq më shumë të thuhet: - Po e shtimë sa më shpejt...

Po, ministri tjetër punë s'ka, këtë e ka, në mes tjerash, dhe duhet të rrijë në seancë. Ministri është zgjedhur prej këtij Kuvendi, dhe nëse ka ndonjë punë më të mençme se sa të rrijë në Kuvend, le të shkojë, por jo me këtë arsyetim të futet në rend dite diçka që është vazhdimi i seancës, prandaj ne si Grup Parlamentar i LDK-së, nuk e përkrahim të futet në rend dite kjo pikë dhe as të ndryshohet.

(Ndërhyrje)

Shikoni, unë e di që është në rend dite, por të futet në fillim, ne nuk e pranojmë, sepse, le të rri deri në fund. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryesues!

As ne nuk e përkrahim këtë lëvizje të pikës, për shkak se nuk po na duke te arsyeshme. Kemi problem me këtë pikë të rendit të ditës tash e sa seanca, dhe kjo që do ta diskutojmë në fund sot, po qe se nuk ndryshohet rendi i ditës, ka hyrë në këtë seancë, duke pasur parasysh se ky është vazhdim i seancës dhe ka hyrë në këtë seancë në mënyrë të përsheptuar dhe tash po kërkohet edhe t’i ndryshohet vendi, pra pa kurrfarë arsye. Dhe ne konsiderojmë që duhet ta vendosim një rregull që për një rend të miratuar të ditës t’i përmbahemi atij rendi të ditës, e jo kështu që sa herë e kujt t’i teket, në çdo moment të seancës, të propozojë mocione për ndryshim të rendit të ditës me futje a nxjerrje të pikave, e kështu me radhë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se shumica e asaj që duhet të thuhet, u tha. Janë çështje të cilat vijnë në seancë plenare Ad-hoc dhe duhet thënë këtu se nuk është opozita ajo e cila po e shndërron Kuvendin në një vend ku njerëzit ulen dhe e ngrisin dorën pa ditur se çka po ndodhë.

Mendoj se këto politika kësisoj, me tërheqje dhe me futje në rend të ditës me procedura të shpejtuara, nuk duhet të ndodhin në Kuvendin e Kosovës për shkak se autoriteti i këtij institucioni po degradohet vazhdimisht dhe mendoj se është tepër e qartë që Qeveria dhe partitë në pushtet po e bëjnë një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kabinetin qeveritar dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh se kjo është vazhdimësi e seancës së kaluar dhe në seancën e kaluar ne e patëm vendosur në rend dite, dhe se a do të jetë pikë e parë a e fundit, nuk është me rëndësi, por të votohet.

Mirëpo, prapëseprapë mendimi i ministrit, për arsye që të jetë prezent gjatë kohës së shqyrtimit të vendimit, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, kryetari i Grupit Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!
I Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke se slaže sa ministrom da ova tačka bude prva na dnevnom redu.

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, nënkryetar!
Edhe Grupi Parlamentar 6+ e sheh si të arsyeshme kërkesën e ministrit dhe është që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet si pikë e parë në seancë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në sallë janë 90 deputetë. Tash e vë në votim këtë... Zoti Beqiri, a e doni fjalën?
Atëherë, urdhëroni!

ISMET BEQIRI: Kërkoj ndjesë që, edhe një herë po e marr fjalën. E kisha ndërmend të them që edhe herën e kaluar, zoti nënkryetar, e dimë të gjithë se kjo pikë ka hyrë me mocion dhe sinqerisht me mocion përsëri bëhet ose tentimi për t'u zhvendosur dhe ne po dëshirojmë ta ruajmë gjithë nivelin e këtij Kuvendi dhe jo çdoherë të bëhen me mocione të bëhen edhe zhvendosje e futje të pikave të rendit të ditës.

Ju dhe të gjithë e dimë se nëse vendoset, si do që të vendosë Kuvendi, ne pastaj kemi për të thënë pse janë arsyet dhe s'do të duhej të votohej, por kjo vjen më vonë.

Prandaj, çdoherë për një pikë nga dy-tri herë bëhen mocione, dhe vërtet është kjo jo serioze. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Unë jam i obliguar që ta vë në votim dhe ta respektoj votën. Prandaj, e hedh në votim propozimin e Qeverisë lidhur me heqjen nga pika e 15-të e rendit të ditës, që ka qenë në seancën e kaluar, dhe të radhitet si pikë e parë e seancës së sotme. Do të thotë, sipas renditjes është pika 9 që e kemi pasur në seancën e kaluar.

Pra, e hedh në votim këtë propozim dhe regjia e deputetët le të bëhen gati për votim dhe votojmë tash.

Falemnderit! Konstatoj se me 47 vota - me elektronikë, 1 pa kartelë, 48 vota për; 31 votë kundër - me elektronikë, 2 pa kartelë, 33; dhe 1 abstenim, Kuvendi vendosi që të zhvendoset pika 15 e rendit të ditës dhe të jetë si pikë e parë vazhduese në këtë seancë.

Atëherë, po vazhdojmë:

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të plotësuar më 7 maj 2012 për

emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Zenun Pajaziti, ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Pajaziti, e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, ministra,

Me në fund dëshiroj po ashtu edhe të sqaroj si kryetar i Komisionit, me vetë faktin që në seancën që jemi ose në seancën e kaluar, kërkoja që të futet në rend dite, e nuk ka asnjë shkelje, është procedurë normale, ne në komision e kemi kaluar. Për më tepër, nuk ka qenë vullneti më herët që edhe deputetët edhe anëtarët të Kuvendit të mos e kalojnë këtë pikë.

Dëshiroj të shfrytëzoj rastin po ashtu të falënderoj edhe Qeverinë, pasi që në propozimin e parë nuk kishte vullnet të mirë edhe nga ana e Komisionit për zhvillim që të aprovohej propozimi i Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Falënderoj pasi që ka reflektuar dhe ka bërë ndryshimin e listës, rrjedhimisht Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri në mbledhjen e radhës e ka trajtuar.

Jemi munduar që me kohë pasi është një vonesë goxha e gjatë e mosfunksionimit të këtij bordi për mungesë anëtarësh dhe rrjedhimisht propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 8 shkurt 2012, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, Komisioni ka vendosur me shumicë votash që Kuvendit t’ia paraqesë rekomandimin, që të miratohet propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 3/73 të datës 7.5.2012 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 8, lidhur me të propozuarit për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, zotin Krenar Bujupi dhe zonjën Merita Kostari dhe për kryesues zotin Enver Halimin.

Unë i ftoj të gjithë grupet parlamentare – deputetët që ta mbështesin këtë propozim të Qeverisë dhe rrjedhimisht ky bord të fillojë të funksionojë, sepse para veti e presin detyra të rëndësishme dhe po ashtu vonesat kanë qenë siç e përsërita goxha të gjata. Falemnderit, shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, a e dëshiron fjalën? Urdhëroni, zoti Besim Beqaj!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Falemnderit, kryesues!

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Para veti e kemi një propozim të Qeverisë, i cili është diskutuar dhe ka marrë edhe votimin e Komisionit parlamentar.

Realisht, e kemi një grup profesionistësh, dy përfaqësues të cilët janë të natyrës profesionale, njëri është i natyrës dhe ka përvojë të gjatë në fushën e energjetikës, ndërsa përfaqësuesja tjetër, gjithashtu është një juriste e cila e ka marrë një përvojë më herët edhe në vetë themelimin e Zyrës së Rregullatorit dhe Rregullatorit në tërësi, me përvojë, e cila gjithashtu mund t'i kontribuojë në mënyrë shumë profesionale funksionimit dhe rregullshmërisë së rregullimit të këtij sektori.

Personi i cili është propozuar për kryesues të këtij bordi, zoti Enver Halimi, është më herët i zgjedhur anëtar dhe në cilësinë e anëtarit të mëparshëm, do të thotë, propozimi është që ai të ngrihet në nivelin e kryesuesit.

Me këtë vendim të sotëm, me këtë votim tuajin të sotëm, ne do të mundësojmë që projektet energjetike të ecin përpara. E kemi një periudhë relativisht të gjatë, kemi projekte të rëndësishme energjetike të cilat duhet të ecin përpara, prandaj edhe propozimi të cilin e keni para vetes është profesional dhe njerëzit të cilët janë këtu kanë kompetencë edhe profesionale edhe njerëzore, respektivisht personi i cili është propozuar për kryesues është person që ka kredibilitet brendapërbrenda këtij rregullatori, prandaj ne presim që ky rregullator të funksionalizohet sa më shpejt dhe të procedojmë me procedura të cilat janë të parapara në fushën e përcaktimit të rregullativës energjetike, në fushën e rregullimit të tregut, në fushën e reformës energjetike dhe njëkohësisht edhe në fushën e mbrojtjes së interesit të konsumatorëve, sepse rregullatori është ai i cili përcakton rregullat për funksionim të operatorëve dhe përcakton rregullat edhe të tarifave dhe përcakton rregullat tjera.

Prandaj, votimi i sotëm, është i një natyre jashtëzakonisht të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe për mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e projekteve energjetike që Qeveria dhe shteti i ka para vetes. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë radhën. Në emër të PDK-së, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Falemnderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar me vëmendje propozimin e parë që ka ardhur nga Qeveria, por edhe propozimin e dytë.

Në këtë rast, më lejoni të falënderoj Qeverinë e Kosovës e cila i ka marrë sugjerimet e Grave deputete të Partisë Demokratike të Kosovës, që ka qenë se në qoftë se në konkurrencë, në kushte të barabarta, ka konkurruar një grua që të jetë pjesë e këtij bordi dhe këtë sugjerim e ka marrë parasysh, prandaj e meriton një falënderim të veçantë dhe

shpresoj e besoj se 40 gra që janë pjesë e këtij Parlamenti, do ta votojnë edhe për një arsye shumë të fortë, sepse pjesë e këtij bordi dhe këtij propozimi është një emër i një gruaje që është profesioniste dhe do të shkojë në vend misioni dhe qëllimi i këtij Grupi që është themeluar në Parlamentin e Kosovës. Ju ftoj për votim. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari i Grupit, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zotni kryesues!

Ne edhe më herët, edhe pse është bërë një ndryshim i vogël, konsiderojmë përsëri që të propozuarit nuk i plotësojnë kriteret, për çfarë kërkohet në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë Elektrike.

Ajo që mund të them me përgjegjësi, është se ajo zyrë po mbushet ose po plotësohet me njerëz, që s'janë të profesionit. Me gjithë respektin ndaj atyre, që i kanë kualifikimet çfarë i kanë, por s'i kanë të natyrës çfarë kërkohet. Dhe, pa dashur të lidhëm në diskutimet paraprake, nëse kriteri parashihet femër e veç duhet të jetë femër, se është femër, pavarësisht a i plotëson kriteret, kjo nuk është ndonjë arsyetim.

Konsiderojmë me përgjegjësi të plotë, që aty po mbushet me militantë partiakë dhe kemi argumente edhe për këtë që po e themi. Dhe, ne si Grup Parlamentar i LDK-së, nga arsyet se nuk i plotësojnë kriteret, kushtet, profesionalizmin dhe nuk do të ndikojnë në ngritjen e punës, në këtë zyre, ne nuk do t'i votojmë, gjegjësisht, do të votojmë kundër këtyre propozimeve.

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar, zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Falemnderit, kryesues!

Së pari, mendoj që kjo mënyrë e trajtimit dhe të votimit për çështje të tilla është e gabuar, meqenëse po kërkohet ta votojmë një listë emrash, të cilët nuk janë të njëjtë, por, nuk janë këta njerëz të njëjtë. Dhe, rrjedhimisht ne po duhet ta vendosim votën tonë karshi disa njerëzve, të cilët janë të ndryshëm dhe të cilët i shikojmë ndryshe, si në aspektin profesional, po ashtu, edhe në atë etik e të përvojës e kështu me radhë.

Së dyti, konsideroj që kjo listë përmban disa emra, të cilët janë shumë problematik. Veçanërisht po e përmend këtu Krenar Bujupin, i cili edhe nuk e ka përvojën e mjaftueshme të punës në sektor, pra që kërkohen 10 vjet përvojë pune në sektor dhe është aktualisht, i punësuar në Bankën Botërore, në çështje të energjisë, që e shkakton edhe një lloj konflikti interesi të zgjedhjes së tij si anëtar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Po ashtu, me këtë emrin e ri, i cili i është shtuar kësaj liste, Merita, ajo shihet që e ka njëlloj përvojë pune edhe në ZRRE edhe kështu me radhë, por megjithatë nuk e përmbush, ose të paktën nuk i kemi informatat e mjaftueshme, për ta vlerësuar nëse ajo vërtetë është e denjë për një post të tillë kaq të rëndësishëm.

Për të folur për rëndësinë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, mendoj se është e tepërt, por vetëm kisha dashur të shtoj një fjalë që projektet energjetike të Qeverisë, të cilat bazohen kryekëput në kapitalin privat, sikur në gjenerim, po ashtu edhe në shpërndarje, e bëjnë këtë zyrë edhe më të rëndësishme se sa që ka qenë deri tash.

Dhe, rrjedhimisht domethënë, ne duhet të jemi edhe më të kujdesshëm se sa që kemi qenë deri tash, për sa i përket anëtarëve të Bordit që i përzgjedhim me këtë.

Dhe për fund, mënyra se si po kërkohet nga deputetët, që të votojnë për listë emrash me CV, domethënë, me punën e tyre, me përvojën e tyre, pa e pasur të paktën edhe një letër shpjeguese, se çka mendojnë ata të bëjnë si anëtarë të ZRRE-së, konsideroj po ashtu mënyrë shumë e gabueshme e të votuarit, për shkak se votimi në Kuvend, ata i bën anëtarë të Bordit automatikisht, që i bie që votimi në Kuvend është një lloj punësimi i këtyre personave. E kur personi aplikon për punë, duhet edhe të shpjegojë çka e ka ndërmend të bëjë me atë post pune e jo vetëm të thotë- këqyre unë sa shkolla i kam kryer, se kjo nuk mjafton.

Pra, ne duhet ta dimë se çka e kanë ndërmend këta me bë me ZRRE-në, si do të ballafaqohen këta me sfidat që paraqiten në ZRRE, si do t'i trajtojnë këta çështjet kryesore të ZRRE-së? Nuk kemi kurrfarë informate për këtë gjë.

Rrjedhimisht, Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje”, konsideron që kjo listë emrash, jo të gjithë po flas, por meqenëse na është paraqitur si listë, atëherë nuk mund ta votojmë “për”, për shkak të këtyre arsyeve, që i përmenda. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Ne si grup parlamentar i shohim dy çështje.

Çështja e parë, është drejtpërdrejt e ndërlidhur me mënyrën se si ka hyrë në seancë kjo pikë, neve na tregon se arsyet pse nuk ka ardhur deri më tani, kanë qenë se nuk ka pas pajtim politik brendapërbrenda Qeverisë për këta emra. Dhe, në momentin që ka ndodhur pajtimi politik, ka ardhur, është futur në seancë dhe tani votohet, që do të thotë se nëse për një çështje, për të cilën po thonë se është krejt profesionale, ka pasur nevojë për pajtim politik, do të thotë ka pasur konflikt serioz politik, derisa kanë ardhur deri te emrat, ky bord është politik.

Ka pasur marrëveshje politike për të ardhur deri te këta emra dhe ky është aspekti i parë. Aspekti i dytë është prapë ai aspekt, për të cilin u fol pak. Çka do të bëjë bordi? Përderisa Qeveria fshehët prapa bordit, qoftë për ngritje të çmimit të energjisë, qoftë për vendimet të cilat i merr dhe e quan bordin si bord të pavarur e në të njëjtën kohë bëhet luftë politike për t' i futur njerëzit në bord, që do të thotë se Qeveria qëndron prapa bordit dhe cilado vendime që do t' i merr ky bord dhe ne po supozojmë me keqardhje, se ndër vendimet e para do të jetë ngritja e çmimit të energjisë, Qeveria qëndron prapa.

Pra, Qeveria e Kosovës e emëron këtë bord me një mision, të cilin ia ka dhënë vetë. Nuk e bën bordi misionin e vetë. Nuk janë këta njerëz, domethënë, në njëfarë forme indirekt të themi, nuk janë këta njerëz, të cilët e dinë se çka kanë për të bërë në bord. Qeveria e di se çka kanë me bë këta edhe i zgjedh njerëzit, të cilët kanë për t'i ndjekur politikën dhe vendimet e Qeverisë në bord, që do të thotë se qytetarët e Kosovës duhet të përgatiten, që të rrjepën edhe pak më shumë, shumë shpejtë, për shkak se duhet diqysh të ndalën subvencionet për KEK, duhet të dënohen ata qytetarë që paguajnë energji dhe duhet prapë me të vazhdojnë të subvencionohen ata që nuk paguajnë.

Ky është misioni, besojmë ne dhe duke e ditë këtë mision, nuk jemi të gatshëm që ta votojmë këtë bord, pavarësisht se kush janë njerëzit. Falemnderit!

KRYESUESI: Kryetarja e Koalicionit Kosova e Re, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh se Qeveria ka sjell edhe një vendim të mëparshëm, i cili ka ra në Komisionin Parlamentar dhe është një vendim i dytë i Qeverisë, plotësim- ndryshim, këtu është fatbardhësi që është ministri dhe kërkoj nga ministri, që në bordet, siç është Zyra e Rregullatorit, ka edhe borde tjera, për të cilat ministri Beqaj është përgjegjës.

Është një ndryshim prej qeverive të kaluara që ministri nuk është në bordet e rëndësishme, mirëpo janë njerëzit profesional. Kërkoj që bordet të plotësohen në afate të parapara e jo me vonesë, se tash jemi përpara një akti të kryer. Të gjitha projektet energjetike, e potencove edhe vetë ministër, që kanë mbetur peng i mos kompletimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Dhe, çka do të ndodhë? Deri më tani e kemi parë në sektorin e energjisë, po, çka do të ndodhë në të ardhmen, atëherë do të mbetet përgjegjësi edhe juaja edhe e këtij Kuvendi, që Kosova të mos përballet, prapëseprapë me reduktime të energjisë dhe me subvencione, qysh u fol nga parafolësi, për arsye se e gjithë barra bie mbi jetën e qytetarit.

Koalicioni për Kosovë të Re edhe njëherë po them, që do të përkrahë për arsye të mungesës së projekteve, të cilat kanë ngelë shkaku i vendimit të ZRRE-së. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, zonja Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna Grupa Samostalne Liberalne Stranke, je takođe razmotrila predloge Vlade i kandidate, koje Vlada predlaže. U ime svoje grupe, želimo da istaknemo da možda jeste ispoštovana polna ravnopravnost ali bojimo se da nije ispoštovan kod multietničnosti, jer u ovom bordu kao i u svakom drugom bordu, nema predstavnika iz manjinske zajednice.

Ovom prilikom apelujem na Vladu da sledeći put, kada predlaže kandidate za bilo koji bord, ima u vidu da ima i dovoljno dobrih profesionalnih i kompetentnih ljudi i iz manjinske zajednice, koji bi mogli da budu članovi bilo kog borda.

Danas ćemo podržati predlog vlade, ali još jednom apelujem na predstavnike Vlade da imaju u vidu kod multietničnosti. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zoti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuar nënkryetar, Kabinet Qeveritar, Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë raport me rekomandim, lidhur me emërimin e anëtarëve të bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Arsyetimin e nevojshëm e paraqiti edhe zoti Ministër edhe kryetari i Komisionit dhe Grupi Parlamentar “6+” do të votojë për këta emra të anëtarëve të bordit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Berisha-Shala e ka kërkuar fjalën, si deputete tani.

SALA BERISHA-SHALA: Falemnderit, nënkryetar!

Unë konsideroj që është dashur ta marrë fjalën pas prononcimeve të shefave të grupeve parlamentare dhe desha t’ia kujtoj zotit Ismet Beqiri, si shef i Grupit Parlamentar të LDK-së, se a mos po tingëllon pak si fyerje arsyetimi, pse duhet të jetë apo s’duhet të jetë një grua pjesë e bordit? Sepse, kjo i plotëson kriteret e kërkuara me ligj edhe dua t’ia përkujtoj se zonja Merita Kostari ka qenë pjesë e bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji nga 1 janari i vitit 2004, deri më 20 maj 2007, domethënë, kur kanë qenë në koalicion qeverisës Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e para.

E dyta, nuk është një tjetër shef i Grupit Parlamentar nga “Vetëvendosje” tha se kërkoj t’ia bashkëngjis një letër përcjellëse këta kandidatët e propozuar. Unë ia përkujtoj zotit Visar Ymeri, le ta analizojë mirë ligjin, se ligji i ka të përcaktuara shumë mirë dhe në ligj kërkojnë kriteret profesionale, nuk ka as kritere etnie e as kritere gjinie.

Unë edhe një herë po dua ta përshëndes Qeverinë e Kosovës, që në kushte të barabarta të kriterëve profesionale, e ka propozuar një grua për anëtare të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

E kam një kërkesë shumë të veçantë për Grupin e Grave në Parlamentin e Kosovës, le ta tregojnë veten tani, le ta votojnë këtë propozim dhe mos t’i përfillin qëndrimet e shefave të tyre. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryesues!

Sinqerisht, mos të ishte kjo këtu të na i përkujtoj këto gjëra, ne s’di çka kishim bërë si deputetë dhe falemnderit prej Perëndisë, që e ka dërguar dhe na përkujton, e para.

E dyta, unë nuk fola vetëm për gjini, fola konkretisht, a i plotëson kriteret në kuptimin profesional? Ka edhe plotë femra tjera që e meritojnë, pa dilemë të jenë pjesë e këtij bordi, po sigurisht ose kësaj zyre, po sigurisht duhet të jetë q anëtare e PDK-së. Mos harroni nëse flisni për profesionalizëm dhe na rikujtoi edhe çështjen e koalicioneve, ju këtu e keni pasur një njeri shumë profesional, por nuk është PDK dhe e keni hequr. Siç është zoti Hamiti, për shembull, Ali Hamiti. Nëse flasim për profesionalizëm, e keni hequr, sepse s'është në PDK. Është shumë normale.

Ndërkaq, te gjinia femërore, thashë edhe një herë, ka përplot sigurisht candidate, që i plotësojnë kushtet. Kjo mund të jetë e zonja, është juriste, por përsëri konsiderojmë, që nuk janë plotësuar kriteret e nevojshme dhe për këtë edhe nuk e votojmë. Po, falemnderit Salës që po na i përkujton këto!

KRYESUESI: Falemnderit! Visar Ymeri ka kërkuar fjalën për kundër-replikë.

VISAR YMERY: Falemnderit, kryesues!

Shumë shkurt. Edhe unë desha vetëm, jo të përgjigjem, por të reagoj ndaj asaj që tha zonja Sala-Berisha, po ia përmend emrin, që ta ketë rastin të flas prapë.

Po shihet që kemi ende deputetë këtu në Kuvend, që nuk kuptojnë, pra sikur herën e kaluar, nuk të marrin vesh çka ke thënë. Unë kur thashë me letër ose me shpjegim ose gojarisht të vijmë në komision të na tregojnë se çka kanë ndërmend të bëjnë, nuk mendova të na tregojnë çfarë gjinie janë edhe çfarë etnie janë, po të na tregojnë se çka e kanë ndërmend të bëjnë me postin e tyre që po e lypin. Se, kjo është një kërkesë e tyre, apo jo, një kërkesë edhe nga Qeveria, që ne t'ia votojmë disa anëtarë të bordit, po edhe kërkesë e tyre, që ata të punësohen si anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit.

E atëherë, meqenëse po kërkojnë, duhet të na tregojnë se çka e kanë ndërmend të bëjë ata? Pse ata e jo do tjerë? Kjo është pyetja. Kjo është shumë legjitime dhe mendoj që ne si deputetë duhet me e ditë.

Mua shumë po më brengos, qysh disa deputetëve nuk i intereson kjo pyetje fare. Pra kjo po lidhet pak me atë që e tha zoti Gjini, që në fakt ka tjetërkush që e di se çka kanë për të bërë këta dhe rrjedhimisht prej tyre nuk pritet as ta dinë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Teuta Sahatqija e ka kërkuar fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar!

Së pari po më vjen mirë që çështja gjinore është aktualizuar dhe është rritur ndjeshmëria dhe po më vjen mirë që zonja Sala e ka ngritur vetëdijen për çështjen gjinore, shpresoj që kjo do të vazhdojë edhe në çështje tjera.

Në rend të parë më vjen mirë, që propozimi ka femër dhe shpresoj që Qeveria edhe në raste tjera do të sjellë emrat në borde, ku do të ketë gra të zonja, të profesionit. Po, nuk ishte arsyeja pse grupi ynë parlamentar dhe grupet tjera parlamentare, propozimin për këta që e shqyrtuam, për listën nuk ishte çështja gjinore, por ishte çështja se të dy të

propozuar kanë konflikt interesi, njëri punon në Bankën Botërore, tjetra punon në KOST, të cilat automatikisht kanë konflikt interesi bashkë, në qoftë se punësohen në ZRRE. Kjo ishte arsyeja për grupin tim parlamentar.

Ndërsa, për Grupin e Grave, mendoj që duhet të kërkojmë përsëri të ketë sa më shumë gra në borde, por është mirë që kjo çështje të diskutohet në Grupin e grave deputete, para se të dalim këtu dhe të flasim në emër të bordit. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Berisha-Shala, replikë.

SALA BERISHA-SHALA: Nuk janë as zonja Sahatqija e as zoti Ymeri ata që i vlerësojnë këtu deputetët, a janë idiotë, a janë të vetëdijshtë, a s'janë, a janë të pavetëdijshtë. Këtu jemi secili me një besim të qytetarëve dhe ashtu vetëm e degradoni vetveten dhe nuk kisha pasur qejf kurrë të kem punë me asi njerëz që e kanë veten shumë në qejf, po këtu po dua t'i tregoj zonjës Sahatqija se shpesh je fshehur me politika tua të mbrapshta rreth avancimit të gruas dhe sot e ke rastin për ta treguar veten, a je vërtet për të avancuar gra në pozita vendimmarrëse apo jo? Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Kundër- replikë, zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, zoti kryesues!

Ato fjalët, që s'ma qet goja, se nuk është ne edukatën time, ato fjalë që i përmende as s'e kam mendjen t' i përsërit, është mirë për t'u përmbajtur edhe mos të përdorën as në familje, e lëre më para deputetëve, e lëre më para njerëzve, të cilët na ndjekin.

Ato politikat e mia të mbara, jo të mbrapshta, janë të njohura shumë më herët, nuk ka nevojë tash të them dhe po ju përkujtoj, unë e përgëzoja, që ka gra dhe kërkoja që të ketë përsëri gra.

E politikat e mia janë politika të mbara, në asnjë mënyrë të mbrapshta. Dhe, ato fjalë tjera, të cilat i përdori, janë fjalë, të cilat unë kurrë nuk i përdori, se në edukatën time nuk ekzistojnë.

KRYESUESI: Falemnderit! Nuk ka tjerë të paraqitur!

Vazhdojmë me votimin e propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Në mbledhje janë të pranishëm 95 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tani!

Falemnderit! Pa kartelë “për”? Dy pa kartelë “kundër” janë.

46 vota “për”, 2 abstenime, 38 vota me elektronikë + 2 pa kartelë, 40 vota “kundër”.

Konstatoj që Kuvendi emëroi Enver Halilin, kryesues, si dhe Krenar Bujupin e Merita Kostari, anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Falemnderit!

Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës sipas radhës:

12. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011

Raportin e punës së Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2011, e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2011 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional ose Armendin, si zëvendës për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë kundër Korrupsionit për vitin 2011. Raporti i punës është debatuar gjerësisht dhe është trajtuar me vëmendje të veçantë nga anëtarët e Komisionit, të cilët i kanë dhënë mendimet e veta, si për përmbajtjen, ashtu edhe për strukturën e raportit.

Po ashtu, është kërkuar edhe nga drejtori i Agjencisë, që të ketë fokus më të madh në aspekte të veçanta, si dhe të rritet rezultati i punës, duke marrë në konsideratë, në mënyrë specifike, çështjet e hetimit dhe gjykimit të rasteve, deri në përmbylljen e rasteve nga gjykatat kompetente, që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit.

Komisioni i ka dhënë përkrahje në parim. Deputetët duhet të japin kontributin e vetë sipas arsyeve dhe përmbajtjes së raportit. Falemnderit shumë!

KRYESUESI: Falemnderit! Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare dhe të raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Kjo Agjenci Kundër Korrupsionit ka pasur të ndarë me buxhet 534 mijë e 351 euro, ku nga këto mjete janë shpenzuar vetëm 348.984 euro, çka domethënë se Agjencia Kundër Korrupsionit ka shpenzuar diku 65% të mjeteve, të cilat i ka pasur në shfrytëzim.

Për paga dhe mëditje ka shfrytëzuar 47% të mjeteve, kurse shpenzimet kapitale ku është paraparë blerja e pajisjeve të teknologjisë informative, nuk ka shpenzuar asnjë mjet, domethënë mjetet kanë mbetur të pashpenzuara. Komisioni për Buxhet i ka diskutuar të gjitha këto çështje me përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe pasi që ka marrë përgjigjet nga kjo agjenci për arsyeshmërinë e mosshfrytëzimit të mjeteve ashtu siç janë planifikuar, e ka përkrahur në parim këtë raport dhe ka rekomanduar që të miratohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësues të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Ne sot po shqyrtojmë një raport që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit dhe me punën e një agjencie që është themeluar pikërisht për të luftuar korrupsionin dhe dukuritë e tilla të ngjashme.

Mirëpo, unë mendoj se ne duhet ta diskutojmë dhe ta analizojmë më në bazë se çka është kjo farë lloj agjencie dhe sa po jep produkt pozitiv në interes të qytetarëve të Kosovës dhe në interes të funksionimit dhe sundimit të shtetit ligjor? Mendoj se realisht ka probleme, sepse shpesh kjo agjenci si rezultat i mungesave profesionale dhe i kapaciteteve ligjore, nuk ka mundësi të kryejë punën e luftës kundër korrupsionit dhe vetë fjala si e tillë “luftë kundër korrupsionit” është një fjalë që realisht thotë shumë, po në të njëjtën kohë nuk jep përgjegjësi për veprim shumë për agjencinë.

Puna kryesore që e bën dhe me të cilën merret kjo agjenci është këqyrja e formularëve të deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë shtetëror dhe këqyrja e mospërputhjes së mundshme në formularët e deklarimit. Po ashtu, merret me trajtimin e informacioneve që herë pas here mund të dërgojë dikush në agjenci për dyshime lidhur me afëra korruptive dhe këtu lind tërë problemi. Sepse, ne kemi një sistem juridik i cili është i ndërtuar si i tillë: me gjykata, prokurori, polici hetuese dhe çfarë lloj kapacitetesh ka kjo agjenci që të merret me hetime, sa mund të merret me hetime?

Pra, a i ka kapacitetet ligjore për t’u marrë me këto lloj hetimesh, apo duhet të mendojmë si shoqëri se duhet të kemi adresë të qartë për luftën kundër korrupsionit? Dhe, adresa e qartë për mendimin tim janë institucionet e shtetit që janë të thirrura për hetim dhe përndjekje të veprave penale. Dhe, në këtë rast- hetim dhe përndjekje të veprave penale janë policia dhe prokuroria e shtetit, sepse, në fund të fundit, edhe gjitha hetimet që i bën agjencia tash të ashtuquajtura “hetime”, sepse unë jam i bindur që kapacitetet profesionale dhe ligjore të agjencisë janë të limituara, jo vetëm te agjencia jonë, por çdo agjenci e tillë që është në vendet në tranzicion, kryesisht ka kapacitete të limituara që të merret me hetim dhe përndjekje.

Dhe, shpesh këto agjenci kthehen në instrument për mbulimin e këtyre dukurive, sepse e merr, e heton, si rezultat i mungesës së kapaciteteve për hetim, e mbyll rastin edhe thotë: “nuk ka”, ose e çon për përndjekje, si rezultat i thashethemeve që mund të dëgjohen nëpër qytet. Prandaj, mendoj se këtu duhet të jemi më të qartë dhe si shoqëri duhet të

fillojmë të mendojmë se çka do të bëjmë me këtë agjenci. Dhe, duhet të fillojmë të mendojmë që të kemi adresë të saktë për luftën kundër korrupsionit. E adresa e saktë për luftën kundër korrupsionit dhe dukurive tjera që kanë të bëjnë me praktikën e abuzimit me paranë publike duhet të jenë Policia dhe Prokuroria e shtetit, sepse kanë kapacitete, edhe të hetimit, edhe të përgjimit, edhe të arrestimit, edhe të përndjekjes, edhe të bllokimit. Të gjitha këto elemente i kanë në dorë Prokuroria dhe Policia. Agjencia nuk ka asnjë lloj instrumenti, mbi bazën e të cilit mund ta bëjë një hetim, një përgjim, një përndjekje dhe, në fund, edhe arrestim nëse është e nevojshme. Këto nuk janë kompetencë e agjencisë, agjencia thjesht merret me një informatë, heton nëse mund të mbledhë informata tjera në aspektin spekulativ. Nuk e kam në kuptimin negativ spekulativ, po thashethemet që mund të dëgjohen ose denoncime anonime që mund t'i bëjë dikush dhe ato pastaj t'i drejtojmë në Prokurori.

Nëse e analizojmë raportin, shumica e denoncimeve që agjencia i ka dërguar në Prokurori, ajo ka konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme për ta filluar ndjekjen penale. Prandaj, ne jemi këtu në një moment kur e kemi një perceptim shumë të lartë për korrupsionin në Kosovë dhe e kemi një agjenci e cila e ka emrin Agjencia për Luftën Kundër Korrupsionit, por realisht produkti i kësaj agjencie dhe produkti i këtij sistemi është shumë i vogël. Ne duhet ta kemi një vizion të qartë si shoqëri, çfarë duam të bëjmë, si përfaqësues të shtetit, me këtë dukuri. Dhe, unë mendoj se ne duhet ta adresojmë qartë te institucionet përkatëse luftën kundër korrupsionit dhe institucion përkatës për luftën kundër korrupsionit është Institucioni i hetimit, Institucioni i përndjekjes dhe Institucioni i gjykimit. Hetim, përndjekje, gjykim mund të bëjnë; hetim Policia, po ashtu edhe Prokuroria përndjekje, dhe gjykim gjykatat, e jo një institucion i cili realisht nuk i ka këto kapacitete, dhe unë mendoj, kam bindje personale si rezultat i raportit se si kjo agjenci e ka problem funksional të arrijë ta realizojë këtë objektiv. Është e pamundur ta realizojë këtë objektiv, sepse nuk i ka kapacitetet. Nuk mundet ta përgjojë dikë, nuk mund ta marrë dikë nën masat të përkohshme të ndalimit, të arrestimit; nuk mund ta detyrojë dikë të raportojë, prandaj duhet t'i shohim vendet në zhvillim qysh e kanë, ose vendet e zhvilluara.

Vendet e zhvilluara e kanë agjencinë ose institutin e lartë për deklarimin dhe kontrollin e pasurive. Dhe ai merret me anën teknike. Kontrollon nëse ka mospërputhje në deklarimin e pasurive, kontrollon nëse dikujt i është rritur shumë pasuria, e si rezultat i rritjes së pasurisë e kontrollon nëse kanë bazë ligjore këto të hyra, e pastaj dhe nëse ka mospërputhje shkon dhe i denoncon në Prokurori. Prokuroria e fillon hetimin profesional dhe në bazë të hetimit profesional, në kuptimin edhe të kapaciteteve shtetërore që i ka, me Policinë që e ka në dispozicion, me njerëz, me masa ligjore, që janë që e përmenda disa herë: arrestimin, mbajtjen e përkohshme, futjen nën sistemin e përgjimit, përcjelljen e sistemit, e rrjetit që mund të jetë i përfshirë në këtë strukturë. Të gjitha këto elemente, mendoj se ka ardhur koha që duhet t'i mendojmë dhe të shohim se çka do të bëjmë me këtë agjenci dhe të shohim çka do të bëjmë me këtë dukuri që po na shfaqet, me këtë dukuri e cila është kthyer në një element edhe i anatemimit të shpeshtë të njerëzve, por edhe nëpërmjet kësaj agjencie të mbulohet shumë edhe korrupsioni, të mbulohet edhe lufta e vërtetë kundër korrupsionit dhe kundër këtyre dukurive.

Unë mendoj se institucioni më i saktë, më adekuat për luftën kundër korrupsionit dhe të gjitha dukurive tjera, veprave penale, hetim edhe luftë kundër veprave penale janë Policia, Prokuroria dhe gjykatat, e jo një agjenci e cila realisht ka kapacitete të limituara. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit, zoti Gashi! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Fillimisht nuk është për t’u çuditur që para nesh e kemi një raport kështu si është, pra raport i gjymtë. Nëse ndalemi dhe e analizojmë raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e shohim që kjo agjenci nuk ka qenë efikase në luftën kundër korrupsionit. Pra, ky raport, si edhe ai i vitit 2010, por jo vetëm, më shumë merret me përshkrimin e detyrave, buxhetin, stafin, se sa me esencën e misionit që e ka. Pra, nuk merret me punën që është dashur ta kryejë me shumë përgjegjësi.

Në këtë raport, si dhe atë të vitit të kaluar, ekziston një dallim i madh ndërmjet numrit të rasteve që janë pranuar dhe proceduar, me rastet të cilat janë zgjidhur. Pra, këtu vërehet mosbashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe institucioneve tjera, që janë të thirrura për ta parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Dhe, kjo neglizhencë dhe ky moskoordinim ndër institucional në luftimin e korrupsionit e vështirëson funksionimin e kësaj agjencie dhe ndikon në rënien e mëtutjeshme në shkallën e besueshmërisë ndaj kësaj agjencie, së cilës nuk mund t’i vihet i tërë faji.

Më pastaj, në këtë raport gjithashtu theksohet se si është hartuar strategjia 5-vjeçare kundër korrupsionit, strategji e cila nuk ka kaluar në Kuvend dhe mendoj që tani e tutje kjo agjenci duhet ta marrë seriozisht luftën kundër korrupsionit dhe ta hartojë një strategji serioze, sepse në të kundërtën do të jetë i kotë edhe ekzistimi i institucioneve të tilla, si puna e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në të cilën ne besojmë që ka shumë zyrtarë të devotshëm për të punuar, por që mendoj se pushteti po i ngulfat.

Pjesë e dobishme në këtë raport, mund të them se është ajo e rekomandimeve. Disa prej tyre kanë qenë edhe në raportin e vitit 2010, mirëpo nuk janë marrë parasysh. Do të ndalem në njërin prej rekomandimeve: kjo agjenci ka rekomanduar që sa më shpejt të nxirret Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, i cili do të ketë fuqi retroaktive. Pra, do të konfiskojë edhe pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme para hyrjes në fuqi të ligjit.

Ministrin e Drejtësisë nuk e kemi këtu, mirëpo ne e kemi draftin e Ministrisë së Drejtësisë dhe ai draft ka për qëllim amnistinë e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, por ne shpresojmë që ai draft të mos na sillet ashtu në Kuvend dhe të përpunohet në mënyrë që të ketë fuqi retroaktive dhe t’i përfshijë të gjitha rekomandimet e shoqërisë civile, për të cilat tashmë është në dijeni Ministria e Drejtësisë.

Ajo çfarë presin qytetarët e Kosovës është që Agjencia Kundër Korrupsionit të na sjellë rezultate konkrete nëpërmjet denoncimit të aferave korruptive, e jo shifra koti sa për t’u hedhur qytetarëve hi syve. Në fund, të votosh për këtë raport është të votosh kundër faktit

që korrupsioni ka lëshuar rrënjë në çdo nivel të udhëheqjes së institucioneve. Do të thotë, të votosh kundër shumë raporteve ndërkombëtare që na thonë se më keq s'ka ku shkon, do të thotë të votosh kundër denoncimeve të shumta të aferave korruptive që janë bërë nga qytetarët, shoqëria civile, përfshirë edhe mediet, ndaj institucioneve të vendit dhe bartësve të tyre, përfshirë edhe vetë Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Andaj, ky raport, bashkë me këtë institucion, nuk do ta ketë votën “për”, përderisa është pjesë e mirëmbajtjes e kësaj gjendjeje, përderisa shërben si trampolinë për fshehjen e pasurimit të paligjshëm e kriminal, përderisa në emër të luftës kundër korrupsionit, po lufton denoncuesit e tij. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se kësaj radhe, ndoshta prapë duhet të përsëriten disa fjalë, të cilat janë thënë më përpara, kur është shqyrtuar raporti i Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kosovë.

Në njëfarë forme, krijimi i kësaj agjencie e ka krijuar bindjen te një pjesë e madhe e institucioneve tjera se kjo është agjenci që e lufton korrupsionin, ndërsa institucionet tjera kanë punë tjera. Mendoj se është kuptim i gabueshëm i gjithë kësaj çështjeje dhe i vendimit të Kuvendit, vendimit të dikurshëm të Kuvendit që të themelohet kjo agjenci. Agjencia nuk është themeluar për ta luftuar korrupsionin vetëm, agjencia është themeluar për t'i ndihmuar Kosovës për ta luftuar korrupsionin. Do të thotë, edhe nëse kuptohet si i tillë, atëherë edhe institucionet tjera e marrin rolin e vet. U përmend këtu Policia dhe Prokuroria, dhe gjyqet, do të thotë Gjyqësori, dhe mendoj se me plot të drejtë u përmendën, por nuk janë vetëm këto. Do të thotë, duhet edhe vetë institucionet brendapërbrenda, duhet politika ta luftojë korrupsionin. Nuk mund Agjencia Kundër Korrupsionit ta luftojë korrupsionin, nëse politika nuk e lufton. Dhe, a e lufton a nuk e lufton politika korrupsionin?

I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit të Kosovës! Jemi diku nga 30 veta në sallë. Po e bëjmë kuorumin edhe po diskutojmë për një problem jashtëzakonisht serioz të Kosovës, qysh është korrupsioni. Për një problem, për të cilin të gjithë themi se është problemi gati më i madhi në Kosovë, edhe i kemi në sallë pak më shumë se deputetët që e bëjnë kuorumin për diskutim, jo për marrjen e vendimeve.

Çështje tjetër është se po shihet që këto hallka të luftës kundër korrupsionit në Kosovë nuk po funksionojnë. Nëse njëra prej hallkave është Agjencia Kundër Korrupsionit, hallkat tjera nuk funksionojnë dhe Agjencia Kundër Korrupsionit mbetet një institucion, siç u tha më përpara këtu me plot të drejtë, i cili i bën disa raporte, shkruan se çka po ndodh, na i mbledh neve listat e deklaramit të pasurisë edhe kurrë nuk ndodh më. Ne kemi menduar se krijimi i kësaj agjencie do t'i ndihmojë Kosovës që ta ketë një tërësi institucionale, e cila do ta luftojë korrupsionin përbrenda. Domethënë është luftë sistimore kundër korrupsionit, është luftë konceptuale kundër korrupsionit. Jo luftë

kundër korrupsionit, t'i zënë ata që e fshehin pasurinë. Atë punë duhet ta bëjnë Policia dhe Prokuroria. Qartë.

Sidoqoftë, mendoj se gjithë ato që desha t'i them, i thashë. Për ta luftuar korrupsionin në mënyrë sistimore duhen të gjitha institucionet, nuk mjafton Agjencia Kundër Korrupsionit, nuk mjafton as Prokuroria. Duhet vullnet politik në mënyrë tepër të qartë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë raportin, jo pse i pëlqen, jo për shkak se mendon se detyrimsht duhet të votohet raporti, mirëpo mendon se nuk guxojmë në këtë lëmsh institucional në luftën kundër korrupsionit ta dënojmë një institucion, i cili të paktën po përpiqet të bëjë diçka në gjithë këtë lëmsh, siç thashë më përpara, institucional. Do ta votojmë raportin, mirëpo mendojmë se megjithëkëtë që po bëhet, përkundër raporteve, Kosova është larg prej momentit ku do të fillonte ta luftonte korrupsionin seriozisht. Ende jemi vetëm me fjalë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Sa kemi? Sa deputetë janë në sallë?

Po presim 2 minuta!

Unë i lus kryetarët e grupeve parlamentare, në qoftë se doni ta vazhdojmë seancën, e vazhdojmë, në qoftë se jo, kemi votime. Atëherë, duhet ta ndërpresim nëse nuk ka kuorum.

(Ndërhyrje)

Po po, po e kuptoj.

Konstatoj se në sallë janë 63 deputetë. Pra, ne mund të mos diskutojmë shumë për çështjet që kemi për t'i votuar dhe të futemi drejtpërdrejt në votim edhe të mos mbesim duke i pritur deputetët.

(Ndërhyrje)

Pra, rrini në sallë, përndryshe e ndërpres seancën e lë për javën e ardhshme. Unë s' dua për ta pritur askënd deri sa të pinë kafe.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Falemnderit! Konstatoj se me 48 vota "për", 8 "kundër", 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit. Falemnderit!

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për kërkesa pronësore

Zoti Gashi e ka fjalën, në emër të Komisionit FunkSIONAL për të dhënë sqarimet e duhura.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryesues!

Propozimi për anëtarin e Komisionit për Kërkesa Pronësore është kompetencë e Gjykatës Supreme dhe Gjykata Supreme ka propozuar zotin Adem Vokshin si anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore. Komisioni ka shqyrtuar nga aspekti teknik dhe juridik. Propozimi ka bazë ligjore dhe i ka dhënë vizën për aprovim. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Atëherë e hedh në votim. Në mbledhje janë prezentë 62 deputetë. Votojmë tani.

Faleminderit! Konstatohet që me 44 vota “për”, 8 abstenime dhe asnjë “kundër”

Dhe një e kemi votim me dorë, 45 vota, Kuvendi e emëroi anëtarin e Komisionit për Kërkesa Pronësore, Adem Vokshi, me mandat njëvjeçar.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës

Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës, e ka shqyrtuar Komisioni funksional për Legjislacion dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Nënkryetari i Komisionit funksional për Legjislacion, zoti Behar Selimi, për arsyetimin e raportit me rekomandime, kështu e kam unë të shkruar.
Zoti Selimi, e keni fjalën.

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion ka shqyrtuar vendimin e kryeministrit për propozimin e anëtarëve të bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe këtij Kuvendi rekomandon që të emërohen anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës Ujup Krasniqi dhe Ismajl Osdautaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Qeveria nuk e do fjalën, meqë askush s’është paraqitur.

Në sall janë 62 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 44 vota “për”, 9 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi emëroi Ujup Krasniqin dhe Ismajl Osdautaj, anëtarë të bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës është:

15. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë

Në bazë të nenit 57.7 të Rregullores së Kuvendi, Komisioni për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka kërkuar nga Kuvendi vazhdimin e afatit kohor për punën e Komisionit.

Ftoj kryetarin e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, deputetin Haki Demolli, që para Kuvendit ta arsyetojë kërkesën e Komisionit. Zoti Demolli e keni fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Siç e dini edhe ju, vitin e kaluar ky Kuvend ka themeluar, në prill, Komisionin për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës.

Ky Komision ka pasur mandatin kohor prej 8 deri në 12 muaj. Gjatë punës së vetë Komisioni ka vendosur që këtij Kuvendi t'i paraqesë draftligj të ri për zgjedhjet. Arsyt kryesore për një vendim të këtillë kanë qenë, numri i madh i amendamenteve të identifikuara dhe të miratuara nga ana e Komisionit, pastaj struktura jo e kënaqshme e ligjit ekzistues, respektivisht ristrukturimi i tij si dhe kanë qenë një numër i madh i gabimeve teknike dhe gjuhësore të cilat i kemi hasur në ligjin ekzistues e të cilat synojmë që t'i përmirësojmë me draftligjin e ri.

Mirëpo, gjatë punës së vet, Komisioni ka hasur në vështirësi të mëdha lidhur me sistemin zgjedhor dhe elementet përbërëse të tij siç janë: Numri i zonave zgjedhore, natyra e listave zgjedhore të hapura apo të mbyllura, pastaj pragu zgjedhor, vota preferenciale si dhe sistemi i shpërndarjes së ulëseve në Parlament, sepse konkretisht para Komisionit janë paraqitur 5 propozime lidhur me numrin e zonave zgjedhore, kurse ne gjithsej kemi qenë 9 anëtarë të Komisionit dhe ka qenë thuajse praktikisht e pamundur të arrihet pëlqimi, respektivisht të arrihet numri i votave të mjaftueshme për cilindo prej këtyre propozimeve.

Të ballafaquar me një sfidë të këtillë thuajse të patejkalueshme për Komisionin, Komisioni ka kërkuar ndihmë prej udhëheqësve të subjekteve të mëdha politike, por fatkeqësisht deri në skadimin e mandatit të Komisionit, nuk është gjetur një zgjidhje e pranueshme për të gjitha palët lidhur me numrin e zonave zgjedhore.

Duke pasur parasysh rrethanat dhe sfidat me të cilat është përballur Komisioni, i njëjti në mbledhjen e vet të fundit, vendosi me 6 vota "pro" dhe një abstenim që t'i drejtohet Kuvendit me kërkesë për vazhdimin e mandatit kohor edhe për 3 muaj të tjerë.

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha faktet e paraqitura në këtë kërkesë, ftoj deputetët e Kuvendit që të votojnë dhe ta miratojnë mandatin shtesë prej 3 muajve për punën e Komisionit ad hoc. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Falemnderit!

Për fjalë është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Ne duke mirëkuptuar edhe kërkesën e Komisionit edhe duke qenë pjesë sigurisht me ata që e kanë bërë marrëveshjen dhe më vonë edhe rezolutën, sigurisht dëshirojmë që ky mandat t'u vazhdohet, por Grupi Parlamentar i LDK-së dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, konsideron që një muaj është e mjaftueshme që ky Komision ta kryej punën e vet. Ky është qëndrim i Grupit Parlamentar të LDK-së, është çështje edhe e marrëveshjes edhe e vullnetit politik. Ne jemi të bindur që edhe 6 muaj nuk do të kryhet edhe një vit nëse mungon vullneti politik për të bërë atë që janë marrë vesh edhe liderët, por edhe që është pjesë e rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, ne konsiderojmë që një muaj është e mjaftueshme të realizohen të gjitha ato që parashihen gjatë këtij procesi dhe sigurisht nuk dëshirojmë të jemi pjesë e stërzgjatjes dhe zvarritjes, por të jemi pjesë e kryerjes sa më shpejtë të këtij procesi në cilin jem. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka fjalën zoti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Falemnderit, nënkryetar!

Ne, si përfaqësues të Partisë Demokratike, në Komisionin përkatës e kemi mbështetur propozimin e kryetarit për të zgjatur mandatin për këta 3 muaj që u propozua këtu në seancë, dhe unë e dëgjova me vëmendje arsyetimin të cilin e paraqiti kryetari i Komisionit, i cili qëndrim ishte edhe qëndrim i përfaqësuesve të Partisë Demokratike në Komision.

E dëgjova me vëmendje edhe kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, me shumë respekt për kryetarin edhe për fjalën që e paraqiti, por dua të nënvizoj qëndrimin e përfaqësuesve të Lidhjes Demokratike në Komision që kanë qenë shumë konstruktiv, shumë kolegjal, shumë të përgjegjshëm dhe mjaftë të angazhuar që e kanë arsyetuar kërkesën tonë që ka pasur zëra aty edhe për 6 muaj të vazhdohet edhe arsyetimi i tyre që 3 muaj do të jenë të mjaftueshëm, na kanë bindur edhe ne si përfaqësues të Partisë Demokratike që ta mbështesim këtë propozim dhe unë mendoj që është e domosdoshme koha prej 3 muajsh, ashtu siç e propozoj kryetari i Komisionit.

KRYESUESI: Falemnderit! Unë dua t' ju them që sipas Rregullores, afati mund të shtyhet 2 muaj me kërkesë plus, është një muaj, kërkesa është brenda Rregullores së Parlamentit, për mundësitë ose pamundësitë janë çështje e Komisionit, unë nuk dua të interferoj në çështjet e Komisionit.

Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryesues!

Fillimisht nëse flasim për mandat shtesë, duhet edhe të dimë edhe pse ai mandat shtesë, për çka?

Në kërkesën e Komisionit për ndryshimin e Ligjit të zgjedhjeve, ka shumë të pavërteta, mangësi e paqartësi dhe e njëjta kërkesë nuk është mbështetur nga subjekti jonë në Komision. E them të pavërteta, për faktin se vërehet një tendencë për të krijuar përshtypjen se Komisioni gjatë një viti paska punuar shumë, e aq shumë që paska punuar, nuk i kanë mjaftuar as 8 muaj që i ka pasur e as 12 muaj dhe po i kërkon edhe 3 muaj, kjo është e pavërtetë.

Gjithashtu aty krijohet bindja që të gjitha subjektet politike i kanë pruar qëndrimet në Komision për ndryshimin e Ligjit të zgjedhjeve, por pasi që janë të ndryshme nuk kemi mund të gjejmë një konsensus edhe kjo është një e pavërtetë. Pasi që subjektet nuk i kanë sjell qëndrimet e tyre, nuk kanë sjell analiza konkrete se si i shohin zonat zgjedhore përveç se i kanë përmendur ato. Për shembull, LDK-ja ka thënë: 10 zona zgjedhore, por bën edhe 26, PDK-ja ka thënë 6, 7 edhe 8 këto s'janë qëndrime. Është e vërtetë që Bashkimi Evropian ka lëshuar deklaratë që të shikohen mundësitë për zgjatjen e mandatit, por është e vërtetë që në asnjërin prej rreshtave nuk përmenden zonat zgjedhore. Ata duan sistem të thjeshtë, transparent, pra ata janë të interesuar që të krijojnë mekanizma për mbrojtjen e votës së qytetarëve ashtu siç jemi të interesuar edhe ne. Ata janë të interesuar që të organizojnë zgjedhje demokratike sipas standardeve ndërkombëtare, ata janë të interesuar që manipuluesit e votave të marrin dënimin e duhur e jo si ka ndodhur me dënimet qesharake me gjoba. Pra, kështu e kemi qëndrimin edhe ne, dhe e kemi paraqitur në vazhdimësi në Komision.

Ne vendosëm që të marrim pjesë në këtë Komision me qëllim që ta ndryshojmë rrënjësisht pjesën më të rëndësishme të legjislacionit zgjedhor, pra administrimin e zgjedhjeve dhe të vetëdijshëm që atëherë për qasjen e mbrapshtë, por të qëllimshme të hartuesve të rezolutës së atëhershme.

Dhe tani me këtë afat shtesë që po kërkohet nga Komisioni, nëse nuk specifikohen qartë çështjet që do të ndryshohen me këtë mandat shtesë, atëherë vota jonë si subjekt do të ishte votë për liderët partiakë, nënshkrues të marrëveshjes për të bërë pazare me sistemin zgjedhor.

Kështu që unë në emër të subjektit politikë lëvizja “Vetëvendosje” dua të cek pikat kyçe se çka duhet të ndryshohet, nëse i jepet mandat shtesë Komisionit.

Komisioni për ndryshimin e Ligjit të zgjedhjeve, pas marrjes së mandatit shtesë, të fillojë menjëherë hartimin e Kodit zgjedhor, kjo ka qenë kërkesa jonë edhe në fillim, mirëpo nuk është përkrahur nga subjektet tjera.

Më pastaj të përcaktohet në detaje lista e votuesve dhe përmbledhja e saj si dhe përgjegjësitë e secilit institucion në raport me listën e votuesve dhe regjistrin civil. Edhe këtë çështje e kam ngritur në vazhdimësi në Komision dhe në grup punues, mirëpo shumë pak janë marrë parasysh vërejtjet tona.

Më pastaj, vetëm dokumentet e Republikës së Kosovës, të njihen si dokumente të vlefshme për votim.

Më pastaj, votimi jashtë vendit të bëhet nëpër ambasada apo konsullata. Identifikimi i votuesve të bëhet në mënyrë biometrike, numërimi i rezultateve të bëhet nëpër qendra komunale dhe atë përmes kamerave dhe skanerëve, të adresohen procedurat që kanë të bëjnë me përzgjedhjen dhe përgjegjësitë e komisionarëve, vëzhguesve, menaxherëve të qendrave të votimit dhe personelit ndihmës. Asnjëra prej këtyre çështjeve nuk përmendet në arsyetimin e Komisionit dhe për ne si i tillë ai arsyetim është i papranueshëm dhe nuk do ta votojmë nëse nuk parashihen këto çështje që i përmenda.

Të gjitha këto propozime pra ne i kemi adresuar edhe në Komision, por partia në pushtet ka qenë ajo që në shumicën e herëve i ka kundërshtuar këto propozime dhe kjo tregon faktin se këta janë të pa interesuar të bëjnë reformë të mirëfilltë zgjedhore. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Kadaj- Bujupi e ka fjalën në emër të AAK-së.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Falemnderit, i nderuar nënkryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, sigurisht që do ta përkrahë kërkesën e Komisionit duke marrë parasysh që një ligj i ri i cili besojmë që do të dalë apo reformat që do të ndodhin gjatë këtij procesi, do të pamundësojnë vjedhjen dhe manipulimin masiv të votave dhe ardhjen eventuale në pushtet të atyre të cilët në fakt keqpërdorin mekanizmin shtetëror dhe nuk e zbatuan as ligjin i cili ka qenë më herët, por i cili ndoshta për shkak të hapësirave të cilat këta i kanë gjetur, ka lejuar që të ketë zgjedhje të këqija të cilat besojmë që nuk do të përsëriten asnjëherë, më.

Prandaj, do ta përkrahim Komisionin, përsëri po them me qëllim të vetëm që të bëjmë një ligj i cili do të minimizojë mundësinë e vjedhjes dhe manipulimit masivë, siç na ka ndodhur, më 12 dhjetor 2010. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, nënkryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh kërkesën e Komisionit për Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, këtu duhet të potencoj se ne e kemi pasur një rezolutë të miratuar në Kuvend të Kosovës, për çështjen e reformave kushtetuese dhe reformën e Ligjit Zgjedhor. Mirëpo, do të ishte e udhës pikësëpari të reformohen partitë politike se çështja e Ligjit zgjedhor është çështje politike ndërmjet subjekteve politike dhe pikë së parë në rast se ne dom t'i zbatojmë ligjet ashtu si i miratojmë brenda Kuvendit të Kosovës dhe Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme kishte me qenë apel i jemi edhe si qytetare edhe si deputete e Kuvendit të Kosovës që pikë së pari partitë politike brenda vetvetes të shohin a janë duke zbatuar ligjin dhe mos të vijnë deri te plotësim- ndryshimi i shumë ligjeve, ndërsa në zbatueshmëri të tyre është krejt esenca dhe problemi i partive politike të cilat manipulojnë me ligj.

Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje këtij Komisioni, mirëpo siç po shihet prapëseprapë skemë edhe aq shumë çka të ndërrojmë në këtë ligj. Unë edhe një herë potencoj që krejt problemi është te subjektet politike.

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Beqiri, a e deshët fjalën? Urdhëroni zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Më vjen keq që po e marr edhe një herë fjalën për këtë çështje. Unë i kisha lutur kolegët që ne kemi sigurisht respekt edhe po të mos e çmonim punën e atyre që i kemi dërguar në Komision, ata s'do të ishin në Komision, po pikërisht për punën që e bëjnë mjaftë mirë, janë në atë Komision. Por, kjo nuk do të thotë qëndrimi i LDK-së e ka qëllimin kryesor që të mos prolongohen gjërat, të mos shtyhen. Edhe një herë e përsëris, nëse vazhdohet kështu jo 3 muaj po as 6 muaj as një vit s' do t'u mjaftojë, dhe nuk është mirë të thirrën tash këta janë në komision e çmojnë punën e tjera e tjera. E themi qëndrimin e qartë LDK-ja si shkaktare mund të thuhet lirisht e këtij procesi të reformave është që kjo punë të jetë ekspeditive dhe të kryhet sa më shpejtë. Dhe, po ashtu nuk dëshirojmë të komentojmë edhe qëndrimet e partive tjera politike, a është qëndrim i tyre apo nuk është qëndrim i tyre? Prandaj, ne po i përcjellim me vëmendje, këtu është mirë të rezervohemi nga komentet për subjektet tjera. Edhe një herë po e them për LDK-n e konsiderojmë e mjaftueshme koha që për një muaj këto punë të kryhen, ato çështje që janë kontestuese dhe së këndejmi edhe një herë e rikonfirmoj qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, që jemi për një muaj të ju zgjatet mandati ose afati i këtij komisioni për të bërë punën e tyre. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Atëherë e hedhim në votim formal kërkesën e Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë. Në sallë janë 76 deputetë. Votojmë tash, ose votojmë me elektronikë, votojmë tani më mirë. Propozimi i parë i Komisionit shkon, Ismet. Pastaj, në qoftë se nuk fiton propozimi i Komisionit dihet që afati ndryshon dhe duhet përsëritur. Unë zoti Beqiri e kam hallin që prapë do të detyrohem të vijmë të njëjtën pikë pas një muaji për t'i kërkuar edhe 2 muaj të tjerë, a po e di. Kështu që më mirë e bëjmë sot me 3 muaj edhe i japim afat edhe partive politike edhe Komisionit, po mendoj më racional jemi, se edhe ashtu ka për t'u zgjatur kjo punë. Votojmë tani. Regjia, si është bërë votimi?

Konstatohet se me 45 vota "për", 11 "kundër" dhe një abstenim, miratohet afati shtesë i Komisionit ad hoc për Ligjin e zgjedhjeve prej 3 muajsh.

Pika e radhës:

16. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar "Sharri" dhe për Projektligjin për parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Unë mendoj që duhet t'u jepet afat shtesë një muaj, sepse u ka marrë kohë shumë shqyrtimi i Ligjit për Prizrenin dhe për Hoçën, kështu që e kanë harxhuar kohën atje, ne duhet t'i japim afat kohë dhe votojmë tani edhe për këtë kërkesë. Falemnderit!

Konstatohet se më 59 vota me elektronikë, 2 pa elektronikë, miratohet edhe kërkesa e Komisionit për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural, për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”. Faleminderit! Mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë